



**Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës**  
*Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave*

# Kush kujdeset?

Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë





# **Kush kujdeset?**

## **Kërkesat, ofertat dhe opsionet për rritjen e mundësive të kujdesit të fëmijëve në Kosovë**

Nga Nicole Farnsworth, Adelina Berisha, Erica Browne, Nerina Guri, Donikë Kastrati,  
dhe Gresa Rrahmani për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

Prishtinë, Kosovë  
2016

© Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, 2016

Autore: Nicole Farnsworth, Adelina Berisha, Erica Browne, Nerina Guri, Donikë Kastrati,  
dhe Gresa Rrahmani për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës

Përkthyer nga: Mars A

ISBN ISBN-978-9951-8923-8-4

Shtypur nga “NightDesign”, me materiale ekologjike.

Ky dokument është financuar nga projekti “Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE)”, i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), dhe zbatohet nga konsorciumi Swisscontact, Instituti Riinvest dhe PEM Consult. Opinionet e shprehura në këtë publikim jo domosdoshmërisht i paraqesin opinionet konsorciumit të partnerëve të PPSE-së.

[www.womensnetwork.org](http://www.womensnetwork.org)

## **Përmbajtja**

Akronimet .....	6
Mirënjohje.....	7
Përmbledhje ekzekutive.....	8
Hyrje .....	9
Pse nevojitet kujdesi?.....	9
Rreth këtij hulumtimi.....	12
Metodologjia.....	13
Korniza ligjore e Kosovës lidhur me kujdesin për fëmijë.....	15
Objektivat e BE-së të Barcelonës: Zhvillimi i kujdesit për fëmijë.....	18
Kërkesa për kujdes për fëmijë te gratë e papunësuar .....	20
Kërkesa për kujdes për fëmijë në radhët e punonjësve .....	25
Kujdesi aktual për fëmijë (3 deri 6 vjeç) .....	26
Kujdesi aktual për fëmijë (6 muaj deri 3 vjeç) .....	27
Shërbimet më të rëndësishme të kujdesit për fëmijë .....	30
Çmime të arsyeshme për shërbimet e kujdesit për fëmijë.....	31
Interesi i punëdhënësit në përkrahjen e shërbimeve të kujdesit për fëmijë .....	32
Shërbimet në dispozicion në qendrat e kujdesit për fëmijë .....	34
Orët e punës të qendrave për kujdesin e fëmijëve.....	37
Çmimi i kujdesit për fëmijë .....	37
Shpenzimet për qendrat e kujdesit për fëmijë .....	37
Kërkesa për kujdesin për fëmijë .....	38
Sfidat me të cilat përballen qendrat për kujdes të fëmijëve .....	38
Shërbimet e kujdestareve dhe të dadove.....	39
Përfundime .....	40
Vlerësimi i kostos së kujdesit.....	40
Modelet opsionale për rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë .....	42
Modeli 1. Zgjerimi i kujdesit publik të financuar nga shteti.....	42
Modeli 2. Partneritetet Publiko-Private.....	43
Modeli 3. Inkurajimi i bashkë-financimit privat të përkuqjesjes për fëmijë .....	45
Modeli 4. Zgjerimi i qendrave të kujdesit për fëmijë me bazë në komunitet.....	46
Perspektivat komunale për modelet e ndryshme të kujdesit për fëmijë .....	47
Komuna e Prishtinës.....	47
Komuna e Gjakovës .....	49
Komuna e Pejës.....	50
Komuna e Kamenicës.....	51
Kosova e Veriut, Veçanërisht Mitrovica e Veriut.....	52
Rekomandime shtesë.....	54
Rekomandimet për Komunat .....	54
Rekomandime për Ministrinë e Financave .....	55
Rekomandime për MPMS-në.....	55
Rekomandime për MASHT-in .....	55
Rekomandime për biznesin.....	55
Rekomandime për qendrat e kujdesit.....	56
Rekomandime për financuesit jo-qeveritarë.....	56

Rekomandime për Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe për hulumtime në të ardhmen.....	56
Bibliografia .....	57
Shtojca 1. Rreth PPSE .....	60
Shtojca 2. Metodologjia .....	61
Shtojca 3. Vlerësimet e përafërta të kërkesave të paplotësuara për kujdesin ndaj fëmijëve nga ana e Komunës.....	65
Shtojca 4. Institucionet parashkollore të identifikuara.....	68
Shtojca 5. Punonjëset/it me fëmijë të interesuar në shërbime të kujdesit të fëmijëve nga punëdhënësi/ja.....	71
Shtojca 6. Tabela Punëdhënëseve/ve të interesuar në Përkrahjen e Rritjes së Qendrave të Kujdesit për Fëmijë.....	73
Shtojca 7. Lista e Pjesëmarrësve në Hulumtim.....	75
Shtojca 8. Pyetësorët dhe udhërfyesit e intervistimit .....	76
Pyetësori për gratë e papunësuara.....	76
Hulumtimi i qendrave të kujdesit.....	79
Pyetësori i punëtoreve/ëve.....	83
Pyetësori për punëdhënësit/et.....	86

## Akronimet

IB	Intervali i Besueshmërisë
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
KE	Komisioni Evropian
SZHMFH	Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme
BE	Bashkimi Evropian
AIK	Amplituda Interkuartile
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
RrGGK	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
SKZh	Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OBZhE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PPP	Partneritet Publiko-Privat
PPSE	Projekti "Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE)
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
DS	Devijim Standard
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar

## Mirënjohje

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) falënderon të gjitha punonjëset dhe punonjësit, punëdhënësit, qendrat e kujdesit, përfaqësuesit e institucioneve, si dhe nënat e papunësuar që kanë kontribuar me mendimet e tyre për këtë hulumtim. Gjithashtu, falënderojmë Swisscontact dhe projektin e saj Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE) për mbështetjen e hulumtimit të kësaj teme të rëndësishme. Në veçanti, falënderojmë Alida Muhaxhirin dhe Béat Windlin për kontributin e çmuar dhe mbështetjen e shkëlqyeshme teknike gjatë gjithë procesit të hulumtimit. Autoret falënderojnë Igballe Rogovën, Drejtore Ekzekutive në RrGGK dhe Besa Shehun, Menaxhere e Financave për përkrahjeje të vazhdueshme në realizim të këtij hulumtimi.

Agonjeta Marashi, Arbëresha Maloku, Arta Arifi, Ardiana Hetemi, Bardh Rexhepi, Donjeta Arifi, Edona Sahatqija, Fitore Simnica, Fjollë Kastrati, Genita Lleshi, Milica Barac, dhe Vanesa Tahirsylaj i kanë bërë anketat dhe intervistat. Elizabeta Murati ka ndihmuar në hulumtim. Dua Dauti-Kadriu, anëtare e Bordit të RrGGK-së, vullnetarisht ka ofruar ndihmën e saj në sigurimin e informatave të nevojshme në çastin e fundit.

RrGGK falënderon recensentët vullnetarë për komentet e tyre të hollësishme të dhëna në draftin e raportit: Dr. Vjollca Krasniqi, Universiteti i Prishtinës; Dea Pallaska O'Shaughnessy; Donjeta Morina; Ariana Qosaj-Mustafa, Kryesuese e Bordit të RrGGK-së; Iliriana Banjska; Arbëresha Maloku dhe Arlinda Kadriu.



## Përmbledhje ekzekutive

Në Kosovë, shkalla e pjesëmarrjes së grave në fuqinë punëtore është ndër më të ulëtat në botë: 18.1%. Disa studime kanë treguar se përgjegjësitë për ofrimin e kujdesit në shtëpi kontribuojnë në këtë pjesëmarrje të ulët të grave. Në shumicën e kulturave, grave u caktohen detyrat dhe përgjegjësitë tradicionale gjinore të punës së kujdesit pa pagesë. Kujdesi pa pagesë mund të ndikojë negativisht në nivelin e arsimimit të grave, në pjesëmarrjen e tyre në fuqinë punëtore, në përfshirjen politike si dhe në nivelet e varfërisë gjatë jetës.

Ky hulumtim shqyrton kërkesën e mbuluar dhe të pambuluar për shërbime të kujdesit për fëmijë në Kosovë; shërbimeve publike dhe private të kujdesit për fëmijë që janë në dispozicion; si dhe pikëpamjet e shumëllojshme të palëve të interesit lidhur me mundësitë për krijimin e më shumë shërbimeve të qëndrueshme të kujdesit për fëmijë. Ky hulumtim është përqendruar në pesë zona gjeografike, dhe ka përfshirë anketa me familje, të përzgjedhura sipas metodës së rastit, me 491 nëna të papunësuar me fëmijë; anketa me 519 gra dhe burra të papunësuar; intervista me 61 punëdhënës; intervista me 51 qendra publike dhe private të kujdesit për fëmijë; si dhe intervista me zyrtarë publikë.

Të gjitha qendrat e kujdesit për fëmijë në Kosovë, qofshin publike ose private, do të duhej të regjistroheshin dhe të ofrojnë programe të edukimit parashkollorë. Në vitin 2016 janë regjistruar 74 institucione parashkollore private dhe 41 publike. Së bashku me qendrat tjera ekzistuese, gjithsej janë rreth 134. Po ashtu ka edhe qendra të tjera të kujdesit për fëmijë të cilat nuk janë të regjistruara. Megjithatë, vetëm rreth 15.5% e fëmijëve kosovarë i frekuentojnë qendrat e kujdesit ditore. Më shumë se gjysma e të anketuarve të punësuar kanë deklaruar se varen nga anëtarët e familjes të cilët ofrojnë pa pagesë shërbimin e kujdesit për fëmijët e tyre. Shërbimet e kujdesit për fëmijë gjenden kryesisht në Prishtinë, ndërkohë që në zonat rurale ka shumë pak qendra të tilla. Vetëm 20% e nënave të papunësuar që jetojnë në zona rurale kanë deklaruar që shërbimet e kujdesit për fëmijë ishin të arritshme në aspektin gjeografik. Me sa duket, dymbëdhjetë komuna nuk kanë në dispozicion qendra të kujdesit për fëmijë. Pothuajse të gjitha gratë e papunësuar që janë anketuar do të dëshironin të kishin një punë që paguhet. Nga gratë e interesuara për punë, 88% do t'i shfrytëzonin shërbimet e kujdesit për fëmijë po të kishin në dispozicion një mundësi të përballueshme financiarisht.

Korniza ligjore e Kosovës në mënyrë të qartë përcakton themelet për rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë. Kushtetuta e konsideron Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGjFDG) drejtpërdrejtë të zbatueshme; ajo u bën thirrje shteteve të krijojnë qendra të kujdesit me qëllim të luftimit të diskriminimit kundër grave dhe të përmirësimit të pjesëmarrjes publike të grave. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, e cila është gjithashtu drejtpërdrejtë e zbatueshme, bën thirrje për kujdes për fëmijët. Nevoja për të mbrojtur mirëqenien e fëmijëve mund të interpretohet si përmirësim i qasjes në edukimin e hershëm në mënyrë që ata të tregojnë më shumë sukses në shkollë dhe të kenë mundësi më të mira për punë gjatë jetës. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZh) ka për qëllim, ndër të tjera, rritjen e numrit të çerdheve dhe institucioneve private të kujdesit për fëmijë. Gjithashtu, në kontekstin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE), Kosova duhet të angazhohet maksimalisht që të ulë papunësinë e grave, të përmirësojë vijueshmërinë në institucione parashkollore, të luftojë diskriminimin ndaj grave, ku të gjitha këto janë të ndërlidhura me rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë.

Kosova duhet ta njohë publikisht vlerën e punës së kujdesit për fëmijë që ndërmerret nga gratë; të *zvogëlojë* kohën që gratë kalojnë duke u kujdesur për fëmijë, përmes rritjes së mundësive të shërbimeve të kujdesit; si dhe të inkurajojë *rishpërndarjen* e punës të kujdesit për fëmijë tek burrat, komunitetet dhe shteti. Transformimi i punës së kujdesit për fëmijë, e cila aktualisht nuk paguhet, në punë me pagesë mund të kontribuojë në të ardhmen në përmirësimin e suksesit edukativ të fëmijëve, në krijimin e vendeve të reja të punës, uljen e papunësinë, dhe uljen potenciale të varfërisë së grave të pensionuara. Siç shpjegohet në hollësi në këtë studim, RrGGK-ja ka përllogaritur se investimi në qendra të kujdesit për fëmijë në përputhje me Objektivat e Barcelonës të Komisionit Evropian (KE) do të mund të krijonte të paktën 9,989 vende të reja të punës në arsim. Kjo do të mund të kontribuonte, të paktën, me 50.6 milionë euro si të hyra të reja dhe me 2 milionë euro si tatime të paguara çdo vit. Këto shifra nuk marrin në konsideratë vendet e reja të punës, të ndërlidhura me qendrat e kujdesit, që do të mund

të krijojeshin ose të hyrat e reja materiale për prindërit që aktualisht nuk punojnë e të cilët do të ishin në gjendje të hynin në punë si fuqi punëtore.

Ekzistojnë disa modele të mundshme për rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë: qendrat publike të kujdesit për fëmijë të financuara nga shteti; partneritetet publiko-private (PPP-të); qendrat me bazë në komunitet; dhe, në të ardhmen, ndërmarrjet shoqërore. Pasi që niveli i kërkesës dhe situata politike në secilën nga zonat gjeografike të studiuara dallojnë bukur shumë, RrGGK-ja shtjellon opsione të ndryshme për rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë në secilën zonë. Duke marrë parasysh hapësirat e kufizuara në dispozicion në qendrat publike të kujdesit për fëmijë, komunat do të duhej të vendosin prioritetet lidhur me atë se kush përfiton nga kujdesi publik. Gratë e papunësuarat të cilat aplikojnë për punë, që marrin asistencë nga Zyrat e Punësimit, dhe që vijojnë kurse në Qendrat e Aftësimit Profesional do të duhej të përfitonin kujdes afat-shkurtër pa pagesë për fëmijët e tyre. Ky studim përmban edhe rekomandime specifike shtesë.

## Hyrje

Në Kosovë, shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore të grave është ndër më të ulëtat në botë: 18.1%.<sup>1</sup> Më shumë se tetë nga dhjetë gra të moshës së punës nuk janë aktive në fuqinë punëtore, në krahasim me katër nga dhjetë burra.<sup>2</sup> Shkalla e papunësisë në mesin e grave është 36.3%. Kjo dëshmon se disa gra madje as nuk kërkojnë punë. Disa studime të kohëve të fundit kanë gjetur se përgjegjësitë e kujdesit në shtëpi kontribuojnë në mosaktivitetin e grave në tregun formal të punës. Në anketën e fuqisë punëtore të vitit 2015, 11.4% të grave kanë deklaruar se ato nuk punonin për arsye se ishin të detyruara për t'u kujdesur për fëmijët ose personat e moshës madhore me nevoja të veçanta (krahasuar me 0.2% të burrave).<sup>3</sup> 38.5% e grave të tjera kanë deklaruar se nuk punonin për arsye të përgjegjësisë të tjera personale ose familjare (krahasuar me 3.8% të burrave). Ngjashëm, në anketën me familje të realizuar nga RrGGK në tërë Kosovën në vitin 2015, përgjegjësitë e kujdesit për fëmijë ishin arsyeja *më dominuese* që gratë e kanë theksuar lidhur me atë se përse nuk janë të punësuarat; një në katër gra ka deklaruar se nuk është e punësuar për shkak të përgjegjësisë për kujdesin ndaj fëmijëve dhe të kujdesit për shtëpi.<sup>4</sup> Në anketën me familje të realizuar nga RrGGK-ja në vitin 2016, 17.8% (krahasuar me 2% të burrave) kanë deklaruar se përgjegjësitë e kujdesit ishin arsyeja kryesore pse ato nuk ishin duke punuar me pagë; 16.1% e grave e kanë identifikuar punën e kujdesit për shtëpi si arsyen kryesore (2.8% të burrave).<sup>5</sup> RrGGK-ja ka shumë kohë që sugjeron se kujdesi për fëmijë i cili është i disponueshëm dhe i përballueshëm do të mund t'iu mundësonte më shumë grave hyrjen në tregun e fuqisë punëtore, si duke krijuar vende të reja pune ashtu edhe duke e bërë kujdesin për fëmijë më lehtësisht të qasshëm.<sup>6</sup>

### Pse nevojitet kujdesi?

Puna pa pagesë e kujdesit për fëmijë zakonisht kalon pa u vënë re, megjithëse ajo është me rëndësi thelbësore për funksionimin e ekonomisë familjare, komunitetit, mirëqenies njerëzore, si dhe ekonomisë.<sup>7</sup> I quajtur shpesh si punë "riprodhuese" ose "shtëpiake", kujdesi pa pagesë për fëmijë tradicionalisht është trajtuar ndryshe nga puna me bazë në treg. Një pikëpamje tradicionale e ekonomisë

<sup>1</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Banka Botërore, *Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore për vitin 2015, qershor 2016, marrë nga:* <https://ask.rks-gov.net/en/lm?download=1636:results-of-the-kosovo-2015-labour-force-survey>.

<sup>2</sup> ASK, Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore për vitin 2015, (Qershor 2016), tabela 1.4, Statusi i punësimit, ASK, fq. 10.

<sup>3</sup> Po aty.

<sup>4</sup> RrGGK, anketa me familje për dhunën në familje dhe ngacmimin seksual e realizuar në tërë Kosovën, demografia, 2015.

<sup>5</sup> RrGGK, anketa me familje për kujdesin shëndetësor e realizuar në tërë Kosovën, 2016.

<sup>6</sup> Shih, për shembull, Strategjia e RrGGK 2015-2018, marrë nga:

[http://www.womensnetwork.org/documents/kwn\\_strategy\\_2015\\_2018\\_shq.pdf](http://www.womensnetwork.org/documents/kwn_strategy_2015_2018_shq.pdf).

<sup>7</sup> UNDP, Fälth, A., Blackden, M., *Përmbledhje e politikave për punën pa pagesë të kujdesit (Policy Brief on Unpaid Care Work)*, Nju Jork, 2009, marrë nga:

<http://www.undp.org/content/dam/undp/library/gender/Gender%20and%20Poverty%20Reduction/Unpaid%20care%20ork%20English.pdf>.

përqendrohet në proceset e prodhimit dhe konsumit material, duke e injoruar ofrimin e kujdesit. Sipas përkufizimit, “pa pagesë” do të thotë që personat të cilët e kryejnë punën e kujdesit shpesh nuk marrin pagë. Prandaj, puna e tyre nuk matet në llogaritjet e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PPB).<sup>8</sup> “Kujdes” do të thotë se kjo veprimtari i shërben mirëqenies së njerëzve, dhe “punë” do të thotë se kjo veprimtari përfshin kalimin e kohës dhe shpenzimin e energjive.<sup>9</sup> Ekzistojnë katër lloje të ndryshme të punës së kujdesit: kujdesi për fëmijë, kujdesi rehabilitues, kujdesi për persona me nevoja të veçanta dhe kujdesi për persona të moshuar.<sup>10</sup> Puna e kujdesit po ashtu mund të përfshijë gatimin, pastrimin, blerjen, grumbullimin e ujit dhe të lëndëve djegëse, dhe kujdesin për personat e sëmurë.<sup>11</sup>

Përgjegjësia për t'u kujdesur për fëmijët bie si mbi babanë ashtu edhe mbi nënën.<sup>12</sup> Megjithatë, në shumicën e kulturave, grave iu janë caktuar detyrat dhe përgjegjësitë tradicionale gjinore të punës së kujdesit pa pagesë. Byroja për Regjistrim të Popullsisë e Shteteve të Bashkuara ka gjetur se gratë në SHBA “ia përkushtojnë më shumë se 110 milionë orë në vit kujdesit pa pagesë për fëmijë, që është më shumë sesa dyfishi i 55 milionë orëve që burrat ia përkushtojnë kujdesit pa pagesë për fëmijë”.<sup>13</sup> Në Evropë, burrat kalojnë vetëm nëntë orë në javë duke u marrë me kujdesin pa pagesë për fëmijë, ndërsa gratë kalojnë 26 orë.<sup>14</sup> Çiftet me fëmijë të vegjël kalojnë më shumë kohë, pavarësisht statusit të punësimit; megjithëkëtë, burrat kalojnë përafërsisht 17 orë në krahasim me gratë të cilat kalojnë rreth 40 orë në javë.<sup>15</sup> Në Kosovë nuk është bërë ndonjë studim lidhur me kohën që gratë dhe burrat kalojnë duke u kujdesur për fëmijë, prandaj nuk ka informata të sakta lidhur me këtë. Një studim pilot prej 194 grave në tri komuna dëshmon se gratë kalojnë mesatarisht më shumë se tri orë në ditë dhe 21 orë në javë në punën pa pagesë të kujdesit që ndërlidhet *vetëm* me fëmijë, të moshuar dhe persona të tjerë (duke mos përfshirë, gatimin, pastrimin, dhe format tjera të kujdesit).<sup>16</sup> Pra, kjo kohë e kaluar është e barasvlershme me një punë me gjysmë orari.

Pasi që ekziston një shpërndarje e pabarabartë e punës së kujdesit pa pagesë midis grave dhe burrave, është me rëndësi që të kuptohet rëndësia dhe dinamika e saj. Siç kanë vlerësuar Fäth dhe Blackden, “Puna pa pagesë e grave në kujdes shpesh nuk vërehet dhe nënvlerësohet, ndërkohë që burrat marrin më shumë të ardhura dhe vlerësim për kontributin e tyre ekonomik.”<sup>17</sup> E megjithatë, një nga arsyt kryesore pse burrat janë në gjendje të punojnë është puna e kujdesit pa pagesë që bëhet nga gratë në rolet e tyre tradicionale “riprodhuese”.

Aktualisht, lidhur me ndarjen e pasurisë, Qeveria e Kosovës njeh vetëm punën pa pagesë në shtëpi. Në bazë të Ligjit për Familjen, gjykatat gjatë vendosjes në kontestet për pronë të përbashkët duhet të njohin të gjitha kontributet e grave dhe të burrave lidhur me grumbullimin e pasurisë së tyre të përbashkët. Gjykata duhet të vlerësojë “të gjitha rrethanat”, dhe “jo duke marrë parasysh vetëm të

<sup>8</sup> Po aty.

<sup>9</sup> Po aty.

<sup>10</sup> Himmelweit, Susan, Konferenca publike për *Gjininë dhe Financat Publike nga Perspektiva e Kujdesit*, 2014, marrë nga: [https://www.wu.ac.at/fileadmin/wu/d/i/vw3/Public\\_Conf\\_Key\\_Note\\_Sue\\_Himmelweit.pdf](https://www.wu.ac.at/fileadmin/wu/d/i/vw3/Public_Conf_Key_Note_Sue_Himmelweit.pdf).

<sup>11</sup> Eyben and Fontana, Kujdesi për Mirëqenie, Brighton, 2011, marrë nga: <https://opendocs.ids.ac.uk/opendocs/bitstream/handle/123456789/3674/Bellagio-Eyben%20and%20Fontana.pdf?sequence=1>.

<sup>12</sup> Kjo përgjegjësi përcaktohet në KEGJFDG, neni 16, ku parashihet që, “(d) Të drejta dhe përgjegjësi të njëjta si prindër, pavarësisht statusit të tyre martesorë, në çështjet që kanë të bëjnë me fëmijët e tyre.” Ligji për Barazi Gjinore i Kosovës po ashtu parashihet për gratë dhe burrat pjesëmarrje të barabartë në të gjitha sferat e shoqërisë (neni 3, para. 1.10). Gjithashtu, sipas Ligjit për Familje të Kosovës, rregullimi i marrëdhënieve familjare bazohet në parimet e “barazisë midis burrit dhe gruas, respektit dhe ndihmës së ndërsjellët midis tyre dhe anëtarëve të familjes”; dhe “mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësisë e të dy prindërve për rritjen dhe arsimimin e fëmijëve të tyre.” (neni 3, para. 1, 2).

<sup>13</sup> Folbre, Nancy, *Për Dashuri dhe Para: Ofrimi i Kujdesit në Shtetet e Bashkuara (For Love and Money: Care Provision in the United States)*, Nju Jork: Russell Sage Foundation, 2012.

<sup>14</sup> Anketa për kushtet e punës në Evropë në vitin 2010, marrë nga: [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/economic-independence/economic-growth/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/economic-independence/economic-growth/index_en.htm).

<sup>15</sup> Eurofound, *vjetari i Eurofound 2013*: Jeta dhe puna në Evropë, 2013, marrë nga:

[http://www.eurofound.europa.eu/sites/default/files/ef\\_publication/field\\_ef\\_document/ef1416en.pdf](http://www.eurofound.europa.eu/sites/default/files/ef_publication/field_ef_document/ef1416en.pdf).

<sup>16</sup> Studimi pilot i RrGGK, 2016. Ky studim nuk ka përfshirë një mostër të rastit dhe nuk mund të konsiderohet si përfaqësues, por vetëm ilustrues.

<sup>17</sup> UNDP, Fäth, A., Blackden, M., *Përmbledhje e politikave për punën pa pagesë të kujdesit (Policy Brief on Unpaid Care Work)*, Nju Jork, 2009.

ardhurat personale dhe të hyrat e tjera të secilit bashkëshort, por edhe ndihmën e njërit prej bashkëshortëve që i ofron bashkëshortit tjetër, si kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.”<sup>18</sup> Megjithatë, kujdesi pa pagesë për fëmijë nuk njihet sipas ligjit të Kosovës.

Punë e përkujdesit mund të çojë në humbje të mundësive për arsimim. Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), “Dallimi në nivelin e arsimit midis kujdestarëve intensiv dhe kujdestarëve jo-intensiv është i madh: Përçindja e kujdestarëve intensiv me arsimim të ulët është pothuajse 30% më e lartë krahasuar me kujdestarët jo-intensiv.”<sup>19</sup> Në anketën me familje të realizuar nga RrGGK-ja në vitin 2015, midis personave të cilët e kishin ndërprerë arsimimin e tyre para përfundimit të universitetit, 3% e totalit të të anketuarve, dhe 5.2% e grave kanë deklaruar se arsyeja kryesore ishte se duhej të kujdeseshin për të tjerët.<sup>20</sup> Pasi që koha dhe energjia e nevojshme për punën e kujdesit i kufizon gratë më shumë sesa burrat, ajo gjithashtu pengon në mundësinë e grave për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në jetën ekonomike dhe politike.<sup>21</sup>

Gjithashtu, pjesëmarrja e ulët e grave në tregun e punës mund të ndikojë në mirëqenien e tyre edhe më vonë gjatë jetës së tyre. Duke marrë parasysh se puna pa pagesë që bëjnë gratë në sferën e kujdesit nuk konsiderohet kontribut zyrtar në ekonomi, gratë nuk marrin përfitime sikurse janë pensionet kontributdhënëse ose, në disa situata, përfitime në kujdes shëndetësor. Puna pa pagesë nuk konsiderohet si “pagesë” zyrtare në sistemin pensional, prandaj gratë nuk kualifikohen për pensione më të larta. Në të vërtetë gratë kosovare, mesatarisht, përbëjnë 67% të përfituesve të pensionit bazik (75€ në muaj), ndërsa vetëm 14.5% e përfituesve të pensioneve kontributdhënëse që marrin 138€ në muaj.<sup>22</sup> Fakti që gratë marrin pensione më të ulëta, edhe më vonë gjatë jetës, mund t'i vërë ato në rrezik më të madh të varfërisë.

Nga perspektiva e barazisë gjinore, siç parashihet në Ligjin për Barazi Gjinore, dëshmia e mësipërme si dhe ajo e paraqitur në këtë hulumtim do të duhej të përdoren si informata për politikën publike, e veçanërisht lidhur me prioritetin e SKZh-së për ta ulur papunësinë.<sup>23</sup> Diane Elson ka sugjeruar se për trajtimin e punës së kujdesit pa pagesë duhet zbatuar korniza e “3 R-ve” (Recognition, Reduction, Redistribution - Njohje, Zvogëlim, Rishpërndarje):<sup>24</sup>

- *Njohja* e rolit të grave dhe vajzave në ofrimin e kujdesit pa pagesë, si dhe vlera sociale dhe ekonomike e kujdesit pa pagesë.
- *Zvogëlimi* i angazhimit dhe barrës kohore të kujdesit pa pagesë, posaçërisht për gratë që jetojnë në varfëri.
- *Rishpërndarja* e punës së kujdesit pa pagesë: nga gratë tek burrat, dhe nga familja te komuniteti dhe shteti.

<sup>18</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji për Familjen i Kosovës, neni 54(1), marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>.

<sup>19</sup> OBZHE, “Kërkohe Ndihmë - *Ndikimi i Kujdesit në Kujdestarët Familjarë*”, OBZHE 2011, marrë nga: <http://www.oecd.org/els/health-systems/47884865.pdf>.

<sup>20</sup> RrGGK, anketa me familje për dhunën në familje dhe ngacmimin seksual e realizuar në tërë Kosovën, demografia, 2015.

<sup>21</sup> Siç ka theksuar Elson-i, “Kjo është njohur në lëvizjen e grave në vitet 1960-ta dhe 1970-ta dhe janë bërë përpjekje për ta paraqitur rëndësinë e ekonomisë shtëpiake në kuadër të ekonomisë politike marksiste nëpërmjet debatit për punën në shtëpi” Ekonomikja, Politikja dhe Ekonomia shtëpiake (*The Economic, the Political and the Domestic*), 1998).

<sup>22</sup> RrGGK, Buxhetimi drejt Mirëqenies Sociale, *Analizë gjinore+ për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë 2016-2018*, Prishtinë, Kosovë, 2016, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20151203094304881.pdf>.

<sup>23</sup> Sipas Ligji për Barazi Gjinore, institucionet janë përgjegjëse për analizën e statusit të femrave dhe meshkujve në organizatat dhe fushat përkatëse (neni 5 (1.1)) dhe për përfshirjen e integritimit gjinor në të gjitha politikën, dokumentet dhe legjislacionin (neni 5 (1.3)) me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor.

<sup>24</sup> Sida, *Udhëzues i shpejtë lidhur me çfarë dhe si: Puna Pa Pagesë në Kujdes - Pikat Hyrëse për Njohje, Zvogëlim dhe Rishpërndarje* (*Quick Guide to What and How: Unpaid Care Work - Entry Points to Recognise, Reduce and Redistribute*), marrë nga: <https://www.oecd.org/dac/gender-development/47565971.pdf>.

Nocioni i “ekonomisë së kujdesit”, ndryshe nga “ekonomia e tregut”, paraqet vizionin e një ekonomie që vlerëson punën pa pagesë në statistikë, analizon rolin e kujdesit dhe mallrave në funksionimin e ekonomisë, si dhe integron ekonominë e kujdesit në politika.<sup>25</sup>

Duhet të miratohen politika shtetërore për njohjen e faktit se puna e kujdesit është shumë e rëndësishme në aspektin social dhe ekonomik për funksionimin e një shoqërie. Përndryshe, fakti që gratë bëjnë shumë më shumë punë të kujdesit sesa burrat do të vazhdojë të jetë një faktor i rëndësishëm që ndikon në varfërinë joproporcionale të grave. Eisler dhe Otis kanë identifikuar disa hapa për adresimin e punës së nënvlerësuar të grave dhe të ndikimit të saj: përlogaritni “vlerën ekonomike të punës së kujdesit pa pagesë”; tregoni se si “kujdesi dhe edukimi cilësor i fëmijëve mund të ndikojë në konkurrueshmërinë ekonomike”; dhe tregoni “se si kombet e tjera e mbështesin punën e kujdesit dhe fuqizimin e grave, ku që të dyja këto garantojnë në sukses ekonomik dhe në një cilësi të përgjithshme më të lartë të jetës.”<sup>26</sup>

Investimi në kujdesin për fëmijë mund të ofrojë edhe më shumë mundësi për edukim të hershëm. Dëshmitë sugjerojnë se fëmijët të cilët vijnë në institucionet parashkollore tregojnë se janë më të suksesshëm në shkollë. Mesatarisht, “fëmijët përfitojnë rreth një të tretën e vitit përmes mësimave në gjuhë, lexim dhe matematikë.”<sup>27</sup> Fëmijët që vijnë në edukimin e hershëm demonstronë përfitime në zhvillimin socio-emocional dhe në shëndet. Hulumtimet e kryera nga neuro-shkencëtarë, psikologë dhe socio-ekonomistë kanë përlogaritur ndikimin që ka edukimi i hershëm në zhvillimin ekonomik. Studimet nga James J. Heckman kanë treguar se programet cilësore parashkollore kanë një “kthim në investim prej 7% deri në 10% duke u bazuar në rritjen e arritjeve në shkollë dhe në karrierë dhe në uljen e kostos së edukimit korrigjues, si dhe shpenzimeve shëndetësore dhe të sistemit të drejtësisë penale.”<sup>28</sup>

## Rreth këtij hulumtimi

Në këtë hulumtim është përdorur një qasje gjithëpërfshirëse në adresimin e punës së grave në kujdes, e cila deri tani në Kosovë nuk është njohur dhe nuk paguhet, si dhe ndikimin që ajo ka në fuqinë punëtore dhe në mirëqenien e grave. Hulumtimi kishte për qëllim të vlerësojë kërkesën e mbuluar dhe të pambuluar për shërbime të kujdesit për fëmijë në mesin e grave dhe burrave të punësuar dhe të papunësuar; shërbimet publike dhe private të kujdesit për fëmijë në dispozicion; si dhe pikëpamjet e shumëllojshme të palëve të interesit lidhur me mundësitë për krijimin e më shumë qendrave të qëndrueshme të kujdesit për fëmijë. RrGGK-ja e ka kryer këtë hulumtim me mbështetje të projektit PPSE të Swisscontact-it. Objektivat e hulumtitit ishin:

- Vlerësimi i gatishmërisë së nënave dhe baballarëve aktualë dhe potencialë, të punësuar në ndërmarrje të mesme ose të mëdha, për të përdorur qendrat e kujdesit për fëmijë brenda kompanisë ose në rrethinën e afërt (p.sh., në një kompani tjetër që gjendet afër);
- Vlerësimi i gatishmërisë së kompanive për të themeluar ose bashkë-financuar kujdesin për fëmijët e punonjësve të tyre;
- Vlerësimi se në çfarë shkalle kontribuon obligimi i nënave të papunësuar për t'u kujdesur ndaj fëmijëve në papunësinë e tyre, dhe cilat shërbime të kujdesit për fëmijë do ta lehtësonin qasjen e tyre në punësim;

<sup>25</sup> The Conversation, *Llogaritja e kostos së ekonomisë së kujdesit të Australisë (Counting the cost of Australia's care economy)*, 2012, marrë nga: <http://theconversation.com/counting-the-cost-of-australias-care-economy-9946>.

<sup>26</sup> Eisler, Riane Kimberly Otis, *Puna e kujdesit e nënvlerësuar dhe pa pagesë i mban gratë buzë gremine (Unpaid and Undervalued Care Work Keeps Women on the Brink)*, at: <http://shriverreport.org/unpaid-and-undervalued-care-work-keeps-women-on-the-brink/>.

<sup>27</sup> Hirokazu Yoshikawa, Christina Weiland, Jeanne Brooks-Gunn, Margaret R. Burchinal, Linda M. Espinosa, William T. Gormley, Jens Ludwig, Katherine A. Magnuson, Deborah Phillips, Martha J. Zaslow; *Investimi në ardhmërinë tonë: baza e dëshmive për arsimin parashkollore (Investing in Our Future: The Evidence Base on Preschool Education)*, marrë nga: <http://fcd-us.org/sites/default/files/Evidence%20Base%20on%20Preschool%20Education%20FINAL.pdf>.

<sup>28</sup> Studimi i qasjes së mësimnxënies me pjesëmarrje aktive në institucionin parashkollore “Perry Preschool”, i cili ishte një eksperiment shkencor, ka identifikuar efekte afatgjata dhe afatshkurtra në cilësinë e arsimit parashkollore për fëmijët e rinj që jetojnë në varfëri (marrë nga: [http://www.highscope.org/file/research/perryproject/specialsummary\\_rev2011\\_02\\_2.pdf](http://www.highscope.org/file/research/perryproject/specialsummary_rev2011_02_2.pdf)). The Heckman Equation, *Investimi në zhvillimin e fëmijërisë së hershme: zvogëlon deficitin, forcon ekonominë (Invest in early childhood development: Reduce deficits, strengthen the economy)*, marrë nga: <http://heckmanequation.org/content/resource/invest-early-childhood-development-reduce-deficits-strengthen-economy>.

- Vlerësimi i ofertës aktuale të kujdesit për fëmijë nga qendrat publike dhe private; dhe
- Vlerësimi i gatishmërisë së zyrtarëve publik për të mbështetur rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë.

Ky studim fillon me shqyrtimin e kornizës përkatëse ligjore të Kosovës përkitazi me kujdesin për fëmijë. Gjithashtu shtjellon Objektivat e Barcelonës të KE-së, si një synim potencial për rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë dhe ndikimin pozitiv që mund të ketë përmbushja e tyre në Kosovë. Më tej, hulumtimi analizon përgjigjet nga gratë e papunësuara, punonjësit, punëdhënësit, si dhe qendrat e kujdesit për fëmijë, lidhur me kërkesën dhe ofertën për shërbime të kujdesit për fëmijë. Pas përmbledhjes së përfundimeve kyçe të nxjerra nga këto të dhëna burimore, RrGGK-ja shtjellon modelet e ndryshme potenciale për rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë në Kosovë. Më pas, RrGGK-ja paraqet mundësitë për zgjerimin e kujdesit për fëmijë në secilën nga pesë zonat gjeografike të studiuar. Dhe në fund, ofrohen rekomandime shtesë për institucione specifike. Shtojcat përmbajnë informata të mëtejme lidhur me PPSE-në, metodologjinë, qendrat e kujdesit për fëmijë, interesin e punonjësve në kujdesin për fëmijë, interesin e punëdhënësve në kujdesin për fëmijë, si dhe instrumentet e përdorura për anketim.

## Metodologjia

Në këtë pjesë përmbledhet metodologjia e përdorur për të siguruar informata për këtë hulumtim.<sup>29</sup> Pesë zona gjeografike që ishin zgjedhur për këtë studim janë: Prishtina, Peja, Gjakova, Kamenica dhe Kosova veriore, duke përfshirë Mitrovicën e Veriut, Leposaviqin, Zubin Potokun dhe Zveçanin. Këto komuna ishin përzgjedhur duke përdorur variantën e marrjes së mostrave, duke marrë parasysh lokacionet e tyre të ndryshme gjeografike, demografinë, veprimtaritë ekonomike, si dhe etnitë e shumëllojshme. Rezultatet mund të jenë të përgjithësueshme ose me vlefshmëri ekologjike me komunat tjera, megjithatë dallimet duhet të merren parasysh.

Në këtë hulumtim, të kryer gjatë vitit 2016, janë përdorur metoda të përziera. Anketat janë administruar duke përdorur pyetësor elektronik të mbështetur nga “KoBo Collect”. Së pari, në mënyrë që të vlerësohej kërkesa për shërbime të kujdesit për fëmijë, janë kryer intervista me 519 punonjës të kompanive, duke përfshirë gratë (64%) dhe burrat (36%). Kompanitë janë përzgjedhur në bazë të madhësisë (më shumë se 20 punonjës), sektorit dhe potencialit për të investuar në kujdes për fëmijë. Përafërsisht dhjetë punonjës janë intervistuar në çdo kompani. Pyetjet kishin të bënin me demografinë, fëmijët, shërbimet e kujdesit për fëmijë që janë në dispozicion, si dhe mendimet për kujdesin për fëmijë.

Së dyti, përmes metodës së rastit RrGGK-ja ka anketuar 491 gra të papunësuara me fëmijë të moshës gjashtë vjeç dhe më të vegjël. Kjo anketë kishte për synim të vlerësojë nivelin e kërkesës për kujdes për fëmijë në mesin e grave të papunësuara, duke përfshirë edhe shërbimet aktualisht në dispozicion të kujdesit për fëmijë, përdorimin e mëhershëm të shërbimeve të tilla, interesimin për përdorimin e shërbimeve të tilla, si dhe për atë se a do t’iu mundësonte të kërkonin punësim me pagesë nëse kujdesi për fëmijë do të ishte në dispozicion.

Së treti, RrGGK-ja ka anketuar 51 qendra të kujdesit për fëmijë për të kuptuar shërbimet në dispozicion, sfidat e hasura dhe koston e kujdesit. Nga qendrat e anketuara, 41% ishin nga Prishtina, që pasqyron faktin se shumica e qendrave gjenden në kryeqytet. Gjithashtu, RrGGK-ja ka bërë telefonata dhe ka dërguar e-maile qendrave të regjistruara të kujdesit për të mbledhur informata lidhur me kapacitetin, shkallën e vendeve të lira dhe listat e pritjes.

Së katërti, RrGGK-ja ka intervistuar 61 punëdhënës nga të njëjtat kompani ku janë anketuar punonjësit, dhe ku është diskutuar interesi i tyre për të mbështetur qendrat e kujdesit për fëmijë.

Së pesti, RrGGK-ja ka intervistuar zyrtarë nga secila komunë, duke përfshirë Mitrovicën e Veriut për pjesën veriore të Kosovës, duke pasur parasysh se atje janë të përqendruara më shumë biznese dhe veprimtari ekonomike. Zyrtarët janë përzgjedhur në bazë të pozitave të tyre. Këtu janë përfshirë personat të cilët do të duhej të përfshiheshin në themelimin e qendrave të kujdesit për fëmijë nga departamentet e planifikimit urban, pronës, financave, arsimit dhe shërbimeve sociale.<sup>30</sup>

<sup>29</sup> Shtojca 2 ofron hollësi të mëtejme rreth metodologjisë.

<sup>30</sup> Për më shumë informata, ju lutemi të shihni Shtojcën 7.

Pjesë e këtij hulumtimi po ashtu ka qenë edhe shqyrtimi i kornizës ligjore përkatëse; shqyrtimi i literaturës për konceptet dhe teoritë përkatëse, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ekonominë e kujdesit dhe buxhetimin gjinor; si dhe shqyrtimi dokumentar i publikimeve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me kujdesin për fëmijë në Kosovë dhe në vende të tjera. RrGGK-ja gjithashtu është mbështetur në statistikat ekzistuese demografike dhe arsimore.

## Korniza ligjore e Kosovës lidhur me kujdesin për fëmijë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban Konventën për të Drejtat e Fëmijës, e cila njih të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë "të drejtën për mbrojtje dhe kujdes të nevojshëm për mirëqenien e tyre."<sup>31</sup> Meqenëse fëmijët për të cilët kujdesen të dy prindërit dhe që shkojnë në institucione parafillore priren të kenë rezultate më të mira në shkollë, kujdesi i tillë për fëmijë kontribuon në mirëqenien e tyre.<sup>32</sup> Kushtetuta e konsideron edhe KEGjFDG-në si të zbatueshme drejtpërdrejtë në Kosovë,<sup>33</sup> dhe në KEGjFDG thuhet se:

Për të parandaluar diskriminimin ndaj gruas për shkaqe martesore ose maternitetit, dhe për të siguruar të drejtën e saj efektive për punë, shtetet palë marrin masa të përshtatshme: [...] Për të inkurajuar sistemin e shërbimeve sociale mbështetëse të nevojshme që t'i mundësojnë prindërit të gërshetojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë në vendin e punës, dhe të marrin pjesë në jetën publike, sidomos duke nxitur themelimin dhe zhvillimin e një rrjeti qendrash për kujdesin e fëmijëve.<sup>34</sup>

Kësisoj, institucionet e Kosovës kanë përgjegjësinë ligjore të marrin masa për t'u siguruar që qendrat e kujdesit për fëmijë janë në dispozicion.

Prindërit janë po ashtu bartës të detyrës kur është fjala për kujdesin për fëmijët e tyre. Në KEGjFDG thuhet se "prindërit kanë të drejta dhe përgjegjësi të njëjta si prindër, pavarësisht nga gjendja martesore, për ato çështje që kanë të bëjnë me fëmijët."<sup>35</sup> Më konkretisht, sipas Ligjit të Familjes të Kosovës, marrëdhëniet familjare mbështeten në parimet e "barazisë midis burrit dhe gruas, respektit dhe ndihmës së ndërsjellë midis tyre dhe anëtarëve të familjes"; dhe "mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe përgjegjësisë e të dy prindërve për rritjen dhe arsimimin e fëmijëve të tyre."<sup>36</sup> Kjo i bën gratë dhe burrat përgjegjës për rritjen e fëmijëve të tyre, gjë e cila ndoshta ka të bëjë edhe me kujdesin për fëmijë dhe financimin e tij, aty ku është e nevojshme. Më përgjithësisht, edhe Ligji i Kosovës për Barazi Gjinore parashikon se gratë dhe burrat marrin pjesë në mënyrë të barabartë në të gjitha fushat e shoqërisë.<sup>37</sup> Kësisoj, si nënat, ashtu edhe baballarët kanë përgjegjësi në sigurimin e qasjes në kujdes cilësor për fëmijët e tyre. Nga kjo del se asnjë nga bashkëshortët nuk duhet të jetë medoemos bartës i barrës së kostos për kujdesin e fëmijës. Nuk duhet të supozohet që gratë duhet të paguajnë për kujdesin e fëmijëve nga paga e tyre sepse, kulturalisht, ato me gjasë do të kujdeseshin për fëmijët e tyre po të mos ishin në punë. Është e kuptueshme se niveli i të ardhurave të bashkëshortëve mund të jetë një faktor vendimtar në mënyrën se si familja vendos të financojë kujdesin për fëmijët.<sup>38</sup>

Qendrat e kujdesit për fëmijë, arsimit parashkollor dhe të gjitha format e kujdesit në Kosovë rregullohen me Ligjin nr. 2006/02-L-52 për Arsimin Para-shkollor. Ky ligj përfshin në vetvete Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Arsimit i ofruar nga qendrat e kujdesit duhet të mbështetet në parimet e barazisë, përfshirjes, demokracisë, autonomisë së stafit, profesionalizmit, përgjegjësisë dhe të drejtës për të qenë të ndryshëm. Në Kosovë "arsimi parashkollor" i referohet arsimit të hershëm për fëmijët e shkollës parafillore, duke përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta. Fëmijët me moshë nëntë deri në gjashtë vjeç

<sup>31</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 50, marrë nga: <http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>.

<sup>32</sup> Instituti për Studime Fiskale, Alissa Goodman dhe Barbara Sianesi, *Early Education and Children's outcomes: How long do the impact last?*, [Arsimi i hershëm dhe rrezultatet e fëmijëve: sa zgjasin këto ndikime?] korrik 2005, marrë nga: [http://www.ifs.org.uk/docs/ee\\_impact.pdf](http://www.ifs.org.uk/docs/ee_impact.pdf).

<sup>33</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

<sup>34</sup> CEDAW, neni 11, paragrafi 2 dhe 2(c).

<sup>35</sup> CEDAW, Art. 16(d).

<sup>36</sup> Neni 3, paragrafët 1 dhe 2

<sup>37</sup> Neni 3, paragrafi 1.10

<sup>38</sup> Nga 129 prindër të punësuar që RrGGK ka anketuar, 22% thanë se nëna e paguan kujdesin e fëmijëve; 19% babai; ndërsa 59% thanë se të dy prindërit e ndajnë pagesën.



preferohet të futen në institucionet parashkollore. Arsimi parashkollor ka dy grup-mosha: çerdhe për fëmijët nga nëntë muaj deri në 3 vjeç, dhe kopshtet, ku përfshihen fëmijët nga tre deri në gjashtë vjeç.<sup>39</sup> Në këtë raport, RrGGK-ja i referohet të gjitha grup-moshave dhe institucioneve së bashku me termin "qendra të kujdesit për fëmijë". Qendrat publike të kujdesit për fëmijë financohen nga komunat, ndërsa institucionet private financohen nga persona juridikë privatë pas licencimit të tyre nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Të gjitha qendrat publike dhe private të kujdesit për fëmijë duhet të regjistrohen si institucione parashkollore dhe të licencohen nga MASHT-i.<sup>40</sup> MASHT-i mund t'i mbyllë institucionet parashkollore nëse ato nuk licencohen.<sup>41</sup>

Të gjithë edukatorët/et në shkollat publike duhet të kenë diplomë universitare në fushën e arsimit të hershëm për fëmijët.<sup>42</sup> Kjo kërkesë nuk aplikohet për ofruesit asistentë të kujdesit për fëmijë dhe as në institucionet private parashkollore apo shkollat me bazë në komunitet. Asistentët publikë parashkollorë duhet të kenë një diplomë nga arsimi i mesëm nga një program për arsimin parashkollor apo diplomë të arsimit të mesëm "të plotësuar me trajnime të përshtatshme profesionale të certifikuara nga MASHT-i."<sup>43</sup> Mësimdhënia kryhet në gjuhën shqipe, por nëse popullsia përbëhet nga enti të ndryshme, institucionet duhet të sigurojnë komunikimin në gjuhën e grupit (grupeve) minoritare etnike.<sup>44</sup> MASHT-i ofron mbikëqyrjen pedagogjike dhe profesionale të arsimtarëve. Institucionet e tjera ofrojnë forma të tjera të mbikëqyrjes. Për shembull, Ministria e Arsimit, midis institucioneve të tjera, duhet të monitorojë cilësinë e ushqimit që iu jepet fëmijëve.<sup>45</sup> Qendrat për Punë Sociale ndjekin kujdesin social dhe adresojnë rastet në të cilat punonjësit e kujdesit dyshojnë se një fëmijë mund të jetë kryerës apo viktimë e dhunës.<sup>46</sup> Inspektimi për Arsimin duhet të marrë masa dhe/ose sanksione nëse institucionet parashkollore shkelin Ligjin për Edukimin Parashkollor, rregulloret e ndërlidhura dhe udhëzimet administrative (p.sh. duke tejkuluar numrin e fëmijëve për edukatorë/e).<sup>47</sup>

MASHT-i ka miratuar Kurrikulën për Arsimin Para-shkollor (për tre deri gjashtë vjeçarët) dhe Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme për Fëmijët nga 0 deri 6 vjeç.<sup>48</sup> Standardet paraqesin "arritjet e pritshme të fëmijëve në mosha të caktuara në fusha të ndryshme të zhvillimit dhe gjithashtu ofrojnë modelet dhe nismat lidhur me mënyrën se si të përkrahen dhe inkurajohen fëmijët për t'i arritur këto standarde."<sup>49</sup> MASHT-i aktualisht është duke rishikuar planprogramin mësimor për të siguruar shërbime cilësore parashkollore, me përkrahjen e Fondit për Fëmijë të Kombeve të Bashkuara E caktuar për t'u përfunduar nga fundi i vitit 2016, planprogrami do të jetë në harmoni me Kornizën e Kurrikulës të Kosovës dhe do të harmonizohet me Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme (SZHMFH) për fëmijët e moshës nga zero në gjashtë vjeç.<sup>50</sup>

<sup>39</sup> Republika e Kosovës, Udhëzimi Administrativ i MASHT-it, nr. 19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucionet Parashkollore në Kosovë, neni 2, marrë nga: <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/09/19-ua-nr-19-2016-per-perfshirjen-e-femijeve-ne-institucionet-parashkollore-ne-kosove-rotated.pdf>.

<sup>40</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji nr. 2006/02-L-52 për Edukimin Parashkollor, 2006, neni 46, marrë nga: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006\\_02-L52\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L52_al.pdf).

<sup>41</sup> Po aty, Neni 41 (2).

<sup>42</sup> Po aty, Neni 28 (4).

<sup>43</sup> Po aty, Neni 28 (8).

<sup>44</sup> Po aty, Neni 5 (parag 5. 1, 5. 2).

<sup>45</sup> Po aty, Neni 38 (parag 38.4). Në versionin në gjuhën shqipe të ligjit, organi përgjegjës për inspektimin e ushqimit dhe mbrojtjes së shëndetit është Inspektimi Sanitar i Komunës. Më tej, Ligji për Inspektimin e Arsimit në Kosovë thotë se ata janë përgjegjës për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve në institucionet parashkollore (Ligji për 2004/37 për Inspektimin e Arsimit në Kosovë, neni 4, paragrafi 3, marrë nga: [http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004\\_37\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_37_al.pdf)).

<sup>46</sup> Rregullorja e QRK-së nr. 02/2013 për Protokollin dhe për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-Universitar, neni 6, paragrafi 1.7, marrë nga: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/rregullore-qrk-nr-21-2013-per-protokollin-per-parandalimin-dhe-referim.pdf>.

<sup>47</sup> Ligji për Inspektimin e Arsimit në Kosovë, neni 5,6,7.

<sup>48</sup> Republika e Kosovës, MASHT, "Standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme 0-6 Vjet", fq. 5, marrë nga:

[https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web\\_1.pdf](https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/elds-report-alb-for-web_1.pdf)

<sup>49</sup> Po aty.

<sup>50</sup> Korrespondencë elektronike me UNICEF-në, 11 tetor 2016.

Çdo vit, Këshilli Drejtues i secilit institucion parashkollor duhet të përgatisë dhe të paraqesë planin dhe programin e institucionit. Më tej, Këshilli Drejtues i institucionit parashkollor, në bashkëpunim me këshillin e prindërve, duhet ta miratojnë atë.<sup>51</sup> Plani, mes çështjeve të tjera, duhet të përfshijë orët e punës, kujdesin për fëmijët, programet për ndërtimin e kapacitetit, metodologjinë, kujdesin shoqëror, bashkëpunimin e qendrave të kujdesit me prindërit, marrëdhëniet e komunitetit dhe programet edukative.

Një udhëzim administrativ i vitit 2008 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucionet Parashkollore rregullon numrin e fëmijëve për klasë. Të paktën dy edukatorë/e duhet të shoqërojnë secilën grup-moshë (shihni tabelën 1).<sup>52</sup> nëse kërkesa për kujdes është më e lartë dhe hapësirat janë të pamjaftueshme, atëherë numri i fëmijëve mund të rritet në se lejohet nga drejtoritë arsimore komunale. Të njëjtat udhëzime rregullojnë përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet parashkollore.

Edhe korniza ligjore e Kosovës specifikon kushte të caktuara që institucionet private duhet të përmbushin për t'u licencuar për ofrim të shërbimeve për kujdes të fëmijëve.<sup>53</sup> Për shembull, hapësira fizike në klasa duhet të jetë të paktën dy metër katrorë për fëmijë, një oborr, një mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë, ndriçim natyror, tualete (deri në 10 fëmijë të vegjël ose fëmijë dhe kabina të ndara për të dyja gjinitë) dhe pajisje sanitare. Më tej, mjedisi i jashtëm i qendrës, oborri duhet të ketë të paktën pesë metër për fëmijë dhe të jetë i sigurtë nga çdo rrezik potencial.<sup>54</sup> I njëjti udhëzim administrativ ofron kërkesat që lidhen me shërbimin e ushqimit, ruajtjen e ushqimit (më së shumti deri në 24 orë dhe ushqimi i nxehtë duhet të shërbehet 60 gradë celsius ose më i ftohtë) dhe plotësimin e nevojave individuale të fëmijëve.<sup>55</sup> Kërkesat e qendrave të kujdesit për fëmijë, sidomos kërkesat hapësinore në zonat urbane, janë cituar si sfiduese nga pronarët e institucioneve parashkollore.<sup>56</sup>

Strategjia Kombëtare e Kosovës për Zhvillim për 2016-2021 (SKZh) ka identifikuar frekuentim të ulët të arsimit të hershëm (i cili citohet të jetë midis 25 dhe 30%) si një sfidë e rëndësishme zhvillimore. Një krahasim i të dhënave demografike ekzistuese me të dhënat për nxënësit nën gjashtë vjeç të përfshirë në programe arsimore lë të kuptohet se vetëm rreth 15.5% e të gjithë fëmijëve nën gjashtë vjeç janë përfshirë në programet arsimore në vitin 2015.<sup>57</sup> Raporti i Progresit i BE-së për vitin 2015 për Kosovë vlerësonte, më dukshëm, se vetëm 4.5% e fëmijëve nga zero në pesë vjeç frekuentonin arsimin parashkollor.<sup>58</sup> Prandaj, nevoja duket se është më e madhe sesa ajo që ka vlerësuar SKZh-ja. Gjithmonë e më shumë, frekuentimi i arsimit të hershëm është një prej qëllimeve të SKZh-së. "duke rritur numrin e kopshteve publike dhe duke rritur përfshirjen përmes institucioneve private."<sup>59</sup>

**Tabela 1. Nr. maksimal i fëmijëve për grup arsimor sipas moshës**

Grupmosha	Nr. ideal i fëmijëve	Nga nr. min. te nr. maks.
9 muaj – 1 vj	8	6-10
1-2 vjeç	12	10-14
2-3 vjeç	14	12-16
3-4 vjeç	20	18-22
4-5 vjeç	22	20-24
5-6 vjeç	24	22-26
1-3 vjeç	10	8-12
3-6 vjeç	20	18-23

<sup>51</sup> Ligji për Edukim Parashkollor, neni 10, paragrafi 10.2, 10.5.

<sup>52</sup> Republika e Kosovës, MASHT, Udhëzimi Administrativ për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucionet Parashkollore, 2008, marrë nga: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7562>, paragrafi 3.

<sup>53</sup> MASHT, Udhëzimi Administrativ nr. 15/2016 për Licencimin dhe Regjistrimin e Institucioneve Edukativo-Arsimore Parashkollore Private.

<sup>54</sup> Po aty, nenet 4 dhe 8

<sup>55</sup> Po aty, neni 15.

<sup>56</sup> Diskutim i RrGGK-së me pronarë të institucioneve parashkollore, 2015.

<sup>57</sup> RrGGK-ja e ka përlogaritur këtë duke u mbështetur në numrin e fëmijëve nën gjashtë vjeç, të cilët janë përfshirë në programin e arsimit publik dhe privat në vitin 2015, të ndarë sipas numrit të përgjithshëm të fëmijëve nën gjashtë vjeç që jetonin në Kosovë në vitin 2015. Numri i përgjithshëm i fëmijëve nën gjashtë vjeç llogaritet duke u mbështetur në të dhënat e ASK-së. Nga numri i lindjeve të gjalla çdo vit që prej vitit 2010 deri në vitin 2015, RrGGK-ja ka zbritur numrin e vdekjeve në atë grup-moshë për të nxjerrë numrin e fëmijëve të gjallë nën moshën gjashtë vjeçare.

<sup>58</sup> BE, Commission Staff Working Document, *Kosovo, 2015 Report*, [Raporti për Kosovë, 2015] fq. 46, marrë nga: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf).

<sup>59</sup> Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Strategjia Kombëtare e Zhvillimit për periudhën 2016-2021 (SKZh), faqe 11, marrë nga: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia\\_Kombetare\\_per\\_Zhvillim\\_2016-2021\\_Shqip.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf).

Më tej, në kontekstin e anëtarësimit të Kosovës në BE, ekzistojnë disa arsye për rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë. Së pari, Raporti i Progresit për vitin 2015 i BE-së përmend shprehimisht frekuentimin e ulët të arsimit parafillor nga fëmijët dhe e nxit Kosovën të përmirësojë qasjen në arsim cilësor. Së dyti, Raporti i Progresit ka vënë në dukje se Kosova duhet të adresojë numrin e lartë të papunësisë në radhët e grave.<sup>60</sup> Kjo do të bëjë të nevojshme rritjen e qasjes në shërbime të kujdesit për fëmijë. Së treti, lidhur me mundësitë e barabarta, në Raportin e Progresit vihet në dukje se Ligji për Barazi Gjinore është miratuar, por zbatimi duhet të përmirësohet, sidomos lidhur me papunësinë e lartë të grave. Më tutje, në të thuhet se "dispozitat e pamjaftueshme lidhur me lejet e lehonisë i minojnë përpjekjet për të trajtuar diskriminimin kundër grave në vendin e punës, sidomos në sektorin privat."<sup>61</sup> RrGGK-ja ka argumentuar tjetërkund se rritja e mundësive të kujdesit për fëmijë përkrahë mundësinë që nënat e reja t'i kthehen punës.<sup>62</sup> Edhe direktiva 2006/54/KE inkurajon ofrimin e qendrave të qasshme dhe të përbalueshme ekonomikisht për kujdesin për fëmijët si një prej mënyrave që vendet anëtare duhet të ndjekin për të adresuar "problemin e vazhimit të diferencave në pagë me baza gjinore dhe ndarjes së dukshme gjinore në tregun e punës"<sup>63</sup> Së katërti, Raporti i Progresit ka vënë re se Kosova duhet të zvogëlojë informalitetin,<sup>64</sup> gjë e cila do të kërkojë një përmirësim të të kuptuarit të asaj se kush punon në vendet informale të punës nga perspektiva gjinore, me qëllim që të merren masat e duhura, duke shmangur çdo diskriminim të qëllimtë apo të paqëllimtë me bazë gjinore, i cili mund të ndodh gjatë marrjes së masave për të adresuar informalitetin.

## Objektivat e BE-së të Barcelonës: Zhvillimi i kujdesit për fëmijë

Sipas KE-së,<sup>65</sup> "mundësitë në dispozicion të qendrave cilësore dhe të përbalueshme të kujdesit për fëmijë, për fëmijët e vegjël nga lindja deri në arritjen e moshës së detyrueshme për shkollim, janë një prioritet për Bashkimin Evropian."<sup>66</sup> Prandaj, KE ka krijuar "Objektivat e Barcelonës", në të cilat thuhet se:

Shtetet Anëtare duhet të heqin pengesat për pjesëmarrjen e krahut të punës nga radhët e grave, duke marrë parasysh kërkesën për qendra të kujdesit për fëmijë dhe në pajtim me modelet kombëtare të ofrimit, për të ofruar kujdes për fëmijë deri në vitin 2010 për të paktën 90% të fëmijëve nga 3 vjeç deri në moshën kur ndjekja e shkollës bëhet e detyrueshme dhe për të paktën 33% të fëmijëve nën 3 vjeç.<sup>67</sup>

Sipas Objektivave të Barcelonës, investimi në përkujdes cilësor për fëmijë është një investim thelbësor në zhvillimin e fëmijëve, në parandalimin e braktisjes së shkollës dhe për t'iu mundësuar grave të marrin pjesë në tregun e punës. më tej, rritja e pjesëmarrjes së prindërve, sidomos e grave, në tregun e punës,

<sup>60</sup> KE, *Kosovo, 2015 Report* [Kosova, Raporti për vitin 2015] fq. 45.

<sup>61</sup> Po aty.

<sup>62</sup> KWN, *Arritja e ekuilibrit: Opsionet e politikave që synojnë të informojmë amandamentimin e Ligjit të Punës në Kosovë*, Prishtinë: RrGGK, 2016, marrë nga: <http://www.womensnetwork.org/documents/20160504154201554.pdf>.

<sup>63</sup> Direktiva 2006/54/KE pëlr zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe punëzënies (11).

<sup>64</sup> KE, *Kosovo, 2015 Report* [Kosova, Raporti për vitin 2015] fq. 36.

<sup>65</sup> Një draft fillestar për këtë pjesë është shkruar nga Nerina Guri, Nicole Farnsworth dhe Donjeta Morina për RrGGK-në si pjesë e një flete pune të papublikuar, të titulluar *Kosova dhe Ekonomia e Kujdesit*, pjesë të së cilës janë paraqitur në konferencës e UBT-së për Ekonominë Gjinore në vitin 2015.

<sup>66</sup> Objektivat e BE-së të Barcelonës: *Zhvillimi i objekteve për kujdesin ndaj fëmijëve, për fëmijët e vegjël në Evropë, në vështrim të rritjes së qëndrueshme dhe përfshirëse* [The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth], fq. 5, marrë nga: [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/130531\\_barcelona\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/130531_barcelona_en.pdf).

<sup>67</sup> Po aty.

e zvogëlon rrezikun e varfërisë, nxit përfshirjen shoqërore të të gjithë anëtarëve të familjes dhe përmirëson të ardhmen e fëmijëve.<sup>68</sup> Ndërkohë që Kosova ende nuk është anëtare e BE-së, Objektivat e Barcelonës kanë përcaktuar synime të qarta, të mbështetura në prova, të cilat Kosova mund dhe duhet të përpiqet t'i përmbushë.

Duke përdorur synimet e përcaktuara nga Objektivat e Barcelonës, RrGGK-ja ka përdorur të dhënat demografike dhe ato për përfshirjen në arsimin parashkollor për të përlogaritur shkallën në të cilën përmbushen nivelet aktuale të kërkesës për kujdesin për fëmijë. Në vitin 2015, në Kosovë jetonin 79,092 fëmijë të moshave tre vjeç ose më të vegjël (shihni tabelën 2).<sup>69</sup> Sipas Objektivave të Barcelonës, 26,100 fëmijë duhet të kenë qasje në kujdesin për fëmijë. Gjatë vitit shkollor 2015-2016, vetëm 1,527 fëmijë të kësaj grup-moshe janë regjistruar në arsimin publik.<sup>70</sup> Vlerësohet se 264 fëmijë të kësaj grup moshe janë regjistruar në kujdesin privat për fëmijë<sup>71</sup>. Në pajtim me synimin e Objektivave të Barcelonës prej 33%, kjo nënkupton që 24,309 fëmijë ishin pa kujdesje.

Numri i fëmijëve të moshës nga tre deri në gjashtë vjeç në vitin 2015 ishte 94,723.<sup>72</sup> Të paktën 85,251 fëmijë në këtë grup-moshë duhet të kishin në dispozicion kujdesin për fëmijë. Vetëm 24,043 fëmijë nga mosha tre deri në gjashtë vjeç janë përfshirë në institucionet parashkollore publike dhe në programet e arsimit para-fillor gjatë vitit shkollor 2015-2016.<sup>73</sup> Përafërsisht 1,090 fëmijë të tjerë të kësaj grup moshe janë përfshirë në kujdesin privat për fëmijë<sup>74</sup>. Prandaj, 60,118 fëmijë të moshës tre deri në gjashtë vjeç ende kanë nevojë për kujdes, sipas Objektivave të Barcelonës.<sup>75</sup>

Tabela 2. Përlogaritja e pozitave të reja dhe të ardhurave të edukatorëve/eve nëse dëshirojmë të arrihen Objektivat e Barcelonës							
Grupmosha	0-1	1-2	2-3	3-4	4-5	5-6	
Fëmijë në Kosovë	24,356	25,709	29,027	27,401	33,902	33,420	
Objektivat e Barcelonës (OB)	33%			90%			
# minimal i fëmijëve që kanë nevojë për kujdes në pajtim me OB	8,037	8,484	9,579	24,661	30,512	30,078	
Fëmijë të përfshirë në programet e arsimit publik	689		838	1,087	1,301	Parashkollorë 1,313	Para-fillorë 20,342
Fëmijë të përfshirë në programet e arsimit privat	94		170	272	341	408	69
Fëmijë ende në nevojë për kujdes në pajtim me OB	15,738		8,571	23,302	28,870	7,946 482   7,464	
# i pozitave të reja për edukatorë/e	3,148		1,224	2,330	2,625	662	
Pagat e reja vjetore për edukatorë/e	50,644,178€						
Të ardhurat vjetore (taksat) shtetërore	2,266,702€						

Gjatë vitit shkollor 2015-2016, raporti i nxënësve për edukatorë/e për fëmijët nën moshën gjashtë vjeçare ishte 9.9 nxënës për edukatorë/e.<sup>76</sup> Për fëmijët e moshës pesë deri në gjashtë vjeç, në

<sup>68</sup> Po aty.

<sup>69</sup> Qeveria e Kosovës, ASK, *Statistikat e lindjeve 2013, 2014, 2015 dhe Statistikat e vdekjeve 2013, 2014, 2015*. RrGGK-ja e ka llogaritur këtë duke mbledhur numrin e lindjeve në Kosovë në periudhën 2013-2015 dhe duke zbritur numrin e vdekjeve në secilën grup-moshë në vitin 2013 dhe 2015.

<sup>70</sup> Qeveria e Kosovës, ASK, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015-2016*, Prishtinë: 2016, fq. 22, marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/sq/statistikat-e-arsimit#>.

<sup>71</sup> Po aty. Fq. 60.

<sup>72</sup> Llogaritje të RrGGK-së mbështetur në Qeverinë e Kosovës, ASK, *Statistikat e lindjeve 2010, 2011, 2012 dhe Statistikat e vdekjeve 2010, 2011, 2012*.

<sup>73</sup> Qeveria e Kosovës, ASK, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015-2016*, fq. 22.

<sup>74</sup> Po aty. Fq. 60.

<sup>75</sup> Llogaritur nga RrGGK-ja si 85,251 - (24,043+1,090).

<sup>76</sup> Qeveria e Kosovës, ASK, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2015-2016*, fq. 53.

arsimin para-fillor, raporti ishte 22.4 nxënës për edukatorë/e.<sup>77</sup> Ndoshta, raportet aktuale nxënës- edukatorë/e nuk janë në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucionet Parashkollore, i cili rekomandon dy edukatorë/e për çdo dhjetë fëmijë nën tre vjeç dhe dy edukatorë/e për çdo njëzet fëmijë nga tre deri në gjashtë vjeç. Mbështetur në numrin maksimal të fëmijëve për edukatorë/e, të cilët lejohen ligjërisht, RrGGK-ja vlerëson se së paku do të ishin krijuar 9,989 vende pune përmes hapjes së qendrave të reja për përmbushjen e Objektivave të Barcelonës<sup>78</sup>. Do të ishin krijuar pozita të tjera edhe për punonjësit e qendrave të tjera të kujdesit, si dhe për përgatitjen e ushqimit, pastrimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin. Më tej, rritja e mundësive të kujdesit për fëmijë do të bënte që të rritej numri i kujdestarëve të fëmijëve të cilët kërkojnë aktivisht të punësohen në profesione të ndryshme, duke ulur papunësinë dhe duke rritur pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.

Duke përdorur qasjen e të ardhurave për të llogaritur produktin e brendshëm bruto (PBB), PBB-ja do të rritej me 50,644,178€ çdo vit.<sup>79</sup> Kontributet nga taksat, të paguara nga çdo person i sapopunësuar në qendrat e kujdesit llogaritet të kapte shifrën e përafërsisht 2,266,702€ në vit.<sup>80</sup>

## Kërkesa për kujdes për fëmijë te gratë e papunësuar

Në këtë pjesë trajtohet kërkesa për kujdes për fëmijë në radhët e grave të cilat aktualisht nuk janë të punësuar. Të gjitha respondentet e përzgjedhura rastësisht nga pesë komuna kishin fëmijë nën moshën gjashtë vjeçare. RrGGK-ja ka anketuar vetëm gra të cilat ishin të papunësuar, të përcaktuara në vija të përgjithshme si gra që nuk punojnë për të fituar të ardhurat e tyre. Për këtë arsye, mostra përfshinte gratë të cilat kryenin punë pa pagesë në shtëpi ose që kontribuonin në bizneset e familjeve të tyre, por vetë nuk merrnin të ardhura.

Kur u kërkua nga gratë të përshkruanin statusin e tyre aktual të punësimit, pjesa më e madhe e tyre (56%) thanë se aktualisht bënin punë pa pagesë në shtëpi, duke përfshirë edhe kujdesin për fëmijë, kujdesin për të moshuarit, punët në kopsht dhe punët në shtëpi; 34% thanë se ishin të papunësuar, por ishin duke kërkuar për punë; dhe 21% thanë se janë të papunësuar por se nuk po kërkonin punë. Gratë në Prishtinë (40%) dhe në Gjakovë (44%) kishin më shumë të ngjarë të ishin në kërkim të ndonjë vendi pune sesa gratë në Pejë (22%) dhe Kamenicë (10%).<sup>81</sup> Nuk kishte diferencë të konsiderueshme midis zonave urbane dhe rurale: 36% e grave në zonat urbane ishin në kërkim të një pune, krahasuar me 30% të atyre në zonat rurale.<sup>82</sup> Gratë më shumë të shkolluara kishin më shumë të ngjarë të kërkonin punë,<sup>83</sup> ndërsa gratë me dy apo më shumë fëmijë kishin më pak të ngjarë ta bënin këtë.<sup>84</sup> Kësisoj, të kesh shumë fëmijë ka gjasa të kontribuojë që gratë të kenë më pak mundësi të kërkojnë të punësohen.

Grave iu kërkua të tregonin se pse nuk punonin në një pozitë me pagesë, me mundësinë e përzgjedhjes së njëres prej përgjigjeve (shihni Grafikon 1).

Ndër arsyet kryesore ishin: nuk kishin mund të gjenin punë (60%); bënin punë përkujdesjeje në shtëpi (për fëmijët, për të moshuarit, për personat me aftësi të kufizuara) (39%); dhe bënin punë në shtëpi (gatim, pastrim, etj.) (29%). Më tej, 14% thanë se mungesa e kujdesit për fëmijë kontribuon në papunësinë e tyre. Gratë në Prishtinë kishin më pak të ngjarë ta konsideronin përkujdesin në shtëpi si shkak për papunësinë e tyre.<sup>85</sup>

<sup>77</sup> Po aty.

<sup>78</sup> Llogaritjet e RrGGK në lidhje me numrin e duhur të edukatorëve/eve janë bërë duke u bazuar në grup moshë brenda Udhëzuesit Administrativ, duke e përdorur medianen për grupet edukative për fëmijë sipas moshës.

<sup>79</sup> Përllogaritjet e RrGGK-së mbështeten në supozimin se gjysma e edukatorëve/eve do të kishin diploma universitare dhe do të paguheshin njëllor si edukatorët/et para-shkollorë publikë (462€ bruto, 416.99€ neto) dhe gjysma do të ishin asistentë të edukatorëve/eve, më pak të kualifikuar e më pak të paguar, pagë të njejtë si për ndihmës edukatorët/et e punësuar në kopshtet publike, (383€ bruto, 347.94€ neto) Mesatarja e këtyre dy numrave (422.5€ bruto) është shumëzuar me 9,989 vende pune.

<sup>80</sup> Llogaritja e RrGGK-së është bërë në përputhje me udhëzimet e ATK, në: <http://www.atk-ks.org/8285-2>.

<sup>81</sup>  $P < 0.001$


<sup>82</sup>  $P = 0.18$

<sup>83</sup>  $P < 0.01$

<sup>84</sup>  $P < 0.001$

<sup>85</sup>  $P < 0.001$

**Grafikoni 1. Arsyet kryesore pse gratë nuk punojnë për para (%)**



Gratë në Prishtinë dhe Kamenicë ishin më pak të gatshme të përdornin kujdesin për fëmijë sesa gratë në Pejë dhe Gjakovë: 21% në Prishtinë dhe 23% në Kamenicë thanë se *nuk* do ta merrnin parasysh përdorimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijë, krahasuar me 6% në Pejë dhe 12% në Gjakovë.<sup>86</sup> Ndonëse është kështu, shumica dërmuese e grave (85%) thanë se do të merrnin parasysh përdorimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijë.<sup>87</sup> Nga gratë të cilat dëshironin të përfshiheshin në punë të paguar, 88% thanë se do të merrnin parasysh përdorimin e kujdesit për fëmijë.<sup>88</sup> Nga ato që nuk dëshironin të bënin punë me pagesë, 54% gjithsesi do ta përdornin kujdesin për fëmijë.<sup>89</sup> Shkaqet më të zakonshme për të cilat 76 respondente nuk do ta përdornin kujdesin për fëmijë ishin se ato donin t'i rrisnin vetë fëmijët e tyre (45%); nuk kanë nevojë për të (41%); nuk iu besojnë qendrave të kujdesit për fëmijë (17%); dhe qendrat e kujdesit për fëmijë janë shumë të shtrenjta (13%).

<sup>86</sup> P = 0.001

<sup>87</sup> 95% CI: 81%, 87%

<sup>88</sup> N = 390/445

<sup>89</sup> N = 25/46


Kostoja mesatare që gratë menduan se do të ishte për kujdesin për fëmijë për çdo fëmijë në muaj do të ishte 42 euro (shih tabelën 3).<sup>90</sup> Mesatarisht, gratë me më shumë fëmijë kishin prirje të besonin se kujdesi për fëmijë duhet të kushtojë 5 dollarë më pak për çdo fëmijë shtesë për muaj. Megjithatë, kjo nuk ishte statistikisht domethënëse.<sup>91</sup> Kostoja mesatare e preferuar e kujdesit për fëmijë ndryshonte në mënyrë të konsiderueshme nga komuna në komunë.<sup>92</sup> Mesatarisht, gratë në Prishtinë ishin të gatshme të paguanin 52 euro në muaj, në Pejë 38 euro, në Kamenicë 36 euro, në Gjakovë 29 euro, dhe në Veri të Mitrovicës 21 euro. Si mesatare, gratë në zonat urbane ishin të gatshme të paguanin 8.5 euro në muaj më shumë sesa gratë në zonat rurale.<sup>93</sup>

Në aspektin e shërbimeve që janë në dispozicion, 58% e grave thanë se shërbimet e kujdesit për fëmijë ekzistojnë në zonën e tyre. Gratë në Prishtinë kishin më shumë të ngjarë të kishin qasje në shërbimet e kujdesit për fëmijë sesa gratë në Pejë, Gjakovë dhe Kamenicë (grafiku 2).<sup>94</sup> Kjo nuk duhet të na habisë, nëse marrim parasysh se pjesa dërmuese e qendrave të kujdesit për fëmijë ndodhen në Prishtinë.<sup>95</sup> Gratë në zonat rurale kishin më pak të ngjarë të kishin në dispozicion kujdes për fëmijët; vetëm 19% e grave në zonat rurale, përkundër 83% të atyre në zonat urbane, thoshin se do t'i qaseshin kujdesit për fëmijë.<sup>96</sup> Në përgjithësi, nga 205 gra të cilat nuk kishin në dispozicion kujdes për fëmijët, 84% do të merrnin parasysh vendosjen e fëmijëve të tyre në qendrën e kujdesit për fëmijë nëse ajo do të ishte në dispozicion. Në mënyrë të ngjashme, nga 52 gra në zonat rurale pa opsione për kujdes për fëmijë, 85% do të merrnin parasysh përdorimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijë nëse ato do të ishin në dispozicion.

Sikurse ilustron në grafikun 3, gjërat që gratë më së shumti i marrin parasysh në përzgjedhjen e shërbimit të kujdesit për fëmijë janë ushqimi i shëndetshëm (65%), kushtet dhe pastërtia (64%), aktivitetet edukative (63%), stafi i kualifikuar (58%), siguria (47%) dhe çmimi i përballueshëm ekonomikisht (47%). Gratë me fëmijë nga tre deri në gjashtë vjeç kishin të ngjarë gati dy herë më shumë sesa gratë pa fëmijë të kësaj moshe që të përmendnin artet dhe zejet si prioritet.<sup>97</sup>

**Tabela 3. Mendimi për koston e kujdesit për fëmijë për muaj (€)**

Komuna	Mesa	SD	Median	Min	Max	N
Gjakova	29	14	25	10	100	108
Kamenicë	36	20	30	25	150	38
Veriu i Mitrovicës	21	8	20	0	30	14
Peja	38	13	35	20	100	110
Prishtina	52	18	50	20	150	219
<b>Gjithsej</b>	<b>42</b>	<b>19</b>	<b>40</b>	<b>0</b>	<b>150</b>	<b>489</b>



<sup>90</sup> SD: 19; Mediana: 40; IQR: 30 – 50

<sup>91</sup> 95% CI: -10, 0.3 €; p = 0.06

<sup>92</sup> P < 0.001. Nuk ka marrëdhënie midis koston së kujdesit për fëmijë dhe viteve të arsimit (p = 0.80) apo moshës (p = 0.11) së respondentës.

<sup>93</sup> 95% CI: 5, 12 €; p < 0.0001

<sup>94</sup> P < 0.001. Në Veriun e Mitrovicës, ka vetëm 12 përgjigje për këtë pyetje, kështu që, në aspektin statistikor, nuk mund të nxirren përfundime.


<sup>95</sup> MASHT. Për hollësi të mëtejshme, ju lutemi të shihni pjesën më poshtë pjesën për qendrat e kujdesit për fëmijë.

<sup>96</sup> P < 0.001

<sup>97</sup> P = 0.03

**Grafikoni 3. Konsideratat që merren parasysh me rastin e zgjedhjes së ofruesve të shërbimeve të kujdesit për fëmijë (%)**

■ Prishtinë ■ Pejë ▨ Gjakovë ■ Kamenicë ■ Mitrovica e Veriut



Vetëm 20% e respondenteve e kishin praktikuar më përpara shërbimin e kujdesit për fëmijë. Pak më shumë sesa gjysma ishin nga Prishtina (56%).<sup>98</sup> Nga respondentët që kishin paguar për kujdesin për fëmijë, mediana e kostos për muaj për fëmijë ishte 50 euro.<sup>99</sup> Mediana e kostos në Prishtinë ishte shumë më e lartë sesa ajo në komunat e tjera: 70 euro.<sup>100</sup> Nga përdoruesit e shërbimit të kujdesit për fëmijë, 88% ishin "të kënaqura" ose "shumë të kënaqura" me shërbimin. Dymbëdhjetë nënat të cilat u shprehën të pakënaqura vinin nga komunat e Pejës dhe Prishtinës. Shkaqet për pakënaqësinë kishin të bënin me: ushqimin jo të shëndetshëm; mungesën e higjienës; program i zbehtë edukativ; dhe kohë e pamjaftueshme për t'u shoqëruar me fëmijët e tjerë.

<sup>98</sup> Domethënë, 55 nga 97 respondente.


<sup>99</sup> IQR €35 – €80

<sup>100</sup> IQR: €50 – €90



Nga 97 respondente të cilat nuk e kishin përdorur asnjëherë shërbimin e kujdesit për fëmijë, vetëm 13 ende e përdornin shërbimin dhe tetë prej tyre jetonin në Prishtinë. Sikurse ilustron në grafikun 4, shkak më i zakonshëm për të cilin gratë e papunësuarat e ndërprisnin përdorimin e shërbimit të kujdesit për fëmijë ishte sepse ato donin të kujdeseshin vetë për fëmijët e tyre (57%). Për 19% të grave, kujdesi për fëmijë ishte shumë i shtrenjtë, dhe 18% u shprehën se ishte shumë larg nga shtëpia. Dymbëdhjetë gra thanë se do ta ndërprisnin përdorimin për shkak se partneri i tyre apo familja nuk dëshironin që ato të përdornin shërbimin e kujdesit për fëmijë. Nëntë gra të papunësuarat thanë se nuk e kishin përdorur *kurrë* kujdesin për fëmijë *sepse* partneri i tyre nuk donte që ato ta përdornin. Edhe tri gra thanë se anëtarët e tjerë të familjes nuk donin që ato t'i dërgonin fëmijët e tyre në qendrat e kujdesit për fëmijë. Ndonëse kjo është një përqindje relativisht e vogël e grave të papunësuarat (5%), ajo lë të kuptohet se presioni shoqëror që gratë të mbeten në shtëpi me fëmijët e tyre ekziston akoma në disa familje. Nëse gratë janë të papunësuarat, familjet mund të mos shohin vlerën ekonomike në ekonominë familjare duke paguar për shërbime për kujdes për fëmijë. Shikuar nga kjo perspektivë, mund të shfaqet keqkuptimi se kujdesi për fëmijë duhet të paguhet nga pagat e nënave, edhe pse, siç përmendëm më sipër, sipas ligjit të Kosovës, gratë dhe burrat kanë përgjegjësi të barabartë për t'u kujdesur për fëmijët.


**Grafikoni 4. Arsyet pse gratë e papunësuarat kanë ndërprerë shfrytëzimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijë**



Ndërsa gratë e papunësuarat, të cilat nuk e kishin përdorur kurrë shërbimin e kujdesit për fëmijë, 92% thanë se kjo ndodhte sepse ato kujdeseshin vetë për fëmijët e tyre;<sup>101</sup> dhe 35% thanë se kjo ndodhte për shkak se në zonën e tyre nuk kishte shërbime të kujdesit për fëmijë. Gratë kishin mundësi të zgjidhnin disa shkaqe. Gratë në Pejë (58%), Gjakovë (64%) dhe Kamenicë (50%) kishin më shumë të ngjarë sesa gratë në Prishtinë (5%) që të shpreheshin se shërbimet e kujdesit për fëmijë ishin në dispozicion.<sup>102</sup>

Në përgjithësi, 88% e grave të papunësuarat thanë se po të kishin pasur qasje në cilësi, kujdes të përballeshëm ekonomik, ato do t'i dërgonin fëmijët e tyre.<sup>103</sup> Sikurse ilustron në grafikun 5, të gjitha gratë në Mitrovicën e Veriut, 99% e grave në Pejë, 89% e grave në Gjakovë, 83% e grave në Prishtinë dhe 73% e grave në Kamenicë ishin të interesuar për të dërguar fëmijët e tyre në qendrat e kujdesit për fëmijë. Nuk kishte dallime në

**Grafikoni 5. Gratë e papunësuarat të interesuar në shfrytëzimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijë**



gatishmërinë e grave sipas moshës së tyre, arsimit, vendndodhjes rurale/urbane, apo numrit të fëmijëve. Gratë që kishin fëmijë në klasën e gjashtë apo më të rritur (11-12 vjeç) kishin 60% më pak të ngjarë të përdornin shërbimet e kujdesit për fëmijë.<sup>104</sup> Ndoshta gratë nuk i kanë konsideruar shërbimet si të nevojshme sepse në këtë grup-moshë mund të kujdeset vetë për veten.


<sup>101</sup> Gjithsej, 363 nga 394 respondente.

<sup>102</sup>  $P < 0.001$

<sup>103</sup> 95% CI: 84%, 90%

<sup>104</sup>  $P < 0.001$

Gjithsej, 81% e të gjitha grave të papunësuarra e të anketuara do të preferonin t'i dërgonin fëmijët e tyre në një qendër të kujdesit për fëmijë, të drejtuar nga qeveria, 22% preferonin qendrat që drejtohen nga biznesi privat ndërkohë që 17% do të përdornin qendrat e kujdesit për fëmijë, ku përfshihen partneritetet publik-privat (PPP) (shih grafikun 6).<sup>105</sup> Respondentet kishin mundësi të zgjidhnin më shumë sesa një alternativë.



Megjithatë, 64% e grave të papunësuarra përdornin *vetëm* qendra të kujdesit për fëmijë, të menaxhuara nga qeveria. Ndoshta, kjo mund të kuptohet pjesërisht në kuadrin e kohës socialiste të Kosovës ku shteti iu ofronte të gjithëve kujdes falas për fëmijë. Mbështetur në përvojën e tyre të mëparshme, gratë mund të presin që këto shërbime të ofrohen nga shteti, dhe të kushtojnë më pak sesa kujdesi për fëmijë, që ofrohet nga sektori privat. Sipas zyrtarëve publikë, prindërit preferojnë qendrat për kujdes të fëmijëve, të cilat menaxhohen nga qeveria, sepse kanë mbikëqyrje më të mirë publike, çmime më të ulëta, monitorim më të mirë të fëmijëve dhe ushqim cilësor.<sup>106</sup>

Gratë e papunësuarra shprehën në masë dërmuese interesin për të punuar në një pozitë të paguar (91%).<sup>107</sup> Krahas kësaj, 91% e grave të papunësuarra thanë edhe se ato, nëse do të mundnin t'i dërgonin fëmijët në qendër të kujdesit për fëmijë, do të kërkonin punë. Për më tepër, nga 106 gra të cilat përshkruanin statusin aktual të tyre si të papunësuarra, por që nuk shihnin për interesim punën, 75% thanë se do të kërkonin punë në një pozitë të paguar nëse kujdesi për fëmijë do të ishte i disponueshëm. Kjo ofron dëshmi të forta se bërja e kujdesit shëndetësor më të qasshëm do të kontribuojë që më shumë gra të kërkojnë të punësohen, *edhe* pse ato nuk kishin interes të kërkonin punë më përpara. Gjasat që gratë të dëshironin të punonin binin me rritjen e numrit të fëmijëve që kishin dhe rriteshin me vitet e përfunduara të shkollimit.<sup>108</sup> Nga gratë të cilat dëshirojnë të përfshihen në punë të paguar, 71% dëshironin të punonin për një punëdhënës jashtë familjes së tyre, 16% dëshironin të fillonin biznesin e tyre, ndërkohë që 12% dëshironin të punonin për biznesin e familjes së tyre.

## Kërkesa për kujdes për fëmijë në radhët e punonjësve

Gjithsej, 519 punonjës (64% gra dhe 36% burra) morën pjesë në këtë anketim.<sup>109</sup> Mesatarisht, respondentët që kishin fëmijë kishin 1.8 fëmijë. Numri më i lartë i fëmijëve që kishin respondentët ishte katër. Nga 355 punonjës me fëmijë, gjysma kishin të paktën një fëmijë me moshë nga tre deri në gjashtë vjeç, i cili ende nuk ishte nisur në shkollën fillore. Një e treta kishin fëmijë të moshës gjashtë muajshe deri në tre vjeç.

<sup>105</sup> Kësaj pyetjeje iu përgjigjën të gjithë respondentët. Duke shqyrtuar vetëm gratë e interesuara në kujdesin për fëmijë, përqindjet janë të krahasueshme me mostrën e gjerë: 80% (342/430) preferonin shërbimin nga qeveria, 23% nga privati dhe 17% nga PPP-të.

<sup>106</sup> Intervista të RrGGK-së me zyrtarë publikë, 2016. Zyrtarët e MASHT-it kanë vënë re edhe se qendrat private kanë prirje të jenë më të shtrenjta dhe numri i prindërve që mund t'i përballojnë ato ekonomikisht është më i vogël (RrGGK, *Buxhetimi për Arsim më të Mirë*, Prishtinë: RrGGK, 2016).


<sup>107</sup> N = 445/491; 95% CI: 88%, 93%

<sup>108</sup> P = 0.01 dhe p = 0.02, përkatësisht. Nga 46 gra që thanë se nuk do të fillonin të punonin nëse kujdesi për fëmijë do të ishte i disponueshëm, rreth gjysma jetonin në zonat rurale (n = 22/46, 48%).

<sup>109</sup> Për informata të mëtejshme lidhur me mostrën dhe metodologjinë e mostrimit, ju lutemi të shihni Shtojcën 2.

## Kujdesi aktual për fëmijë (3 deri 6 vjeç)

Për punonjësit me fëmijë të moshës tre deri gjashtë vjeç, 52% i dërgonin fëmijët në qendra private (20%) ose publike të kujdesit për fëmijë (32%), dhe 46% kishin një anëtar të familjes që kujdesej për fëmijën e tyre.<sup>110</sup> Shumica e respondentëve thoshin se gjyshërit kujdesen për fëmijët (37%). Më pak respondentë (18%) kishin nënat e tyre që merreshin me kujdesin për fëmijën, 7% kishin baballarët që merreshin me fëmijën, ndërkohë që 11% kishin anëtarë të tjerë të familjes së merreshin me ofrimin e kujdesit për fëmijë. Vetëm pak respondentë kishin dado brenda dhe jashtë shtëpisë. Kësisoj, pothuaj gjysma e punonjësve mbështeteshin kryesisht në punën pa pagesë të anëtarëve të familjes për t'u kujdesur për fëmijët.



Kostoja e kujdesit për fëmijë të moshës tre deri në gjashtë vjeç varionte nga 20 euro në 300 euro në maksimum për fëmijë në muaj, në varësi të komunës dhe të faktit nëse punonjësi përdorte qendër publike apo private. Mediana e kostove për muaj ishte 65 euro.<sup>111</sup> Kujdesi privat, mesatarisht, kushton 43 euro më shumë në muaj sesa kujdesi publik.<sup>112</sup> Dallimet në kosto janë më të dukshme në Prishtinë. Si qendrat private, ashtu edhe ato publike të ofrimit të kujdesit për fëmijë në Prishtinë kushtojnë thelbësisht më shumë sesa ato në komunat e tjera.<sup>113</sup> Kujdesi publik për fëmijë raportohet se kushton më pak në muaj, mesatarisht, në komunat e Leposaviqit (32 euro), Zveçanit (32 euro) dhe Gjakovës (36 euro) sesa në komunat e tjera. Është me interes të vihet në dukje se në Gjakovë punonjësit raportonin se kujdesi privat (33 euro) kushtonte më pak sesa kujdesi publik (36 euro).

**Tabela 4. Kostoja mujore e kujdesit privat (Euro), për fëmijët nga moshë 3 deri 6 vjeçare**

Komuna	Mesat	SD	Mediana	Min	Max	N
Fushë Kosovë	64	16	63	50	80	4
Gjakovë	33	29	50	0	50	3
Pejë	58	12	60	30	70	8
Prishtinë	98	52	100	50	300	21
<b>Gjithsej</b>	<b>80</b>	<b>46</b>	<b>73</b>	<b>0</b>	<b>300</b>	<b>36</b>

Kur diskutohet niveli i kënaqësisë që respondentët kanë me formën e kujdesit për fëmijë, të cilën e përdorin, duhet të kihet parasysh se perceptimi

**Tabela 5. Kostoja mujore e kujdesit publik (Euro), për fëmijët nga moshë 3 deri 6 vjeçare**

Komuna	Mesat	SD	Mediana	Min	Max	N
Fushë Kosovë	50		50	50	50	1
Gjakovë	36	1	36	35	36	4
Leposaviq	32	6	30	20	50	17
Mitrovicë	40	0	40	40	40	9
Pejë	40	5	40	35	50	7
Prishtinë	50	0	50	50	50	4
Zubin Potok	40	5	40	30	50	8
Zveçan	32	4	30	30	40	6
<b>Gjithsej</b>	<b>37</b>	<b>7</b>	<b>40</b>	<b>20</b>	<b>50</b>	<b>57</b>


<sup>110</sup> Vini re se totali shkon më shumë sesa 100% sepse respondentët mund të zgjidhnin më shumë sesa një alternativë.

<sup>111</sup> IQR: 50 – 100 €

<sup>112</sup> 95% CI: 30, 55 € më shumë;  $p < 0.001$ . Për fëmijët parashkollorë, 3-6 vjeç, vetëm 36 punonjës thanë se përdornin kujdesin privat: 21 në Prishtinë, tetë në Pejë; katër në Fushë Kosovë dhe tre në Gjakovë.

<sup>113</sup> Ndonëse ka pasur 119 respondentë nga Kamenica, vetëm 17 (6%) kishin fëmijë gjashtë vjeç ose më të vegjël. Për këtë arsye, nuk mund të raportohet asnjë rezultat domethënës.

personal që kanë njerëzit për cilësinë mund të formësohet nga përvojat e tyre personale.<sup>114</sup> Perceptimi i cilësisë nuk nënkupton domosdoshmërisht se ekziston edhe cilësia. Shumica e respondentëve ishin të kënaqur (40%) ose shumë të kënaqur (46%) me opsionin e tyre të kujdesit për fëmijë. Nuk kishte ndryshime në nivelin e kënaqësisë, duke u mbështetur në gjininë e respondentit.<sup>115</sup> Nga 26 respondentë që ishin të pakënaqur, 42% kishin gjyshërit si ofrues të kujdesit, 33% përdornin kujdesin publik, ndërkohë që 20% përdornin atë privat. Tri shkaqet e zakonshme për pakënaqësi ishin: programi ( 8.31%), prindi që kujdesej për fëmijën do të preferonte të punonte (7.27%) dhe cilësia e ushqimit (6.23%). Nga tetë respondentët të cilët ishin të pakënaqur me kujdesin publik, katër thanë se kjo ndodhte për shkak të programit arsimor dhe gjashtë thanë se atyre nuk iu kishte pëlqyer cilësia e ushqimit.<sup>116</sup>



Punonjësit që përdorin kujdesin për fëmijë në Kosovë dhe Veriun e Mitrovicës dukeshin më pak të kënaqur sesa personat që përdorin kujdesin për fëmijë në Prishtinë (shihni tabelën 6).<sup>117</sup>

**Tabela 6. Të kënaqur me kujdesin për fëmijë (3 deri 6 vjeç)**

Komuna	Shumë të pakënaqur		Të pakënaqur		E kënaqur		Shumë të kënaqur		Gjithsej N
	N	R%	N	R%	N	R%	N	R%	
Fushë Kosovë	0	0.0	0	0.0	1	11.1	8	88.9	9
Gjakovë	0	0.0	6	27.3	8	36.4	8	36.4	22
Kamenicë	0	0.0	0	0.0	1	12.5	7	87.5	8
Leposaviq	0	0.0	4	19.0	7	33.3	10	47.6	21
Lipjan	0	0.0	0	0.0	0	0.0	1	100.0	1
Veriu i Mitrovicës	1	7.1	3	21.4	9	64.3	1	7.1	14
Pejë	1	2.9	5	14.3	11	31.4	18	51.4	35
Prishtinë	0	0.0	4	9.8	13	31.7	24	58.5	41
Zubin Potok	0	0.0	1	5.6	17	94.4	0	0.0	18
Zveçan	0	0.0	1	10.0	4	40.0	5	50.0	10
<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>1.1</b>	<b>24</b>	<b>13.4</b>	<b>71</b>	<b>39.7</b>	<b>82</b>	<b>45.8</b>	<b>179</b>

### Kujdesi aktual për fëmijë (6 muaj deri 3 vjeç)

Për punonjësit që kishin fëmijë më të vegjël, me moshë nga gjashtë muaj deri tre vjeç, 35% i kishin dërguar fëmijët në kujdes privat (14%) apo shtetëror (21%), 39% kishin gjyshërit që merreshin me kujdesin për fëmijët, dhe 26% kishin nënën që kujdesej për fëmijën (grafiku 9). Respondentet kishin


<sup>114</sup> Koment i bërë nga kolegu shqyrtues në draftin e raportit.

<sup>115</sup> P = 0,53

<sup>116</sup> Respondentet kishin mundësi të ofronin më shumë sesa një alternativë.

<sup>117</sup> P < 0.01

mundësi të zgjidhnin më shumë sesa një alternativë. Të tjerët kishin kushërinj (10%), babain (9%) apo të tjerë që kujdeseshin për fëmijën. Kësisoj, në radhët e fëmijëve të moshave më të vogla, 63% e punonjësve mbështeteshin në punën pa pagesë të anëtarëve të familjes për kujdesin e fëmijëve.



Dukshëm, RrGGK-ja ka intervistuar vetëm njerëz që punonin për punëdhënës të mëdhenj. Prindërit që punojnë në ndërmarrje më të vogla, biznese familjare dhe ekonomi informale ku puna nuk regjistrohet, mund të përdorin forma të tjera të kujdesit për fëmijë, siç janë qendrat e peregjistruara të kujdesit për fëmijë. Mund të hipotetizohet se prindërit që punojnë në biznese më të vogla mund të kenë më pak para, prandaj edhe mund të varen më shumë nga anëtarët e familjes për të ofruar shërbim pa pagesë për fëmijët.<sup>118</sup> Megjithatë, nevojiten hulumtime të tjera lidhur me format e përdorura nga personat në ndërmarrjet më të vogla, bizneset familjare, apo që punojnë në informalitet.

Kostoja e kujdesit për fëmijët më të vegjël varion nga 20 deri në maksimum 110 euro për fëmijë në muaj, në varësi të komunës dhe asaj nëse shërbimi është privat apo publik (shihni tabelat 7 dhe 8).

**Tabela 7. Kostoja mujore e kujdesit privat për fëmijë (Euro)**

Komuna	Mesat	SD	Median	Min	Max	N
Fushë Kosovë	75		75	75	75	1
Gjakovë	70	28	60	50	110	4
Lipjan	90		90	90	90	1
Pejë	63	10	65	50	70	4
Prishtinë	96	12	100	75	110	6
<b>Gjithsej</b>	<b>79</b>	<b>21</b>	<b>75</b>	<b>50</b>	<b>110</b>	<b>16</b>

**Tabela 8. Kostoja mujore e kujdesit publik për fëmijë (Euro)<sup>119</sup>**

Komuna	Mesat	SD	Mediana	Min	Max	N
Gjakovë	36	1	36	35	36	4
Kamenicë						1
Leposaviq	27	5	30	20	30	6
Lipjan	50		50	50	50	1
Mitrovicë	40	0	40	40	40	8
Zubin Potok	50		50	50	50	1
Zveçan	45	10	40	40	60	4
<b>Gjithsej</b>	<b>38</b>	<b>9</b>	<b>40</b>	<b>20</b>	<b>60</b>	<b>25</b>

Mediana e kostove për muaj ishte 40 euro për kujdesin.<sup>120</sup> Ndërkohë që kjo mund të lërë të kuptohet se kujdesi për fëmijët e vegjël ka prirje të jetë më pak i shtrenjtë sesa ai për fëmijët më të rritur, kostoja mesatare për kujdesin për fëmijë është pothuaj e njëjtë. Sikurse me fëmijët e moshës parashkollore, kujdesi privat mesatarisht kushton 42 euro më shumë sesa ai publik.<sup>121</sup> Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë, kujdesi privat në muaj për fëmijë në Prishtinë priret të kushtojë më shumë mesatarisht (96 euro) sesa në komunat e tjera.

<sup>118</sup> RrGGK nuk ka mundur të gjejë të dhëna lidhur me pagën mesatare për bizneset me madhësi të ndryshme, të cilat do të ofronin dëshmi në këtë drejtim.

<sup>119</sup> Vetëm një person në Kamenicë raportonte përdorimin e kujdesit publik, por nuk dha të dhëna lidhur me koston. Në Prishtinë kishte 21 punonjës me fëmijë, por asnjë nuk raportonte se përdorte kujdesin publik.

<sup>120</sup> IQR: 40 – 70 €

<sup>121</sup> 95% CI: 32, 51 € më shumë;  $p < 0.001$

Kostoja e kujdesit për fëmijë më të vegjël varioje nga 20 euro në 150 euro në maksimum për fëmijë në muaj, në varësi të komunës dhe të faktit nëse punonjësi përdorte qendër publike apo private për ofrimin e përkujdesit. Mediana e kostove për muaj ishte 40 euro për kujdesin.<sup>122</sup> Sikurse me fëmijët më të rritur, kujdesi privat mesatarisht kushton 42 euro më shumë sesa ai publik.<sup>123</sup> Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë, kujdesi privat në muaj për fëmijë në Prishtinë mesatarisht (96 euro) kishte prirjen të kushtonte më shumë sesa në komunat e tjera.


**Tabela 9. Kostoja mujore e kujdesit privat për fëmijë (Euro)**

Komuna	Mesat	SD	Median	Min	Max	N
Fushë Kosovë	75		75	75	75	1
Gjakovë	70	28	60	50	110	4
Lipjan	90		90	90	90	1
Pejë	63	10	65	50	70	4
Prishtinë	96	12	100	75	110	6
<b>Gjithsej</b>	<b>79</b>	<b>21</b>	<b>75</b>	<b>50</b>	<b>110</b>	<b>16</b>

**Tabela 10. Kostoja mujore e kujdesit publik për fëmijë (Euro)<sup>124</sup>**

Komuna	Mesat	SD	Mediana	Min	Max	N
Gjakovë	36	1	36	35	36	4
Kamenicë						1
Leposaviq	27	5	30	20	30	6
Lipjan	50		50	50	50	1
Mitrovicë	40	0	40	40	40	8
Zubin Potok	50		50	50	50	1
Zveçan	45	10	40	40	60	4
<b>Gjithsej</b>	<b>38</b>	<b>9</b>	<b>40</b>	<b>20</b>	<b>60</b>	<b>25</b>

Shumica e punonjësve ishin të kënaqur (40%) ose shumë të kënaqur (46%) me opsionin e tyre të kujdesit për fëmijë.<sup>125</sup> Nga ata që ishin të pakënaqur, 50% kishin gjyshërit si ofrues të kujdesit, 25% kishin nënën që ofronte kujdesin, ndërkohë që 19% përdornin kujdesin publik ose privat.



<sup>122</sup> IQR: 40 – 70 €

<sup>123</sup> 95% CI: 32, 51 € më shumë; p<0.001

<sup>124</sup> Vetëm një person në Kamenicë raportonte përdorimin e kujdesit publik, por nuk dha të dhëna lidhur me koston. Në Prishtinë kishte 21 punonjës me fëmijë, por asnjë nuk raportonte se përdorte kujdesin publik.


<sup>125</sup> Nuk kishte dallim në bazë të gjinisë së respondentëve apo komunës se sa janë të kënaqur (p = 0.83).

Numri i punonjësve në Veriun e Mitrovicës (29%), Gjakovë (16%) dhe Prishtinë (14%) që ishin të pakënaqur me kujdesin për fëmijë ishte më i madh sesa ai i punonjësve në komunitatet e tjera (shih tabelën 11).<sup>126</sup> Shkaqet më të zakonshme për të cilat respondentët u shprehën se ishin të pakënaqur me ofruesin e shërbimit të kujdesit për fëmijën e tyre ishin se fëmijët nuk socializoheshin mjaftueshëm me të tjerët (9.35%), programi arsimor i ofruar nga ofruesi i shërbimit të kujdesit ishte jo cilësor (8.31%), prindi që kujdesej për fëmijën do të preferonte të punësohej (7.27%) dhe cilësia e ushqimit (6.23%). Nga tetë respondentë të pakënaqur me gjyshërit që kujdesehin për fëmijët, gjashtë (75%) thanë se kjo ishte për shkak të mungesës së mundësive që fëmijët e tyre të socializoheshin me fëmijët e tjerë.

Komuna	Të pakënaqur		Të kënaqur		Shumë të kënaqur		Gjithsej
	N	R%	N	R%	N	R%	N
Fushë Kosovë	1	20	1	20	3	60	5
Gjakovë	3	15.8	6	31.6	10	52.6	19
Kamenicë	1	12.5	2	25	5	62.5	8
Leposaviq	1	7.7	8	61.5	4	30.8	13
Lipjan	0	0	1	33.3	2	66.7	3
Mitrovicë	4	28.6	9	64.3	1	7.1	14
Pejë	2	8	10	40	13	52	25
Prishtinë	3	14.3	4	19	14	66.7	21
Zubin Potok	0	0	4	100	0	0	4
Zveçan	1	20	2	40	2	40	5
<b>Gjithsej</b>	<b>16</b>	<b>13.7</b>	<b>47</b>	<b>40.2</b>	<b>54</b>	<b>46.2</b>	<b>117</b>

### Shërbimet më të rëndësishme të kujdesit për fëmijë


Punonjësit me fëmijë të të gjitha moshave mendonin në mënyrë të ngjashme lidhur me ato që konsideronin si shërbimet më të rëndësishme të kujdesit për fëmijë. Për prindërit e fëmijëve më të vegjël, shumica e aspekteve përfshinte higjienën (75%), e pasuar nga ushqimi (74%) dhe stafi i trajnuar (58%), sikurse ilustron në grafikun 11.



Për fëmijët nga tre deri në gjashtë vjeç, tiparet më të rëndësishme për shumicën e prindërve ishin programi arsimor (84%), stafi i trajnuar (62%) dhe higjiena (61%). Pak prindër që punonin thanë se çmimi i shërbimit të kujdesit ishte një konsideratë e rëndësishme.

<sup>126</sup> Asnjë nga respondentët nuk tha se ishte "shumë i pakënaqur".

**Grafikoni 12. Shërbimet më të rëndësishme për fëmijët e moshës 3 - 6 vjeç**




### Çmime të arsyeshme për shërbimet e kujdesit për fëmijë

Mesatarisht, punonjësit ishin të gatshëm të paguanin 50 euro (48-53 euro) për shërbimet e kujdesit për fëmijë për fëmijën nën tre vjeç dhe 54 euro (52-57 euro) për fëmijët nga tre deri në gjashtë vjeç.<sup>127</sup> Punonjësit pa fëmijë ishin të gatshëm të paguanin më shumë; mesatarisht, ata mendonin se 59 euro ishte një çmim i arsyeshëm krahasuar me 53 euro për ata me fëmijë.<sup>128</sup>

Pritshmëritë lidhur me çmimet ishin të ndryshme në mënyrë domethënëse nga komuna në komunë.<sup>129</sup> Sikurse ilustron në grafikun 15, punonjësit në Prishtinë ishin të gatshëm të paguanin më shumë për shërbimet për kujdesin për fëmijë; si mesatare, punonjësit mendonin se 76 euro ishte çmim i arsyeshëm për fëmijët me moshë tre deri në gjashtë vjeç;<sup>130</sup> dhe 75% ishte çmim i arsyeshëm për fëmijët nga gjashtë muaj deri në tre vjeç.<sup>131</sup>

**Grafikoni 13. Çmimi mesatar i arsyeshëm për shërbimet e kujdesit për fëmijë (€)**



Mund të hipotetizohet se prindërit në Prishtinë, sidomos ata në kompanitë më të mëdha, mund të kenë mesatarisht paga më të larta sesa personat në komunat e tjera. Kjo mund t'i bëjë ata më të gatshëm dhe më të aftë të paguajnë për kujdesin për fëmijë. Prindërit në Prishtinë mund të jenë të vetëdijshëm edhe se çmimi i tregut për kujdesin për fëmijë ka prirje të jetë më i shtrenjtë, prandaj ata nuk do të mundnin të gjenin kujdes cilësor me çmime më të ulëta.

<sup>127</sup>  $P < 0.001$ . Mediana e çmimit mujor për të cilin punonjësit mendonin se ishte i arsyeshëm për fëmijët nën katër vjeç ishte 50 euro (IQR: €35 - €50). Për fëmijët parashkollorë ishte 50 euro (IQR: €40-60).

<sup>128</sup>  $P = 0.01$ . Nuk kishte dallime në preferencë midis grave dhe burrave ( $P = 0.48$ ) apo personat e tjerë me fëmijë nën tre vjeç ( $P = 0.92$ ).

<sup>129</sup>  $P < 0.001$

<sup>130</sup> 95% CI: 69, 82 €

<sup>131</sup> 95% CI: 69, 81 €



## Interesi i punëdhënësit në përkrahjen e shërbimeve të kujdesit për fëmijë

Brenda komunave të synuara, RrGGK-ja është përqendruar në 61 punëdhënës të mëdhenj, të cilët mund të jenë të interesuar të zhvillojnë qendrat e kujdesit për fëmijë apo të kontribuojnë financiarisht për kujdesin për fëmijë për punonjësit e tyre.<sup>132</sup> Duke marrë parasysh normat e ulëta të punësimit në Kosovë në përgjithësi, RrGGK-ja i pyeti kompanitë lidhur me atë se pse ato nuk punësonin më shumë gra: 44% thanë "kjo lloj pune nuk është për gra" (d.m.th. është punë fizike). Kjo i shton vlerë anketimit të mëparshëm të RrGGK-së të 400 punëdhënësve të përzgjedhur rastësisht në Kosovë, ku 47% nuk punësonin gra për të njëjtin shkak.<sup>133</sup> Po ashtu, 36% e punëdhënësve të intervistuar në kuadrin e këtij hulumtimi nuk e dinin pse nuk punësonin më shumë gra. Njëri nuk donte të paguante për lejen e lehonisë. Hulumtimi i mëparshëm i RrGGK-së ka gjetur se diskriminimi kundër grave në punësim ekziston në radhët e punëdhënësve meqenëse ata nuk dëshirojnë të krijojnë mundësinë që t'u duhet të paguajnë për pushimin e lehonisë.<sup>134</sup> Asnjë punëdhënës nuk tha "gratë duhet të kujdesen për fëmijët kështu që nuk mund të punojnë."

Pothuaj të gjithë punëdhënësit (97%) thanë se gjatë pesë viteve të fundit nuk ishte larguar asnjë punonjës për shkak se i duhej të kujdesej për fëmijët. Megjithatë, fakti se 52% e punëdhënësve nuk e dinin nëse punonjësit ishin prindër me fëmijë nën 13 vjeç mund të nënkuptojë se ata mund të mos e kenë ditur se ky është shkak për largimin e një punonjësi.<sup>135</sup> Mungesa e përgjithshme e njohurive për nevojat e punonjësve për kujdesin për fëmijë mund të minojë çdo interes potencial në përkrahjen e shërbimit të kujdesit për fëmijë për punonjësit.

Vetëm gjashtë punëdhënës (10%) mendonin se po të kishte alternativa më të përballueshme për kujdesin për fëmijë në zonë, ata do të kishin më shumë punonjës të kualifikuar për të punësuar. Vetëm katër punëdhënës (7%) shprehën interes për krijimin e një qendre për kujdesin për fëmijë vetëm për punonjësit e tyre, dhe pesë (8%) thanë se do të ishin të interesuar të krijojnë një qendër të shërbimit për fëmijë, së bashku me bizneset e tjera që ndodheshin aty pranë. Pesë punëdhënës (8%) ishin të interesuar të bashkë-financojnë kujdesin për fëmijët, në të ardhmen, për punonjësit nëse donatori do të mbështeste kostot e fillimit. Pesë (8%) ishin të interesuar të bashkë-financojnë në të ardhmen kujdesin për fëmijët e punonjësve si pjesë e një PPP-je, nëse qeveria lokale ishte e interesuar.<sup>136</sup> 22 punëdhënës të tjerë (36%) nuk e dinin nëse do të ishin të interesuar në bashkë-financimin e një PPP-je për fëmijët. Nëntë punëdhënës (15%) ishin të gatshëm të bashkë-financojnë ndërtimin apo renovimin e një qendre për kujdes të fëmijëve, ndoshta së bashku me bizneset e tjera. 11 punëdhënës të tjerë (18%) ishin të pasigurt nëse do të ishin të gatshëm të ofronin bashkë-financime, dhe ndoshta do të mund të bindeshin.

<sup>132</sup> Mediana e numrit të punonjësve ishte 12 (IQR: 7-26). Mediana e numrit të punonjësve ishte pesë (IQR: 2-13) dhe gjashtë për punonjësit (IQR: 3-14). Vlerat mesatare të punonjësve dhe punonjësve janë shtrembëruar sepse një punëdhënës ishte jashtëzakonisht i madh. Për më shumë informata, shih Shtojcën 6

<sup>133</sup> KWN, *Arritja e ekuilibrit*, fq. 14.

<sup>134</sup> Po aty.

<sup>135</sup> Nga 29 punëdhënës të cilët dinin se punonjësit e tyre kishin fëmijë, mesatarisht, thanë se 26% e punonjësve kishin fëmijë nën 13 vjeç.

<sup>136</sup> Nuk kishte lidhje midis madhësisë së kompanisë dhe nivelit të interesit për t'u përfshirë në një PPP ( $p = 0.89$ ).

Kur iu dha shembulli i qendrës së bankës Raiffeisen për kujdesin për fëmijë (kutia 1) vetëm tre punëdhënës (5%) thanë se do të merrnin parasysh t'iu ofronin punonjësve të tyre një përfitim të ngjashëm, nga 3 deri 20 euro në muaj për fëmijë. Krahas kësaj, nëntë punëdhënës (15%) nuk e dinin nëse do të merrnin parasysh ofrimin e një shërbimi si ai i Raiffeisen-it.

Duke konsideruar faktin se shumë punëdhënës nuk kishin njohuri lidhur me nevojat e punonjësve të tyre për kujdes për fëmijë dhe janë të pavendosur lidhur me bashkëfinancimin potencial të kujdesit për fëmijë, mund të ekzistojë mundësia për t'i bindur ata që ta përkrahin kujdesin për fëmijë përmes diskutimeve në të ardhmen dhe ofrimin e provave se investimi në kujdesin për fëmijë i ndihmon bizneset e tyre.

### **Kutia 1. Rast studimor: Banka Raiffeisen beson se subvencionimi i kujdesit për fëmijë ka dobi të shumëfishta**


Në Prishtinë, Banka Raiffeisen ka ofruar një përfitim unik për punonjësit e saj që prej vitit 2008. Përmes një procesi konkurrues prokurimi, Raiffeisen kontraktoi një qendër private të kujdesit për t'u kujdesur për fëmijët e punonjësve të saj. Të gjithë punonjësit mund t'i dërgojnë fëmijët në këtë qendër dhe banka paguan 60% të faturës së përgjithshme mujore, ndërsa prindërit paguajnë pjesën tjetër të mbetur prej 40%. Qendra e kujdesit për fëmijët e moshës nëntë muaj deri në gjashtë vjeç. Qendra e kujdesit menaxhohet dhe drejtohet privatisht. Sipas bankës Raiffeisen, ata nuk kanë pasur asnjë rast ku punonjësi e lë punën për shkak të përgjegjësive për t'u kujdesur për fëmijët. Ata ia veshin këtë faktit se të gjithë punonjësit me fëmijë kanë një zgjedhje për kujdesin për fëmijë. Të gjithë punonjësit mund të monitorojnë punën e qendrës së kujdesit, duke përdorur kamera, gjë që i bënë të besojnë se fëmijët e tyre janë të sigurtë. Si rezultat, punonjësit humbin më pak punë në ditë, dhe performanca dhe produktiviteti i tyre janë përmirësuar. Për këto arsye, përfaqësuesit e Raiffeisen-it nuk e konsiderojnë mbështetjen e kujdesit për fëmijë si kosto, por si investim për të mbajtur dhe menaxhuar stafin, si dhe për të përmirësuar produktivitetin e tyre.

## Shërbimet në dispozicion në qendrat e kujdesit për fëmijë

Sikurse është përmendur të gjitha qendrat e kujdesit për fëmijë në Kosovë, qofshin publike ose private, do të duhej të regjistrohen dhe të ofrojnë programe të edukimit parashkollor. Që prej vitit 2016, MASHT-i ka licencuar 74 institucione parashkollore private për fëmijët nga moshja gjashtë e poshtë.<sup>137</sup> Për vitin shkollor 2015-2016, MASHT-i ka regjistruar 41 institucione parashkollore publike.<sup>138</sup> RrGGK-ka ka identifikuar qendrat që janë shtuar, të cilat e çojnë numrin e përgjithshëm në 134. Sikurse ilustron në grafikun 16, shumica e qendrave të kujdesit për fëmijë ndodhen në Komunën e Prishtinës (62), nga të cilët vetëm dy ndodhen në zona rurale (Besi dhe Hajvali). Dymbëdhjetë komuna duket se nuk kanë në dispozicion shërbime të regjistruara të kujdesit për fëmijë: Deçan, Dragash, Hani i Elezit, Graçanicë, Junik, Klllokot, Mamushë, Novo Bërd, Partesh, Ranillug, Zveçan dhe Shtërpçë. Shumica e qendrave të kujdesit ndodhen në zona urbane; shumë pak ekzistojnë në qytetet e vogla apo zonat rurale. Një komunë interesante dhe që bën përjashtim është Istogu, e cila ka gjashtë institucione parashkollore publike, ku të gjitha, përveç njëres ndodhen në një zonë rurale.<sup>139</sup> Ndonëse për shkak të kufizimeve kohore nuk arritëm të hulumtonim më tutje, ky mund të jetë një shembull interesant i mënyrës se si institucionet komunale e kanë dëshmuar kujdesin për fëmijë në prioritet dhe kanë caktuar buxhet për të. Edhe shkalla në të cilën mundësitë e kujdesit të përmirësuar për fëmijë e kanë përmirësuar pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore mund të jetë me interes.

Forma të tjera të kujdesit informal mund të ekzistojnë, duke përfshirë edhe qendrat e përgjithshme të kujdesit.<sup>140</sup> UNICEF-i është duke përkrahur nëntë qendra të kujdesit për fëmijë, me bazë në komunitet, që merren me zhvillimin e

**Grafikoni 14. Qendrat e kujdesit sipas komunave në vitin 2016**



<sup>137</sup> Dokument i MASHT-it që i është dhënë RrGGK-së, shtator 2016.

<sup>138</sup> Të dhëna nga MASHT-i, Departamenti për Arsimit Parashkollor.

<sup>139</sup> Sipas z. Agim Haxhiut, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në Istog, që prej tetorit 2015, Komuna ka financuar vetëm pesë qendra të kujdesit publik, të vendosura në qytetin e Istogut.

<sup>140</sup> RrGGK-ja nuk i ka shqyrtuar këto në mënyrë tërësore për shkak se janë të përgjithshme dhe ishin të vështira për t'u gjetur. Telefonat e tyre nuk ishin gjithmonë në dispozicion dhe nuk iu përgjigjen e-maileve. Në të vërtetë, vetë natyra e punës së përgjithshme mund të nënkuptojë që qendrat mund të ndihen të kërcënuara nëse iu përgjigjen pyetjeve.

fëmijërisë së hershme, të cilat operojnë me gjysmë orari brenda shkollave lokale publike, por menaxhohen nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) në zonat rurale të Jugut të Mitrovicës (dy), Vushtrrisë rurale (tre), Zveçanit rural (dy), Zubin Potokut rural dhe Leposaviqit rural.<sup>141</sup> Edhe Save the Children ka përkrahur qendrat me kohë të pjesshme të kujdesit për fëmijë, brenda shkollave në fshatrave Broboniq dhe Vernicë në Mitrovicë, Zajm në Klinë dhe Junik.<sup>142</sup>

RrGGK-ja ka intervistuar kryesisht qendra private të kujdesit për fëmijë. Meqenëse shumica e qendrave ndodhen në Prishtinë, ato përbënin shumicën e qendrave të intervistuar. Më tej, RrGGK-ja hipotetizoi se duke marrë parasysh që shumë njerëz udhëtojnë në Prishtinë për të punuar, ata mund të zgjedhin t'i lënë fëmijët e tyre në qendrat në Prishtinë dhe jo në komunat prej nga vijnë. Megjithatë, sipas qendrave të intervistuar, fëmijët dukej se udhëtonin nga i njëjti qytet (78%), qytete fqinje (57%) dhe/ose qytete të tjera në të njëjtën komunë (47%). Vetëm 8% e fëmijëve të përmendur vinin nga një vend tjetër në një komunë të tjetër.

Të gjitha 49 qendrat e kujdesit për fëmijë të intervistuar kishin mesatarisht 71 fëmijë.<sup>143</sup> Kapaciteti i përgjithshëm i qendrave ishte mesatarisht 87 fëmijë (shihni tabelën 12). Qendra më e madhe mund të kujdesej për deri 300 fëmijë.<sup>144</sup> Më shumë sesa çereku i qendrave (29%) kishin 21-40 fëmijë. Përafërsisht një e pesta e qendrave kishin më shumë sesa 100 fëmijë. Leposaviqi dhe Prishtina kishin më shumë qendra sesa komunat e tjera ku akomodoheshin më shumë sesa 100 fëmijë.

**Tabela 12. Numri i fëmijëve në qendrat e kujdesit, të intervistuar sipas komunave**

Nr. i fëmijëve	Gjakovë		Leposaviq		Pejë		Prishtinë		Zubin Potok		Gjithsej	
	N	%	N	%	N	%	N	%	N	%	N	%
5-20	3	21.4	1	20.0	0	0	1	5.0	1	33.3	6	12.2
21-40	4	28.6	0	0.0	2	28.6	7	35.0	1	33.3	14	28.6
41-60	2	14.3	0	0.0	3	42.9	4	20.0	0	0	9	18.4
61-80	1	7.1	0	0.0	1	14.3	3	15.0	0	0	5	10.2
81-100	2	14.3	1	20.0	0	0	2	10.0	0	0	5	10.2
>100	2	14.3	3	60.0	1	14.3	3	15.0	1	33.3	10	20.4
<b>Gjithsej</b>	<b>14</b>	<b>100.0</b>	<b>5</b>	<b>100.0</b>	<b>7</b>	<b>100</b>	<b>20</b>	<b>100.0</b>	<b>3</b>	<b>100.0</b>	<b>49</b>	<b>100.0</b>

Meqenëse nënat e kanë informuar RrGGK-në se gjetja e vendeve për kujdesin e foshnjave nën një vjeç mund të përbëjë një sfidë të konsiderueshme, RrGGK-ja i ka pyetur qendrat e kujdesit nëse e ofronin këtë shërbim. Përafërsisht 69% e qendrave thanë se pranojnë fëmijë nën një vjeç. Në përgjithësi, qendrat për fëmijët më të vegjël do të pranojnë fëmijë tre muajsh ose më të vegjël (8% e qendrave), gjashtë muajsh (31%), nëntë muajsh (22%) ose dhjetë muajsh (8%). Vetëm disi më pak sesa një e katërta e qendrave mund të pranojnë vetëm fëmijë nga tre vjeç e sipër (22%). Përqindja e vogël e qendrave që marrin foshnje nën tre muajsh (8%) ose madje nën gjashtë muajsh (31%) mund të paraqesë një sfidë për nënat që punojnë dhe që kërkojnë të kthehen në punë. Edhe pse kjo nuk do të duhet të jetë përgjegjësi e nënës, dispozitat aktualisht diskriminuese në Ligjin e Punës të Kosovës lidhur me pushimin e lehonisë dhe atësisë, vetëm parashikojnë që gratë mund të marrin pushim për t'u kujdesur për fëmijët e tyre. Për shumë shkaqe të shtjelluara tjetërkund,<sup>145</sup> kjo mund të pengojë qasjen e grave në punësim. Në fakt, RrGGK-ja ka gjetur se sa më shumë të rrinë gratë në pushimin e lehonisë, aq më pak të ngjarë kanë t'i kthehen punës.<sup>146</sup>

<sup>141</sup> Programi filloi në vitin 2011 me katër qendra (dy në veri dhe dy në jug). Pesë qendra të tjera shpesh u hapën në vitin 2014. OSHC-të që menaxhojnë qendrat në jug janë Qendra për Demokratizimin e Shoqërisë Civile dhe OJQ-ja e veriut, Santa Marija menaxhon qendrat (korrespondencë elektronike me UNICEF-in, 11 tetor 2016).

<sup>142</sup> Korrespondencë elektronike, 9 tetor 2016.

<sup>143</sup> SD: 56; Mediana: 50; IQR: 30 - 90

<sup>144</sup> SD: 59; Mediana: 70; IQR: 40-120

<sup>145</sup> Ju lutemi shihni RrGGK, *Arritja e Ekuilibrit*.

<sup>146</sup> Për hollësi të mëtejshme, shihni RrGGK, *Arritja e Ekuilibrit*.


Qendrat e intervistuarat të kujdesit ndryshonin thelbësisht në numrin e punonjësve që kishin, nga vetëm një në 60 (tabela 14). Mesatarisht, qendrat kishin 14 punonjës, edhe pse numri mesatar i punonjësve ndryshonte sipas komunës. Qendrat në veriun e Kosovës (p.sh. Leposaviq dhe Zubin Potok) kishin prirje të kishin më shumë punonjës sesa qendrat e tjera.

**Tabela 13. Numri i punonjësve në qendrat e kujdesit për fëmijë**

Komuna	Mesatarja	SD	Mediana	Min	Max	N
Gjakovë	8	9	6	1	34	14
Leposaviq	33	19	34	5	56	5
Pejë	16	20	10	5	60	7
Prishtinë	11	8	9	4	30	20
Zubin Potok	21	21	10	8	45	3
<b>Gjithsej</b>	<b>14</b>	<b>14</b>	<b>8</b>	<b>1</b>	<b>60</b>	<b>49</b>

Mesatarisht, për çdo 10 fëmijë shtesë që e frekuentonin qendrën, qendra ka dy punonjës shtesë.<sup>147</sup> Për fëmijët nën tre vjeç, mesatarisht ka dhjetë fëmijë për çdo edukatorë/e. Qendrat në Gjakovë (norma mesatare 12:1) dhe Leposaviq (16:1) kishin më shumë fëmijë për edukatorë/e sesa në Prishtinë (8:1) dhe Peja (7:1).<sup>148</sup> Shumica e qendrave të kujdesit kanë më shumë sesa numri i raportit fëmijë-edukatorë/e të parashikuar nga udhëzimi administrativ për përfshirjen e fëmijëve në institucionet parashkollore, gjë që sugjeron që dy edukatorë/e duhet të kenë maksimalisht dymbëdhjetë nxënës (ose gjashtë për edukatorë/e).<sup>149</sup>

**Grafiku 15. Raporti edukatorë/e-fëmijë në qendrat e kujdesit për fëmijë**



Për fëmijët mbi tre vjeç, mesatarisht ka 12 fëmijë për çdo edukatorë/e. Qendrat në Leposaviq mesatarisht kanë 22 fëmijë për çdo edukatorë/e, krahasuar me dhjetë që kanë ata në Prishtinë dhe shtatë ata në Pejë.<sup>150</sup> Udhëzimi administrativ parashikon që dy edukatorë/e do të kenë më së shumti 23 fëmijë të moshave tre deri në gjashtë vjeç, ose 12.5 fëmijë për edukatorë/e.

Në 75% të qendrave, të gjithë punonjësit punonin me kohë të plotë. Në 12 qendrat e tjera, 67% e qendrave kishin ≥80% punonjës që punonin me kohë të plotë. Një qendër kishte vetëm punonjës me kohë të pjesshme. Në 71% të qendrave, 90% ose më shumë punonjës ishin gra. Kjo nuk është për t'u habitur, kur merret parasysh se puna e kujdesit ka prirje të bëhet kryesisht nga gratë në të gjithë botën, për shkak të roleve tradicionale gjinore.<sup>151</sup>

<sup>147</sup> 95% CI: 1.9, 2.3; p<0.001

<sup>148</sup> P < 0.01

<sup>149</sup> MASHT, Udhëzimi Administrativ nr. 06/2008 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucionet Parashkollore.

<sup>150</sup> P = 0.001

<sup>151</sup> Branch, Kathryn, "Are women worth as much as men?: Employment Inequities, Gender Roles, and Public Policy," [A vlejë gratë po aq sa burrat?: Pabarazitë në punësim, rolet gjinore dhe politikat publike] marrë nga: <http://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1205&context=djglp>.

## Orët e punës të qendrave për kujdesin e fëmijëve

Shumica e qendrave (85%) janë të hapura pesë ditë në javë, 14% janë të hapura gjashtë ditë në javë. Qendrat prireshin të ishin të hapura midis orës 6:00-6:30 (41%) dhe 7:00 të mëngjesit (33%).<sup>152</sup> Qendrat mbyllën midis orës 16:00-16:30 (27%), 17:00-17:30 (33%) dhe 18:00-18:30 (20%), ku mbyllja më e hershme është në orën 12:00 dhe më e vona në orën 20:00. Gjashtëmbëdhjetë qendra (33%) janë mbyllur midis gushtit dhe shkurtit. Duke mos pasur në dispozicion kujdesin për fëmijë gjatë muajve të dimrit, janë shfaqur probleme veçanërisht për gratë që punojnë.<sup>153</sup>

## Çmimi i kujdesit për fëmijë

Tarifat e ngarkuara për kujdesin për fëmijë nisin nga zero në 400 euro. Mesatarisht, qendrat ngarkojnë 69 euro për fëmijë për muaj. Megjithatë, qendrat në Prishtinë ngarkojnë mesatarisht 69 euro më shumë për fëmijë për muaj sesa komunat e tjera.<sup>154</sup> Pothuaj të gjitha qendrat (94%) i zvogëlojnë tarifat për prindërit me më shumë sesa një fëmijë në qendër. Mesatarisht, qendrat ngarkojnë 10 euro më pak për fëmijë për muaj nëse frekuentohen nga disa fëmijë të së njëjtës familje.<sup>155</sup> Njëzet qendra (41%) i marrin fëmijët duke u mbështetur në një normë ditore. Nga këto qendra, 55% ngarkojnë 5 euro në ditë.

**Tabela 14. Kostoja mujore për kujdesin për fëmijë (euro)**

Komuna	Mesat	SD	Median	Min	Max	N
Gjakovë	41	20	35	0	95	14
Leposaviq	28	3	30	25	30	5
Pejë	53	27	60	3	80	7
Prishtinë	112	72	100	50	400	20
Zubin Potok	27	3	25	25	30	3
<b>Gjithsej</b>	<b>69</b>	<b>60</b>	<b>60</b>	<b>0</b>	<b>400</b>	<b>49</b>

## Shpenzimet për qendrat e kujdesit për fëmijë

Disa qendra kujdesi hezituan të jepnin informata të detajuara lidhur me shpenzimet e tyre. Qendrat në veriun e Kosovës (Leposaviq dhe Zubin Potok) nuk dhanë informata lidhur me të dhënat dhe shpenzimet operative të tyre. Përgjigjet e tyre lanë të kuptohej se ndoshta merrnin fonde si nga qeveria e Kosovës, ashtu edhe nga ajo e Serbisë, për pagat dhe shpenzimet e tjera, por këtë nuk e konfirmuan.

**Tabela 15. Paga mujore bruto e punonjësit**

Komuna	Mesatarj	SD	Mediana	Min	Max	N
Gjakovë	282	101	350	100	400	13
Leposaviq*	-	-	-	-	-	5
Pejë	269	6	280	150	350	7
Prishtinë	281	6	250	190	407	20
Zubin Potok*	-	-	-	-	-	3
<b>Gjithsej</b>	<b>279</b>	<b>76</b>	<b>275</b>	<b>100</b>	<b>407</b>	<b>40</b>

\* Refuzuan të jepnin informata.

Mesatarisht, qendrat kanë paguar 279 euro si pagë bruto për punonjësit me kohë të plotë në muaj, ku përfshihen pensionet dhe tatimet (tabela 15). Shuma minimale e paguar ishte 100 euro në muaj, ndërsa shuma maksimale ishte 407 euro.

Mesatarisht, qendrat e kujdesit paguajnë 2,507 euro në muaj si shpenzime operative. Megjithatë, mesatarja është ndryshuar nga disa qendra të cilat kishin kosto operative konsiderueshëm më të larta. Për këtë arsye, mediana prej 1,000 eurosh ndoshta është disi më e saktë. Minimalisht, qendrat kanë pohuar se nuk kanë pasur shpenzime operative. Maksimalisht, një qendër raporti se paguante 13,000 euro në muaj si shpenzime.<sup>156</sup>

<sup>152</sup> Ora më e hershme kur hapej qendra ishte ora 5:00 e mëngjesit dhe ora më e vonshme kur qendra hapej ishte ora 9:00 e paradites.

<sup>153</sup> Gratë në Komunën e Kamenicës, për shembull, kishin kërkuar që komuna të adresonte këtë problematikë (Intervistë e RrGGK-së me zyrtarë komunalë, 2016).

<sup>154</sup> 95% CI: 39, 99

<sup>155</sup> SD: 22; Mediana: 10; IQR: 5-10

<sup>156</sup> Ro-ja e Spearman-it: 0.26, p = 0.12

	€0		€100-850		€1000-3000		>€3000		Pa përgjigje		Gjithsej	
	N	R%	N	R%	N	R%	N	R%	N	R%	N	R%
Gjakovë	0	0	10	71.4	0	0	0	0	4	28.6	14	100.0
Leposaviq	5	100.0	0	0	0	0	0	0	0	0	5	100.0
Pejë	0	0	0	0	3	42.9	3	42.9	1	14.3	7	100.0
Prishtinë	0	0	1	5.0	7	35.0	7	35.0	5	25.0	20	100.0
Zubin Potok	2	66.7	0	0	0	0	1	33.3	0	0	3	100.0
<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>14.3</b>	<b>11</b>	<b>22.4</b>	<b>10</b>	<b>20.4</b>	<b>11</b>	<b>22.4</b>	<b>10</b>	<b>20.4</b>	<b>49</b>	<b>100.0</b>


Midis numrit të fëmijëve në qendër dhe mesatares së shpenzimeve mujore nuk kishte ndonjë lidhje domethënëse nga aspekti statistikor (edhe kur kontrollohej për komunat). Me fjalë të tjera, shpenzimet operative mesatare të përlogaritura mujore nuk bashkëshoqërohen me madhësinë e qendrës së ofrimit të kujdesit për fëmijë.

Nr. i fëmijëve	Mesatarja	Mediana	Min	Max
5-20	242	175	0	800
21-40	1731	1500	0	4500
41-60	2257	1500	600	6500
61-80	6500	5000	1500	13000
81-100	1720	850	0	4000
>100	4011	800	0	12000

Njëmbëdhjetë qendra të kujdesit për fëmijë (22%) kanë marrë përfitime ose subvencione nga shteti: nëntë në Gjakovë dhe dy në Prishtinë. Edhe qendrat e kujdesit për fëmijë në veri merrnin përkeqësim, por nuk i kishin këto informata të gatshme.

## Kërkesa për kujdesin për fëmijë

Në përgjithësi, 43% e qendrave të intervistuar kishin më shumë kërkesa për kujdes për fëmijë sesa hapësira që mund të ofronin. Kërkesa për hapësirë shtesë ishte konsiderueshëm më të ulët në qendrat në Gjakovë (14%) krahasuar me ato në Prishtinë (55%).<sup>157</sup> Nga qendrat me kërkesat më të vogla sesa hapësira në dispozicion, 76% kishin lista pritjeje, ku mediana e fëmijëve në listën e pritjes ishte 18.<sup>158</sup> Kjo ilustron më tej kërkesën e qartë për rritje të numrit të kujdesit për fëmijë që është në dispozicion.



## Sfidat me të cilat përballen qendrat për kujdes të fëmijëve


Shumica e sfidave të zakonshme të qendrave të kujdesit për fëmijë, me të cilat thuhet se përballen, janë "prindërit janë tekanjor" dhe "kostot janë më të larta sesa të ardhurat" (33%). Qendrat në Prishtinë kishin më shumë të ngjarë të listonin kostot si sfida; 55% e qendrave në Prishtinë e listuan këtë si sfida, krahasuar me 17% të qendrave nga komunat e tjera.<sup>159</sup>

<sup>157</sup> P = 0.01

<sup>158</sup> IQR 10-30

<sup>159</sup> P = 0.01

**Grafikoni 17. Sfidat kryesore me të cilat përballen qendrat e kujdesit për fëmijë (sipas % së qendrave)**



Në sfidat e tjera të përmendura nga qendrat përfshihen: shpenzimet jokonsistente të elektricitetit dhe shpenzime të ndërlidhura me të, probleme ngrohjeje gjatë dimrit (gjashtë qendra); prindër që nuk ishin të gatshëm të shpenzonin kohë shtesë për t'i ndihmuar fëmijët me detyrat e shtëpisë; konkurrenca; trajnimi i pamjaftueshëm i ofruar nga MASHT-i për stafin e qendrës së kujdesit për fëmijë; orari jo i rregullt i ardhjes së ujit; prindërit kërkojnë më shumë shërbime nga ato që do të paguajnë; procedura burokratike dhe mungesë asistence kur bëhet plotësimi i dokumenteve për MASHT-in dhe drejtorinë komunale të arsimit; mungesa e edukatorëve/eve me kualifikimet e duhura për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta; dhe dixhitalizim i pamjaftueshëm i shërbimeve.

### Shërbimet e kujdestareve dhe të dadove

Aktualisht, ligji i Kosovës nuk e rregullon punën e kujdestareve dhe kujdestaret nuk duhet të regjistrohen. Për këtë arsye, është e vështirë të identifikohet se sa kujdestare ka në Kosovë, çfarë kualifikimesh kanë dhe sa kërkojnë për pagesë. Sipas të dhënave jozyrtare një kujdestare individuale mund të kushtojë afërsisht nga 150 deri në 270 euro në muaj. Kësisoj, pasja e një kujdestareje do të kushtonte konsiderueshëm më shumë sesa qendrat private apo publike të kujdesit për fëmijë, kështu që kujdestaret mund t'i përballojnë ekonomikisht vetëm familjet me të ardhura të larta. Sikurse u përmend, shumë pak prindër të punësuar, që u intervistuan, raportonin se kishin angazhuar kujdestare (d.m.th. "një person në shtëpi").

Ekzistojnë të paktën tri agjenci që ofrojnë shërbime të dadove.<sup>160</sup> Agjencia "Mother Care" (Kujdesi i nënës) për shembull, ka dado të trajnuara të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit për fëmijë për 270 euro në muaj, që i paguhen drejtpërdrejt kompanisë. Kompania merr përgjegjësinë për dadot dhe ofron zëvendësime të menjëhershme në rastet kur kujdestarja nuk shfaqet apo është sëmurë. Në veriun e Kosovës, organizata joqeveritare (OJQ) Qendra për Zhvillimin e Grave ka trajnuar 40 gra për të punuar si kujdestare dhe ka operuar si agjenci, duke vendosur lidhje midis kujdestareve dhe vendeve të punës që prej vitit 2015.<sup>161</sup> Deri më sot, agjencia ka gjetur punë për 15 gra. Tarifa mujore është 25 euro, ndërsa prindërit që e përdorin këtë shërbim çdo ditë paguajnë 3 euro për orë. Ekzistojnë edhe faqet e internetit për të gjetur kujdestare dhe dado, të tilla si [www.bebaime.com](http://www.bebaime.com) dhe <http://www.smartdado.com/>.

<sup>160</sup> RrGGK nuk ka mundur të gjejë ofruesin tjetër, NINA Nana, meqenëse informatat e tij ishin të vjetërsuara. Shumica e informatave në këtë pjesë janë bazuar në të dhënat e njërit prej recesentëve të këtij raporti, bazuar në informata jo formale.

<sup>161</sup> Kjo nismë është mbështetur nga programi i fuqizimit i Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).



## Përfundime

Pothuajse të gjitha gratë e papunësuar që janë anketuar do të dëshironin të punësoheshin në një punë që paguhet. Shumica (88%) do të përdornin shërbimet e kujdesit për fëmijë nëse do të kishin ndonjë opsion të përballueshëm ekonomik. Mesatarisht, ata e konsideronin shumë prej 40 eurosh në muaj si të përballueshme. Qendrat e kujdesit për fëmijë ndodhen kryesisht në Prishtinë dhe qasja në qendrat e kujdesit për fëmijë për personat që jetojnë në zonat rurale është e kufizuar. Një shqyrtim i të dhënave demografike të krahasuara me kujdesin për fëmijë që është në dispozicion sugjeron që aktualisht rreth 145,977 fëmijë nuk kanë çasje në kujdesin e fëmijëve në Kosovë; nevojat e paplotësuara për shërbime të kujdesit për fëmijë është më e madhe në komunat e Prishtinës (16,562 fëmijë); Prizrenit (14,993) dhe Ferizajt (8,997). Dymbëdhjetë komuna duket se nuk kanë kujdes ndaj fëmijëve për fëmijët nën 5 vjeç (shih Shtojcën 3).

Duke u mbështetur vetëm në gjetjet e hulumtimit të RrGGK-së, është e vështirë të arrihet në një kosto të saktë të propozuar për kujdesin për fëmijët; disa qendra nuk ofruan informata lidhur me shpenzime, ndërkohë që kostot mund të ndryshojnë në varësi të llojit të shërbimit të ofruar dhe lokacionit. Gjatë shqyrtimit, prindërit e punësuar u shprehën se kujdesi publik për fëmijë mesatarisht iu kushton rreth 40 euro në muaj, ndërkohë kujdesi privat iu kushton 80 euro në muaj. Punonjësit ishin të gatshëm të paguanin rreth 50 euro në muaj për shërbime të kujdesit për fëmijë. Tarifa mesatare për fëmijë, e raportuar nga qendrat private të kujdesit për fëmijë, ishte 70 euro në muaj. Zyrtarët publikë u shprehën se kujdesi publik kushton nga 35 deri në 50 euro në muaj. Kostoja e kujdesit ndryshonte në varësi të komunës, psh. në Prishtinë kushtonte konsiderueshëm më shumë sesa ai në komunat e tjera.

## Vlerësimi i kostos së kujdesit

Krahas marrjes parasysh të kostove operacionale, vlerësimet e sakta për kujdesin për fëmijë duhet të pasqyrojnë kostot reale të ofrimit të kujdesit cilësor, i cili i plotëson standardet e sipërpërmendura ligjore të caktuara në Kosovë. Këtu bën pjesë marrëdhënia me kërkesat hapësinore, shëndetin, sigurinë, edukatorët/et e kualifikuara, stafin mbështetës, ushqyerjen, programimin arsimor dhe materialet didaktike (p.sh. librat dhe materialet e harxhueshme).<sup>162</sup> Po ashtu, prindërit thanë se presin që qendrat e kujdesit për fëmijë të ofrojnë opsione për ushqim të shëndetshëm, ambiente higjienike, program të mirë edukativ dhe staf të kualifikuar.

Edhe shërbimet e paguara të kujdesit për fëmijë duhet të njohin si duhet shërbimet e ofruara nga punëtorët e kujdesit.<sup>163</sup> Puna e kujdesit kërkon kohë dhe prani në orare dhe vende të veçanta në të cilat ekziston nevoja.<sup>164</sup> Kujdesi i duhur shpesh kërkon që ofruesi i shërbimit të krijojë një marrëdhënie me marrësin e shërbimit. Këtyre aspekteve të kujdesit dhe përkujdesjes duhet t'u kushtohet vëmendje kur diskutohet komodifikimi i kujdesit. Puna e paguar e përkujdesit shpeshherë nënvlerësohet dhe punonjësit që ofrojnë kujdesin mund të jetojnë në varfëri për shkak të pagave të ulëta dhe kushteve të dobëta të punës.<sup>165</sup> Transformimi i kujdesit pa pagesë në kujdes me pagesë nuk do t'i shërbejë grave (apo burrave) nëse puna e kujdesit nënvlerësohet. Në çdo qasje të re për të rritur mundësitë e kujdesit për fëmijë, duhet të sigurohen pagat e drejta dhe trajtimi i drejtë i punonjësve në qendrat e kujdesit.

---

<sup>162</sup> Koment i bërë nga kolegu shqyrtues në draftin e raportit, 2016.

<sup>163</sup> Himmelweit, Susan, Divizioni i OKB-së për Avancimin e Grave, *Rethinking Care, Gender Inequality and policies*, [Të rimendosh kujdesin, pabarazitë dhe politikat gjinore] 2008, fq. 2, marrë nga: <http://www.un.org/womenwatch/daw/egm/equalsharing/EGM-ESOR-2008-EP-7%20Susan%20Himmelweit.pdf>.

<sup>164</sup> Po aty.

<sup>165</sup> Për shembull, një studim në Mbretërinë e Bashkuar gjeti se disa punonjës të kujdesit jetojnë nën pagën minimale kombëtare (për informata të mëtejshme, shihni: Matthew Pennycook, Fondacioni Resolution, *Does it pay to care? Under-payment of the National Minimum Wage in the social care sector* [A paguhesh të kujdesesh? Pagesa nën pagën minimale kombëtare në sektorin e kujdesit social], MB: Fondacioni Resolution, gusht 2013, marrë nga: <http://www.resolutionfoundation.org/wp-content/uploads/2013/08/Does-it-pay-to-care.pdf>).

RrGGK-ja ka bërë vlerësime të përgjithshme të kostove potenciale të ofrimit të kujdesit cilësor për fëmijët pesë ditë në javë, për tetë orë në ditë (shihni tabelën 19). Kostoja e vlerësuar për edukatorët/et mbështetet në shumën që i paguhet aktualisht edukatorëve/eve të institucioneve parashkollore publike, duke mbajtur parasysh formimin e tyre arsimor dhe njohjen e cilësisë së punës së kryer.<sup>167</sup> Ulja e pagës nuk do të njihet dhe vlerësonte rolin e rëndësishëm që luajnë edukatorët/ et në arsimimin e fëmijëve të institucioneve parashkollore. Edukatorët/et mund të ndihmohen nga një asistent teknik me më pak kualifikime, sikurse parashihet me ligj, në shumën bruto prej 279 euro. Numri i edukatorëve/eve mbështetet në raportin ideal dhe ligjor të fëmijëve për edukatorë/e. Në këto përlogaritje nuk përfshihet stafi administrativ, i cili mund të nënkuptojë kosto shtesë.

**Tabela 18. Vlerësimi i shpejtë vjetor i kostove të kujdesit për 20 fëmijë**

Shpenzimet	Njësia	Kostot për njësi	Nr. i njësive	Gjithsej
Paga bruto për edukatorët/et	Edukatorët/et /muaj	€462	12	€5,474
Paga bruto për ndihmës edukatorët/et	Edukatorët/et /muaj	€383	12	€4,596
Mëngjes	Fëmijë/ditë	€1.5	4800	€7,200
Drekë	Fëmijë/ditë	€2	4800	€9,600
Vakte të shpejta (dy)	Fëmijë/ditë	€1.5	4800	€7,200
Materiale didaktike të harxhueshme	Fëmijë/muaj	€2	240	€480
Lodrat dhe investimet	Në muaj	€50	12	€600
Shërbime të pastrimit (dy herë në javë)	Për ditë	€15	100	€1,500
Lyerja	Për herë	€1,000	1	€1,000
Dezinfektimi	Për herë	€400	2	€800
Mirëmbajtja	Muaj	€20	12	€240
Edukatorët/et zëvendësues <sup>166</sup>	Ditë	€50	24	€1,200
Shërbimet komunale (uji, ngrohja, energjia elektrike)	Muaj	€60	12	€720
Trajnimi i stafit	Edukatorët/et	€100	2	€200
Tarifat bankare		€12	12	€144
<b>Gjithsej</b>				<b>€41,204</b>

Përlogaritjet e shpenzimeve të tjera u mbështetën në kostot e përafërta të shërbimeve në Prishtinë, të cilat mund të kushtojnë më shumë sesa në lokacionet e tjera. Përlogaritjet nuk përfshijnë koston e qirasë apo taksave mbi pronën (nëse qendrat janë pronësi private), meqenëse këto kosto mund të ndryshojnë në mënyrë thelbësore. Nëse përdoren ndërtesat publike, këto kosto nuk do të ekzistojnë. Sipas këtyre përlogaritjeve, menaxhimi i një qendre cilësore të kujdesit për fëmijë për 20 fëmijë nga mosha tre deri në gjashtë vjeç do të kushtonte përafërsisht 41,024 euro në vit. Të ndara midis 20 fëmijëve, kostoja e kujdesit do të kapte shifrën prej 171 euro për fëmijë në muaj. Për fëmijët më të vegjël, kujdesi do të kushtonte më shumë për shkak të kërkesës ligjore për dyfishin e edukatorëve/eve, duke kapur shifrën e 52,564 euro çdo vit dhe 219 euro për fëmijë çdo muaj.

Nëse rritet numri i fëmijëve, pa marrë parasysh asnjë kosto shtesë që lidhet me hapësirën, kostoja e kujdesit ullet sepse kostot e përgjithshme operative ndahen midis një numri më të madh fëmijësh, edhe kur merret parasysh nevoja për punësimin e më shumë edukatorëve/eve. Për shembull, për 100 fëmijë të moshave tre deri gjashtë vjeç, kostoja për fëmijë do të binte në 155 euro në muaj dhe 195 euro në muaj për fëmijët më të vegjël. UNICEF-i aktualisht është duke kryer një shërbim tërësor lidhur me kostot aktuale të kujdesit, i cili do të publikohet në fundin e vitit 2016, dhe që ka të ngjarë të ofrojë përlogaritje edhe më të sakta dhe të mbështetura në dëshmi.

Përderisa prindërit në përgjithësi kujdesen për cilësinë e programit arsimor dhe ushqimet që iu jepen fëmijëve të tyre, paraqitja e qartë e kostove reale të ofrimit të kujdesit cilësor për fëmijë mund t'i bëjë prindërit më të gatshëm të paguajnë norma më të larta për kujdesin për fëmijë, duke marrë parasysh, aty ku është e mundur, nivelin e tyre të të ardhurave. Ndoshta qendrat e kujdesit mund të ndajnë me prindërit në mënyrë transparente shpenzimet reale që lidhen me kujdesin që ato ofrojnë, me qëllim që prindërit të kuptojnë më mirë kostot e kujdesit cilësor për fëmijët. Kjo mund t'i nxisë prindërit që të angazhohen më shumë në përkrahjen e përpjekjeve për ngritje të fondeve alternative për qendrat e kujdesit për fëmijë.

<sup>166</sup> Kjo mbështetet në supozimin se mesatarisht secili edukatorë/e do të humbë një ditë pune në muaj.

<sup>167</sup> Vlerësimet e pagës nga bashkëbiseda e RrGGK me MASHT, 10 tetor 2016.

# Modelet opsionale për rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë

Bazuar në të gjeturat e lartpërmendura dhe bisedat me palët e interesuara, ekzistojnë disa modele të mundshme për investim në rritjen e mundësive për kujdesin për fëmijët. Çdo model që përshkruhet më poshtë ka përfitime dhe rreziqe të mundshme. Pasi që RrGGK-ja nuk ka siguruar prova të mjaftueshme që do të mbështesnin rekomandimin e një modeli të vetëm, janë paraqitur disa opsione që mund të kontribuojnë në rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë. Komuna individuale, biznese private dhe donatorë do të zgjedhin modelin apo kombinimin e modeleve që do të kryenin punë më së miri me grupin specifik të synuar, në bazë të nevojave lokale, mundësive dhe burimeve në dispozicion.

## Modeli 1. Zgjerimi i kujdesit publik të financuar nga shteti

Sigurimi i qasjes në kujdesin kualitativ të fëmijëve është përgjegjësi e shtetit sikurse është përcaktuar në Kushtetutë dhe Ligjin për Edukimin Parashkollor, i cili përcakton që autoritetet e komunave duhet të plotësojnë nevojat e komunitetit<sup>168</sup>. Rritja e mundësive në kujdesin për fëmijë është një prioritet i SKZH-së. Për më shumë, shumica e femrave të papunësuar që janë anketuar kanë thënë që ato do të preferonin të përdornin objektet për kujdesin e fëmijëve që drejtohen nga qeveria.

Edukimi parashkollor financohet përmes granteve të veçanta për edukim nga buxheti kryesor i Republikës së Kosovës; të ardhurat vetanake që gjenerohen nga institucionet edukative dhe trajnuese dhe granteve të komunave. Shuma e grantit specifik llogaritet në përputhje me një formulë të ndarjes, bazuar në regjistrimin e nxënësve dhe standardeve që vihen nga MASHT-i. Komisioni për Grante krijon formulën duke marrë parasysh planin mësimor kombëtar, edukimin për nevoja të veçanta, shpenzimet operative që nuk paguhen nga paga, normat e madhësisë së klasave dhe vendndodhjen<sup>169</sup>. Sidoqoftë, sipas raportit të vitit 2015 të MASHT-it, financimi i edukimit parashkollor nuk ka ndryshuar shumë në katër vitet e fundit, "gjë që tregon që komunat nuk kanë punuar për të rritur numrin e kopshteve"<sup>170</sup>. Komunat duhet të ndajnë fonde nga çdo buxhet vjetor për të rritur numrin e vendeve në dispozicion në qendrat e kujdesit për fëmijë që financohen nga shteti, në përputhje me nivelin e nevojave të çdo komune.

Zyrtarët lokal të qeverisë në komunat e Prishtinës, Pejës, Gjakovës dhe Kamenicës u shprehën se nuk kanë buxhet për të krijuar qendra të reja të kujdesit për fëmijë. Ndonëse disa nga to kanë kërkuar financim për të rritur mundësitë e kujdesit për fëmijë, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve lokal, kërkesat e tyre ishin refuzuar nga Ministria e Financave<sup>171</sup>. Ministria e Financave duhet të mbështesë këto kërkesa kur ato janë në linjë me obligimet ligjore të institucioneve publike, janë demonstruar provat se ekziston nevoja, ndërkohë që është shfaqur edhe përkrahja nga publiku.

Duke marrë parasysh kufizimet e buxhetit të Kosovës, qendrat e kujdesit që financohen nga qeveria nuk do të jenë në gjendje që të arrijnë të vetme nivelin e kërkesave për shërbime të kujdesit menjëherë. Kështu që në mënyrë që të plotësohen nevojat e qytetarëve, komunat duhet të kërkojnë rrugë shtesë, alternativa tjera, për të rritur mundësitë e kujdesit për fëmijë. Organizime të ndryshme buxhetore po ashtu mund të ndajnë resurse për të mbështetur rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë, siç lidhen me rolin dhe përgjegjësitë e tyre specifike. MASHT-i duhet të mbështesë numrin e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe të rrisë cilësinë e edukimit para shkollor siç parashihet nga Ligji për Edukimin Parashkollor. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) mund të dizajnojë skema sociale dhe të ndajë resurse për të subvencionuar kujdesin për fëmijë për familjet me të ardhura të ulëta, prindërit e vetëm, personat e papunësuar kur marrin pjesë në intervistat e punës, personat e papunë që ndjekim

<sup>168</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 50 (paragrafi I) dhe Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 2006/02-L-52 mbi Edukimin Parashkollor, Neni 7.

<sup>169</sup> Kuvendi i Kosovës, Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Neni 25 (4), <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2525>

<sup>170</sup> MASHT, *Raporti i Vlerësimit të Planit Strategjik të Edukimit 2011-2016, 2015, faqe 102*, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/02/raport-vleresimi-psak-2011-2016-shq-web.pdf>

<sup>171</sup> Intervista të RrGGK-së me zyrtarë nga këto komuna, 2016.

trajtime profesionale dhe të mbijetuarit e dhunës gjinore<sup>172</sup>. Për më tepër, institucionet publike parashkollore mund të mbledhin fonde nga prindërit që pranojnë shërbime, donacione nga prindërit, shitjet e produkteve dhe shërbimeve, donacionet e komunitetit, dhuratat dhe mallra të tjerë<sup>173</sup>. Procedurat për mbledhjen e këtyre resurseve përcaktohen përmes një marrëveshjeje speciale mes institucionit dhe Ministrisë së Financave<sup>174</sup>.

Pasi që hapësira në qendrat e kujdesit për fëmijë që financohen nga shteti do të jetë e kufizuar në të ardhmen e parashikueshme, bazuar në mësimet e nxjerra nga Komuna e Prishtinës, politikat për t'i dhënë prioritet grupeve të disavantazuara si pranues të kujdesit që financohet nga shteti duhet të aplikohen në të gjithë vendin. Kjo përfshin fëmijët e prindërve të papunë, fëmijët e prindërve të vetëm, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e të mbijetuarve/ave nga dhuna gjinore. Pas grupeve të disavantazuara, nëse mbetet hapësirë në qendrat e financuara nga shteti, fëmijët e prindërve me të ardhura të vogla do të kenë prioritet. Ndërkohë, përmes politikave dhe në disa raste përmes subvencioneve, shteti mund të mbështesë iniciativa të tjera për të rritur mundësitë e kujdesit për fëmijë siç detajohet më poshtë e që do të mund të përfshinte kosto më të ulëta për shtetin.

## **Modeli 2. Partneritetet Publiko-Private**

Partneriteti publiko-privat (PPP) është një partneritet që bëhet në mes të subjekteve private dhe atyre publike për të siguruar shërbime. Banka Botërore e përkufizon PPP-në si: “një kontratë afatgjate në mes të një pale private dhe një subjekti qeveritar për të siguruar një aset publik apo shërbim, në të cilën pala private bart rrezik të madh dhe përgjegjësi për menaxhimin dhe ku shpërblimi lidhet me performancën”<sup>175</sup>. Sa i përket shërbimeve të kujdesit për fëmijë, një PPP mund të përfshijë krijimin e një partneriteti në mes të sektorit publik dhe atij privat për të krijuar dhe/ose menaxhuar një apo më shumë qendra të kujdesit për fëmijë. Ekzistojnë disa shembuj pozitivë të PPP-ve që sigurojnë shërbime të kujdesit në shtetet tjera.<sup>176</sup>

Në Kosovë, të gjitha PPP-të rregullohen me Ligjin Nr. 04/L-045 mbi Partneritetin Publiko-Privat<sup>177</sup>, çdo autoritetet publike, duke përfshirë këtu edhe komunat, Komisionin për PPP-në apo Departamentin e PPP-së, mund të identifikojnë, propozojnë apo iniciojnë një PPP. Së pari, autoriteti publik përkatës kryen një studim të fizibilitetit të projektit bazuar në “parimet e vlerës për para”, që paraqitet tek Komisioni i PPP-së. Nëse Komisioni i PPP-së e aprovon projektin, ai autorizon procedurat e tenderimit. Pastaj, ofertuesit e interesuar mund të paraqesin aplikacionet brenda limiteve kohore të parapara me ligj<sup>178</sup>. Ofertuesit e interesuar duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që janë përcaktuar me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Ligjin për Partneritetin Publiko-Privat<sup>179</sup>. Projektet që kanë të bëjnë me shërbimet publike komunale duhet të përmbushin kritere shtesë: 1) projekti duhet të jetë nën kompetencat komunale siç është përcaktuar nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale; 2) komuna duhet të sigurojë financim adekuat për implementimin e projektit; dhe 3) komuna duhet të sigurojë një shpërndarje të rrezikut në mes të sektorit publik dhe atij privat<sup>180</sup>.

<sup>172</sup> Ligji për Edukimin Parashkollor parashikon që grupet e shtrira në spital, fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët e invalidëve të luftës do t'u paguhet parashkollimi nga buxheti i Kosovës (Neni 25).

<sup>173</sup> MASHT, Udhëzim Administrativ 2/2008 Mjetet e Dedikuara për Financimin e Edukimit Parashkollor Publik dhe Mënyra e Shpenzimit të Tyre, Seksioni 3, tek: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=7561>

<sup>174</sup> I njëjti burim, Seksioni 4 (2)

<sup>175</sup> Banka Botërore, “Partneriteti Publiko-Privat në Infrastruktūrën e Qendrave Burimore”, <http://ppp.worldbank.org/public-private-partnership/overview/what-are-public-private-partnerships>.

<sup>176</sup> Për shembull, Partneriteti ekzekutiv i Kujdesit për Fëmijë i Floridas bashkon punëtorët, qeverinë shtetërore, qeverinë federale dhe ofruesit e kujdesit për fëmijë; punëtorët subvenciojnë koston e kujdesit kualitativ dhe shkollimin e hershëm për familjet që punojnë por kanë të ardhura të ulëta (Fëmijët dhe Familjet, Zyra e Kujdesit për Fëmijë, *Partneriteti Ekzekutiv i Kujdesit për Fëmijë i Floridas*, [https://childcareta.acf.hhs.gov/sites/default/files/public/florida\\_profile.pdf](https://childcareta.acf.hhs.gov/sites/default/files/public/florida_profile.pdf)).

<sup>177</sup> Republika e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-045 mbi Partneritetin Publiko-Privat, Neni 2 (1.7), <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2784>

<sup>178</sup> I njëjti burim, Neni 26

<sup>179</sup> I njëjti burim, Neni 27

<sup>180</sup> Po aty, Neni 22

Ligji për Edukimin Parashkollor po ashtu parashikon që buxheti komunal mund të sigurojë fonde për mirëmbajtje dhe investim në pronat dhe objektet publike parashkollore, brenda institucioneve parashkollore që veprojnë në bazë të koncesionit<sup>181</sup>. Për më tepër, ky ligj parasheh që në lokacionet që nuk kanë institucione parashkollore apo institucione që nuk kanë hapësirë të mjaftueshme, “MASHT-i dhe institucioni përkatës i komunës do të kenë për qëllim të mbështesin financiarisht iniciativat jo-publike që sigurojnë edukim parashkollor”<sup>182</sup>. Ky ligj lejon dhe rregullon financimin në institucionet parashkollore përmes buxhetit të Kosovës, financuesve, prindërve, donacioneve dhe resurseve të tjera<sup>183</sup>. MASHT-i dhe komunat janë përgjegjëse për mbështetjen financiare të institucioneve private parashkollore, qendrave në komunitet dhe institucioneve parashkollore jo-publike<sup>184</sup>. Në të vërtetë, një Raport i Vlerësimit të Planit Strategjik Arsimit të Kosovës për vitet 2011-2016 ka rekomanduar të përdoren PPP-të si një “zgjdhje e mundshme për të rritur kapacitetet e edukimit parashkollor”<sup>185</sup>.

Korniza ligjore e Kosovës mundëson që PPP-të të sigurojnë shërbime të kujdesit për fëmijë, ndërkaq vetëm një qendër e kujdesit për fëmijë dihet që ekziston në Kosovë<sup>186</sup>. Në 2010, Komuna e Prishtinës bëri një thirrje për qendrat private të kujdesit që të ofertojnë për PPP. Qendra për kujdes të fëmijëve *Fillesa* u shpall fituese dhe kjo qendër u hap më 2010. Në vitin e parë qendra kishte vetëm 12 fëmijë. Ndërsa tani në viti 2016 qendra ka 120 fëmijë të moshave të ndryshme. Marrëveshja me Komunën është për një periudhë prej 30 vitesh. Çdo 10 vite, qendra dhe Komuna rishikojnë marrëveshjen. Sipas marrëveshjes, Komuna aktualisht paguan 42 euro në muaj për një fëmijë që shkon në qendrën e kujdesit, përdërisa prindërit e fëmijëve paguajnë 50 euro të tjera. Me mbështetjen e Komunës, qendra e kujdesit paguan pagat e mësuesve. Qendra është përgjegjëse për kostot e tjera operative. MASHT-i siguron trajnime për stafin e qendrës për të avancuar performancën e stafit<sup>187</sup>.

Zyrtarët komunalë shprehin një gatishmëri të përgjithshme për të krijuar PPP-të, veçanërisht nëse kjo do të ndihmonte në adresimin e nevojave të qytetarëve, edhe pse disa besojnë që procedurat e lartpërmendura janë shumë të komplikuar, gjë që vështirësoi krijimin e PPP-ve<sup>188</sup>. Megjithatë, komunat mund të konsiderojnë ndarjen e financimit brenda kategorisë ekonomike të transfereve dhe subvencioneve të tyre për të mbështetur PPP-të në lidhje me kujdesin për fëmijët.

Funksionimi aktual i PPP-ve mund të bazohet në mundësitë dhe nevojat e komunës. PPP-të mund të funksionojnë si qendra private të kujdesit të kontraktuar nga qeveria dhe të përzgjedhura përmes procesit ofertues, përmes të cilit qeveria do të deklaronte qartë rolin e saj dhe rolin e ofruesit, duke përfshirë përgjegjësitë financiare dhe menaxhuese përkatësisht të qeverisë dhe të kontraktorit privat. Kjo është e ngjashme me modelin e PPP-ve që përdoret nga Komuna e Prishtinës dhe *Fillesa*. Në zonat ku janë të vendosura kompanitë e mëdha (p.sh. në Pejë dhe Prishtinë), komunat mund të kërkojnë bashkëpunim me sektorin privat për të iniciuar procedurat për ndërtimin e qendrave të kujdesit<sup>189</sup>. Në mënyrë që të rritet transparencja dhe qeverisja demokratike e PPP-ve, duke përfshirë edhe financat publike që janë ndarë, institucionet e përfshira do të mund të krijojnë një këshill lokal, të përbërë nga prindërit, dhe që është përgjegjës për përzgjedhjen dhe mbikëqyrjen e menaxhimit të qendrave të kujdesit. Menaxhmenti pastaj do të duhej të mbante përgjegjësi për zgjedhjen e stafit tjetër sipas nevojës dhe menaxhimin ditor të operacioneve të qendrës.

<sup>181</sup> Ligji Nr. 02/L-52 për Edukimin Parashkollor, Neni 21(3).

<sup>182</sup> Po aty, Neni 27.

<sup>183</sup> Po aty, Neni 18. “Programet e edukimit parashkollor mund të financohen nga : (a) Buxheti i Kosovës; (b) Themeluesit; (c) Pagesat nga prindërit; (d) Donacionet dhe burimet tjera.”

<sup>184</sup> Po aty, Neni 27. Kur bëhet zgjedhja e vendit ku do të themelohen qendrat, do të duhet të merren parasysh: a) Pozita gjeografike e komunitetit ku ofrohet ky shërbim, duke marrë parasysh sidomos zonat rurale dhe ato të lëna pas dore; b) Shërbimet për fëmijë me nevoja të veçanta; c) Personeli i institucioneve parashkollore duhet të jenë të punësuar në baza të rregullta ligjore; d) Qasja të jetë e hapur për të gjithë fëmijët.

<sup>185</sup> MASHT, *Raport i Vlerësimit të Planit Strategjik të Edukimit 2011-2016, 2015, faqe 111*, <https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/02/raport-vleresimi-psak-2011-2016-shq-web.pdf>

<sup>186</sup> Intervistë e RrGGK -së me znj. Arberia Nagavci, Udhëheqëse e Drejtorisë së Arsimit, Komuna e Prishtinës, 2016.

<sup>187</sup> Intervistë e RrGGK -së me Merita Dili, pedagoge në Fillesa, 21 shtator 2016, Prishtinë.

<sup>188</sup> Intervistë e RrGGK -së me udhëheqësit e departamenteve financiare në Komunën e Gjakovës dhe Pejës.

<sup>189</sup> Ligji për Partneritet Publiko-Privat përcakton këta autoritete si: “Autoritet kontraktues - një autoritet publik i cili ka hyrë në një marrëveshje për partneritet publiko-privat në pajtim me dispozitat e këtij ligji.” (Neni 3 (1,1))

### **Modeli 3. Inkurajimi i bashkë-financimit privat të përkujdesjes për fëmijë**

Punëdhënësit mund të inkurajohen, mundësisht me mbështetje të donatorëve apo komunës, për të zhvilluar objektet private të përkujdesjes për fëmijë brenda apo afër vendeve të tyre të punës. Rasti i studiuar më herët i bankës Raiffeisen ofron një model. Nëse një punëdhënës nuk ka punëtorë me fëmijë, të mjaftueshëm për të mbështetur një qendër të vetme, burimet mund të grumbullohen për të krijuar një qendër të kujdesit që përdoret nga shumë punëdhënës në atë zonë.

Siç e përmendëm, disa punëdhënës kanë shprehur interes që të përfshihen në bashkë-financimin e kujdesit për fëmijë për punëtorët e tyre. Në mes të punëtorëve, 56% kanë thënë që nëse kompania në të cilën ata punojnë do të ofronte shërbime të përkujdesjes për fëmijë në objektet e saj apo afër, ata sigurisht që do t'i përdornin ato objekte, ndërkohë që 6% e tyre me "shumë mundësi" do t'i përdornin. Kishte një dallim të madh statistikor të gatishmërisë së punëtorëve për të përdorur shërbimet e përkujdesjes për fëmijë në bazë të moshës dhe komunës. Punëtorët në Prishtinë kishin 5.4 herë më shumë të ngjarë të përdornin shërbimet e kujdesit për fëmijë në objektet e kompanive të tyre sesa të atyre në komuna të tjera<sup>190</sup>. Punëtorët më të vjetër ishin disi më të gatshëm për të përdorur shërbimet e kompanisë<sup>191</sup>.

Si një nxitje, donatorët apo komunat mund të konsiderojnë financimin apo bashkë-financimin e investimeve fillestare në qendrat e kujdesit bashkë me një ose më shumë biznese. Pas diskutimit të mëtejshëm mbi atë se si do të funksiononin këto modele me secilin biznes, mund të nënshkruheshin kontrata mes donatorit, biznesit dhe komunës së mundshme lokale, sipas rrethanave, duke specifikuar rolin dhe përgjegjësitë e secilës palë. Për shembull, donatorët mund të mbështesnin renovimin e hapësirave të ndonjë biznesi ekzistues apo konstruktimin e disa qendrave të reja në tokë private për përdorim të qartë nga institucionet e përkujdesjes për fëmijë për një periudhë kohore të caktuar me kontratë.

Një mundësi e dytë do të ishte që komunat të lëshonin pronën publike për një periudhë kohore për të mbështetur qendrat private të përkujdesjes për hapjen apo zgjerimin e zonave ku është identifikuar nevoja. Në komunat ku qeveria lokale ka prona (p. sh. ndërtesa të vjetra të fabrikave, shkollat etj.), ato mund të lejojnë subjekte private të rinovojnë pronën dhe të menaxhojnë qendrën e kujdesit për fëmijë. Në komunat ku prona nuk është në dispozicion, sikurse ndodh në Gjakovë ku prona i përket Agjencisë Kosovare të Pronës<sup>192</sup>, komuna mund të ndajë tokë publike për përdorim të përkohshëm nga qendrat e kujdesit. Ligji Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës rregullon mënyrën se si "komunat mund të japin pronë të paluajtshme për përdorim, duke përfshirë këtu edhe tokat dhe ndërtesat që janë në pronësi të komunës"<sup>193</sup>.

Një mundësi e tretë për mbështetjen e rritjes së mundësive të kujdesit për fëmijë, komunat mund t'iu ofrojnë stimulime aktorëve privatë sikurse: heqja e tatimit aty ku është e mundshme. Ndoshta komunat po ashtu do të mund të mbulonin disa nga kostot operative të qendrave të përkujdesit për fëmijë sikurse shërbimet komunale, si pjesë e marrëveshjes që bëhet me bizneset private që ofrojnë kujdes për fëmijë në zonat ku ky shërbim nuk i përmbush nevojat.

Çdonjëra nga këto opsione mund të shërbejë si projekt pilot. Më pas, ndikimi që ka ofrimi i shërbimeve të kujdesit për fëmijë në cilësinë e punëtorëve të rekrutuar, cilësia e punës së tyre, produktiviteti dhe ditët që kanë munguar në punë, mes faktorëve të tjerë, mund të maten me kalimin e kohës. Mësimet që nxirren nga këto pilot projekte mund të informojnë përpjekjet për të simuluar iniciativa të ngjashme tek bizneset e tjera. Nëse është i suksesshëm, ai mund të sigurojë një model pozitiv për bizneset tjera që mund të binden pastaj me prova për të bërë investime të ngjashme.

---

<sup>190</sup> 95% CI: 2.1, 14.3; p=0.001.

<sup>191</sup> P = 0.002. Nuk ishte ndonjë dallim në bazë të gjinisë.

<sup>192</sup> Po aty.

<sup>193</sup> Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Neni 3 (1.2): <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2858>.

## Modeli 4. Zgjerimi i qendrave të kujdesit për fëmijë me bazë në komunitet

Qendrat e kujdesit për fëmijë me bazë në komunitet funksionojnë në bazë të bashkëpunimit të komunitetit dhe komunës. Komuna e Prishtinës e ka përdorur këtë model, aktualisht duke mbështetur pesë qendra të tilla që mund të shërbejnë si një shembull konkret për komunitet e tjera. Komuna e Prishtinës e konsideron këtë model më praktik dhe procedurën për të krijuar qendra të tilla të kujdesit për fëmijë si më miqësore për komunitetin dhe qeverisjen lokale sesa PPP-ët<sup>194</sup>. Sipas një zyrtari, me qendrat e kujdesit për fëmijë me bazë në komunitet, prindërit janë më të përfshirë në jetët e fëmijëve, mbikëqyrin shërbimet e kujdesit për fëmijë më afër dhe përforcojnë ndjenjat e komunitetit në vend që të kemi gara ndërmjet ndërmarrjeve private.

Në mënyrë që të krijohet një qendër me bazë në komunitet, së pari komuniteti duhet t'ia drejtojë kërkesën për të rritur numrin e hapësirave në dispozicion të kujdesit për fëmijë kuvendit komunal gjatë seancave publike. Pasi të miratohet kërkesa nga kuvendi komunal, Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Pronave duhet të identifikojnë të gjitha objektet publike apo tokat që janë të regjistruara si pronë komunale. Pasi komuna të identifikojë një objekt të përshtatshëm, ajo duhet të sigurohet që të mund të rinovohet për t'u përshtatur për shërbimet e kujdesit për fëmijë. Apo në një mënyrë tjetër, nëse komuna ka tokë që mund të përdoret për ndërtimin e një qendre, atëherë ajo duhet të kërkojë mbështetje nga donatorët apo nga fondet komunale.

Në fazën e dytë, Komuna duhet të informojë komunitetin për planet për hapjen e një qendre të kujdesit për fëmijë. Të gjithë prindërit fëmijët e të cilëve janë në moshën e përshtatshme për të marrë pjesë duhet të informohen. Përdoruesit kryesor të qendrës pastaj zgjedhin këshillin drejtues. Komuna mbetet përgjegjëse për të mbështetur komunitetin në organizimin e mbledhjeve, mbikëqyrjen e procesit të seleksionimit dhe procesin e mbështetjes. Punësimi i stafit duhet të bëhet në përputhje me kapacitetin e përgjithshëm të qendrës së kujdesit për fëmijë, duke u bazuar në numrin e fëmijëve që mund të pranohen. Përmes një thirrjeje publike që lëshohet nga Drejtoria e Arsimit, kandidatët mund të aplikojnë për të drejtuar qendrën. Procedura e aplikimit përfshin intervista me kandidatët të mundshëm, të cilat bëhen në bashkëpunim me këshillin drejtues dhe Drejtorinë Komunale të Arsimit. Kryesuesi i zgjedhur bashkë me këshillin bëjnë përzgjedhjen e pjesës tjetër të stafit.

Pagesa mujore për prindërit dhe subvencionet që paguhen nga komuna mund të vendosen nga menaxhmenti i qendrës dhe këshilli në bazë të të ardhurave familjare të fëmijës në fjalë. Në Komunën e Prishtinës, familjet paguajnë tre shuma të ndryshme në shkallë të ndryshme në bazë të të ardhurave familjare. Për shembull, familjet që fitojnë më shumë se 1,000 euro në muaj, paguajnë 100 Euro për fëmijë. Familjet që fitojnë midis 500 euro dhe 1,000 euro, paguajnë 70 euro për fëmijë. Ata që fitojnë më pak se 500 euro në muaj, paguajnë 50 Euro për fëmijë. Për sa i përket pjesës më të madhe, prindërit mbulojnë kostot operative ndërkohë që subvencionet komunale mbulojnë pagat e punëtorëve. Komuna po ashtu mbulon të gjitha pagesat për fëmijët që vijnë nga familjet me të ardhura të vogla apo pa të ardhura fare. Për më shumë, Komuna e Prishtinës ka mbështetur qendrat me shërbime tjera.

### Rast Studimi: Qendra Botanika

Qendra për kujdes për fëmijë me bazë në komunitet *Botanika* është njëra nga pesë qendrat e kujdesit për fëmijë në Komunën e Prishtinës. Qendra e kujdesit menaxhohet nga një "lider" që zgjidhet nga këshilli që përbëhet nga Këshilli i Prindërve dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit; termi "Drejtor" nuk është përdorur qëllimisht. Më pas janë përzgjedhur anëtarët e tjerë të stafit. Ndërtesa e cila është pronë komunale është rinovuar për të shërbyer si qendër e kujdesit për fëmijë. Qendra ka një kopsht me shesh lojërash dhe dhoma për secilin nga katër grup-moshat; nëntë muaj deri në një vjeç, një vjeç deri në tre vjeç, tre vjeç deri në katër dhe pesë vjeç deri në gjashtë.

Qendra paguan kostot operative duke përdorur fonde që mbledhen nga pagesat mujore të prindërve. Komuna përdor subvencionet për të paguar pagat. Prindërit po ashtu mbështetën qendrën duke gjetur donatorë për të financuar aktivitete të ndryshme ose për të siguruar furnizime. Qendra ka të njëjtën kuzhinë sikurse qendrat e tjera publike të kujdesit për fëmijë në Komunë.

Aktualisht kapaciteti i qendrës është plot. Gjithmonë ka të paktë tre deri në katër fëmijë në listën e pritjes për pranim. Për më shumë, qendra pranon të paktën një deri në tre fëmijë çdo vit pa pagesë.

<sup>194</sup> Intervista e RrGGK-së me znj. Arberie Nagavci, Drejtoria e Arsimit, Komuna e Prishtinës.

# Perspektivat komunale për modelet e ndryshme të kujdesit për fëmijë

Pasi që niveli i kërkesës dhe situata politike në secilën nga komunat e studiuara është e ndryshme, opsioni apo modeli më i mirë për të rritur mundësitë e kujdesit për fëmijë ndryshon në bazë të komunës. Në këtë pjesë shqyrtohen opsionet e mundshme që ndërlidhen me çdo komunë dhe diskutohet niveli i interesit nga zyrtarët komunal në rritjen e mundësive të kujdesit për fëmijë në komunat e tyre.

## Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës ka më shumë qendra publike (8), publiko-private (1), private (44), dhe me bazë në komunitet (5) sesa çdo komunë tjetër. Asnjëra nga këto qendra të kujdesit nuk ofron kujdes për fëmijë gjatë fundjavëve. Komuna po ashtu ka arritur një marrëveshje me “SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë” për të subvencionuar kujdesin për fëmijët e cenueshëm të lindur në Komunën e Prishtinës<sup>195</sup>.

Partia politike që aktualisht e udhëheq Prishtinën, *Vetëvendosja*, ka një prirje të majtë politike.

Kështu që zyrtarët nga Komuna e Prishtinës kanë preferuar zgjerimin e modelit të qendrave për kujdes për fëmijë me bazë në komunitet. Komuna planifikon të hapë edhe tri qendra për kujdes për fëmijë me bazë në komunitet në lagjet Tophane, Sofali dhe në Kodrën e Trimave. Eventualisht, ata planifikojnë të hapin qendra të tilla në të gjitha lagjet, duke lokalizuar qendrat sa më afër ofruesve pa pagesë të shërbimit, në mënyrë t'i ndihmojë ata/ato për të gjetur punë.

Qendrat me bazë në komunitet faturojnë 100 euro për muaj për fëmijë, e cila është mediana e kostove të përlogaritura për kujdesin për fëmijë në Prishtinë. Sidoqoftë, siç e përmendëm, Komuna ka krijuar nivele të ndryshme të pagesës për prindërit bazuar në të ardhurat e familjes. Komuna mbulon diferencën në mënyrë që të paguhet totali i shpenzimeve prej 100 euro në muaj për fëmijë.

Meqenëse pagesa mujore për qendrat publike të kujdesit për fëmijë janë më të ulëta, 50 euro në muaj për fëmijë, në 2015-ën Drejtoria e Arsimit krijoi një kriter në lidhje me atë se kush mund të regjistrohet. Ky vendim i cakton rregullat si më poshtë:

1. Vetëm fëmijët e prindërve që jetojnë në komunitetin e Prishtinës afër qendrës janë të pranueshëm;
2. Institucionet parashkollore i pranojnë fëmijët në përputhje me kornizën ligjore dhe kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore;
3. Institucionet parashkollore vendosin për moshën e fëmijëve që pranohen në baze të kapaciteteve profesionale dhe infrastrukturore; sa i përket kornizës ligjore, mosha e fëmijës duhet të numërohet nga dita që fillon shërbimi e jo nga dita që pranohet fëmija;
4. Pranimi i fëmijëve në institucionet publike parashkollore duhet të bazohet në totalin e pikëve që i merr kandidati<sup>196</sup>.

Tabela 19 paraqet në detaje pikët që sigurohen nga fëmijët në situata të ndryshme. Personat që kanë prioritet për pranim përfshijnë: fëmijë nga prindërit me të ardhura të ulëta, fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijë pa prindër, fëmijë me vetëm një prind dhe fëmijë që jetojnë aftë qendrës së kujdesit.

<sup>195</sup> Qendra Sociale Edukative SOS Kindergarten është një OJQ që mbështet fëmijët e pambrojtur: <http://soskosova.org/per-ne/sos-fshatrat-e-femijeve-ne-kosove/>.

<sup>196</sup> Republika e Kosovës, Komuna e Prishtinës, “Vendimi për kriteret e pranimit të fëmijëve në institucionet publike parashkollore”, 15 korrik 2015, faqe 2, <https://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/37fd58f2-ac4d-40b3-a99b-1de6c734a88e/Vendimi-per-kriteret-e-pranimit-te-femijeve-ne-lns.aspx>



**Tabela 19. Kriteret e Prishtinës për caktimin e prioriteteve për pranimin e fëmijëve në institucionet publike parashkollore**

Kriteri	Pikët
Fëmijë jetim që i ka humbur të dy prindërit	100
Fëmijë jetim me një prind që punon	90
Fëmijë jetim me një prind të papunë	80
Fëmijë të prindërve që janë invalidë të luftës, nëse punojnë të dy prindërit.	80
Fëmijë të prindërve që janë invalid të luftës nëse njëri nga ta punon.	60
Fëmijë të prindërve që janë invalidë të luftës, nëse asnjëri nga ta nuk punon.	40
Fëmijë me nevoja të veçanta, nëse të dy prindërit punojnë.	80
Fëmijë me nevoja të veçanta nëse njëri nga prindërit punon.	60
Fëmijë me nevoja të veçanta nëse asnjëri nga prindërit nuk punon.	40
Fëmijë të prindërve të divorcuar nëse prindi që e ka kujdestarinë është i punësuar.	40
Fëmijë të prindërve të divorcuar nëse prindi që e ka kujdestarinë është i papunë.	30
Fëmijë të prindërve që janë veteranë të luftës, nëse të dy prindërit punojnë.	40
Fëmijë i dy prindërve me nevoja të veçanta.	40
Fëmijë me njërin prind me nevoja të veçanta.	20
Fëmijë të prindërve që janë veteranë të luftës nëse njëri nga prindërit punon.	30
Fëmijë të prindërve që janë veteranë të luftës nëse asnjëri nga prindërit nuk punon.	20
Fëmijë me të dy prindërit e punësuar (të ardhurat mujore të prindërve 350 Euro)	50
Fëmijë me të dy prindërit e punësuar (të ardhurat mujore të prindërve 351-700 Euro)	40
Fëmijë me të dy prindërit e punësuar (të ardhurat mujore të prindërve prej 701-1000 Euro)	30
Fëmijë me të dy prindërit e punësuar (të ardhurat mujore të prindërve prej më shumë se 1000 Euro)	20
Fëmijë të prindërve që jetojnë në lagje.	20
Fëmijët e punëtorëve të institucioneve publike parashkollore	10
Fëmijë të prindërve që tashmë kanë një fëmijë të regjistruar në të njëjtin institucion	10
Fëmijë me njërin prind të punësuar (me të ardhura mujore deri në 350 Euro)	20
Fëmijë me njërin fëmijë të punësuar (me të ardhura mujore prej 351-700 Euro)	15
Fëmijë me njërin prind të punësuar (me të ardhura mujore prej 701-1000 Euro)	10
Fëmijë me njërin prind të punësuar (me të ardhura mujore prej më shumë se 1000 Euro)	5

Në mënyrë që të rritet numri i fëmijëve që përcjellin arsimin parashkollor (fëmijë të moshës 5-6 vjeç), Komuna ka hapur klasa të reja në institucionet e shkollës fillore në qytet dhe në fshatra. Në 2015 komuna ka ri-aktivizuar kuzhinën që mbështetet nga shteti që furnizon me ushqim të gjitha qendrat publike të kujdesit dhe ato me bazë në komunitet në Komunë. Iniciativa kërkoi që të përmirësojë menynë duke siguruar ushqim më të shëndetshëm për fëmijë. Në vitet e mëhershme, qendrat publike të kujdesit për fëmijë kishin kontraktuar furnizues privatë për ushqim. Ish të punësuarit e këtyre furnizuesve privat tani punojnë për kuzhinën publike sepse siç raportohet ata preferojnë kontrata me institucionet publike<sup>197</sup>.

Komuna e Prishtinës nuk ka ndonjë përgjegjësi direkte në lidhje me qendrat private për kujdes pasi që këto udhëhiqen nga MASHT-i. Zyrtarët kanë shprehur vullnetin për të identifikuar modalitetet për të krijuar një bashkëpunim të tillë. Përderisa në mënyrë të përgjithshme është e pranueshme ideja e mbështetjes së qendrave private të kujdesit apo PPP-ve, zyrtarët e anketuar nuk konsiderojnë që financimi apo bashkë financimi i sektorit privat duhet të jetë prioritet për përdorimin e fondeve komunale të kufizuara. Personat e punësuar kanë pozitë më të mirë për të gjetur opsione dhe alternativa të kujdesit për fëmijë. Sidoqoftë, disa prindër që përdorin qendrat private të kujdesit për fëmijë kanë kërkuar bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit; disa nga ta kanë shprehur interes në investimin e një kujdesi për fëmijë më të mirë. Këtu mund të ekzistojnë mundësi për të përfshirë prindërit dhe komunitetet në investimin për të krijuar më shumë modele të kujdesit për fëmijë me bazë në komunitet, publik apo PPP.

Sipas Drejtorisë së Pronave, Komuna zotëron përafërsisht 3,000 ngastra tokash që nuk përdoren, disa nga të cilat mund të përdoren për të zhvilluar objekte të kujdesit për fëmijë<sup>198</sup>. Një

<sup>197</sup> Intervista e RrGGK-së me znj. Arberie Nagavci, 2016.

<sup>198</sup> Intervista e RrGGK-së me Dren Kukaj, Udhëheqës i Drejtorisë për Pronat, Komuna e Prishtinës, 27 korrik 2016.

kërkesë zyrtare do të duhej të paraqitej në departamentin e pronave, duke përcaktuar në mënyrë të qartë nevojën publike që mund të plotësohej duke përdorur pronën në fjalë. Drejtoria do të shqyrtonte kërkesën dhe nëse do të ishte jashtë kompetencave të tyre, ata do ta dërgonin kërkesën në kuvendin komunal. Zyrtarët e planifikimit urban po ashtu vërejtën obligimin e tyre ligjor dhe shprehën vullnet për të mbështetur përgatitjen e infrastrukturës adekuatë për qendrat e kujdesit për fëmijë.

Duke marrë parasysh që qasja në zhvillim është një prioritet politik për Komunën e Prishtinës<sup>199</sup>, disa prona publike janë në dispozicion për përdorim; ekziston kërkesa; dhe në disa raste prindërit janë të gatshëm të investojnë, ekzistojnë disa mundësi për të zgjeruar kujdesin për fëmijë. Duke marrë parasysh programin politik të zyrtarëve, stimulimi i modelit të kujdesit për fëmijë me bazë në komunitet mund të rezultojë më i lehtë. Ky model ka po ashtu si dobi edhe përfshirjen më të madhe të komunitetit në pronësi dhe siguron mbikëqyrje. Duke lënë mënjanë kostot fillestare në lidhje me ndërtimin apo renovimin e më shumë qendrave të kujdesit për fëmijë në pronat publike që hipotetikisht mund të financohen nga donatorë ndërkombëtar në bashkëpunim me Komunën, sfida e zgjerimit të këtij modeli mund të jetë buxheti në dispozicion nga Komuna e Prishtinës për bashkë financim në shërbimet e kujdesit për fëmijë. Në të ardhmen, rreziqet mund të përfshijnë sigurimin që grupet e komunitetit që menaxhojnë qendrat të mbesin aktive në ofrimin e mbikëqyrjes, dhe mundësia që çdo ndryshim i ardhshëm në partinë politike në pushtet mund të kontribuojë në uljen e bashkë-financimit të nevojshëm që këto të mbesin operative. Nëse zgjerimi i kujdesit për fëmijë mbetet një prioritet i përgjithshëm i qeverisë, sikurse është deklaruar në SKZh, ky i fundit nuk mund të përbëjë ndonjë rrezik të madh.

Ekzistojnë edhe mundësitë për të mbështetur punëtorë që kanë shprehur interes për hapjen e qendrave të kujdesit në bizneset e tyre si pilot projekt.

## **Komuna e Gjakovës**

Disa gra të papunësuar në Gjakovë thanë që ato ballafaqohen me vështirësi në sigurimin e punësimit për shkak të përgjegjësive të kujdesit për fëmijë dhe të moshuar (46%) dhe mungesës së qendrave për kujdes (13%)<sup>200</sup>. Qyteti i Gjakovës ka një qendër publike që mund të pranojë deri në 500 fëmijë. Aktualisht, kjo qendër mund të pranojë përafërsisht edhe 100 fëmijë më shumë. Në qytetin e Gjakovës përafërsisht 1,000 deri në 1,200 fëmijë ndjekin arsimin parashkollor në qendrat publike apo private për kujdes për fëmijë<sup>201</sup>. Në vitin e kaluar Drejtoria e Arsimit riorganizoi programe me orar të shkollave parashkollore në të gjitha shkollat fillore. Në disa vende mësuesit/et punojnë me turne më të zgjatura, ndihmojnë dy grupe fëmijësh në të njëjtën shkollë. Të tjerët lëvizin nga një fshat në tjetrin për të përmbushur kuotën e orëve të punës.

Komuna e Gjakovës nuk ka ndonjë pronë në qytetin e Gjakovës që mund të përdorej për të krijuar qendra të reja të kujdesit për fëmijë. Sidoqoftë, aty janë dy ndërtesa që janë përdorur nga 1980 deri më 1990, që aktualisht menaxhohen nga Agjencia Kosovare e Pronës: “Electromotori” dhe “Emin Duraku”. Të dyja këto ish-fabrika kishin qendra të kujdesit për fëmijë brenda objektit që përdorehin nga punëtorët në atë kohë. Në të ardhmen kur këto prona të privatizohen, qendrat ekzistuese për kujdes për fëmijë mund të rivitalizohen për të siguruar kujdes për fëmijë për punëtorët e rinj<sup>202</sup>.

Një mundësi tjetër, sipas Drejtorisë së Pronës, është përdorimi i tokës që është në posedim të komunës në zonat rurale për të ndërtuar qendra të reja të kujdesit. Për shembull, zyrtarët e komunës sugjeruan që fshati i Rogovës, fshati më i madh i komunës (4,115 banorë), mund të jetë një lokacion ideal për një qendër të re të kujdesit për fëmijë<sup>203</sup>. Fshati i Rogovës ka një shkollë fillore dhe një të mesme. Në objektin e shkollës fillore ka dy klasa parashkollore për fëmijët e moshës 5-6 vjeç, por asgjë për fëmijët e moshës nën pesë. Tutje, zyrtarët theksuan se ka nevojë për më shumë qendra të kujdesit të fëmijëve, por komuna ka pasur mungesë fondesh. Një qendër e re e kujdesit të fëmijëve mund të përdoret poashtu edhe nga fshatrat e rrethinës, si për shembull: Xërxe (3,184 banorë), Bishtazhin (429),

<sup>199</sup> Po aty.

<sup>200</sup> Anketë e RrGGK-së me femra të papunësuar, 2016.

<sup>201</sup> Intervistë e RrGGK-së me znj. Diana Qarkaxhiu, Udhëheqëse e Drejtorisë së Arsimit, 2016.

<sup>202</sup> Intervistë e RrGGK-së me znj. Diana Qarkaxhiu, 2016.

<sup>203</sup> ASK, Regjistrimi i popullsisë 2011.

Smaq (435), Romajë (2,747), Dedaj (619), dhe Celinë (1,903). Pasi që Xërxa dhe Celina janë në komunën e Rahovecit ndërsa Romaja dhe Dedaj janë në komunën e Prizrenit, ndoshta ekzistojnë mundësitë për ndarje të shpenzimeve mes këtyre komunave, duke i ulur shpenzimet për një komunë të vetme. Drejtoria e Pronës ka shprehur gatishmëri për të bashkëpunuar me ndonjë donator apo kompani private të interesuar për të investuar në zhvillimin e më shumë qendrave të kujdesit për fëmijë, përdërisa proceduat i binden Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Transferimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës<sup>204</sup>. Drejtoria e Financave po ashtu ka shprehur vullnet për të mbështetur iniciativa në lidhje me renovimin e ndërtesave të vjetra për qëllime të kujdesit përdërisa respektohen të gjitha procedurat<sup>205</sup>.

## **Komuna e Pejës**

Komuna e Pejës aktualisht ka një qendër publike të kujdesit për fëmijë ku përfshihen 200 fëmijë dhe ka rinovuar një qendër për 40 deri në 60 fëmijë që planifikohet të hapet në shtator të 2016-ës. Qendra ekzistuese ka financim të mjaftueshëm dhe Komuna do të zhvendos disa punëtorë nga kjo qendër për stafin e qendrës së re. Kjo qendër ka nevojë për riparim të mëtutjeshëm duke përfshirë dritare të reja, tualete, dyer dhe një çati. Drejtoria Komunale e Financave planifikon të kërkojë investim nga Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në shtator<sup>206</sup>. Nëse kjo kërkesë nuk miratohet, atëherë ata do të provojnë të ndajnë mënjane disa fonde komunale apo të kërkojnë financim diku tjetër.

Komuna planifikon të hapë më shumë qendra të kujdesit për fëmijë në tre zona të qytetit, afër parkut të qytetit, Qendrës Kryesore Familjare Mjekësore dhe në rrugën "Xhemajl Kada". Njëra nga këto do të ketë nevojë për investime fillestare për të ndërtuar qendrën pasi që ngastra është aktualisht e lirë. Drejtoria e Pronës tha që dy hapësira të tjera mund të rinovohen për t'u përdorur për kujdes për fëmijë: Lagja Kristal dhe ish-ndërtesa e Organizatës për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Komuna ka shprehur gatishmërinë për të mbështetur krijimin e qendrave të edukimit parashkollor në zona të tjera rurale dhe urbane<sup>207</sup>. Kështu që Komuna e Pejës ka ndarë disa prona që do të përdoren për ndërtimin e qendrave të reja të kujdesit për fëmijë. Sidoqoftë, Komuna ka nevojë për fonde për renovimin apo ndërtimin e këtyre qendrave. Në të ardhmen Komuna do të ketë nevojë për fonde shtesë për kostot operative dhe mësuesit/et.

Në mënyrë që të mbulojë këto kosto, Komuna duhet të vazhdojë të kërkojë fonde shtesë hap pas hapi për të zgjeruar kujdesin për fëmijë që financohet nga shteti. Në të njëjtën kohë Komuna mund të bashkëpunojë me biznese dhe komunitetin lokal për të provuar modelet e PPP-së dhe ato me bazë në komunitet. Kjo mund të ndihmojë në reduktimin e barrës financiare të Komunës për të rritur mundësitë e kujdesit për fëmijë. Komuna ka shprehur gatishmëri për të bashkëpunuar me sektorin privat në mënyrë që të krijojë qendra të kujdesit për fëmijë, duke përdorur modelin e PPP-së<sup>208</sup>. Zyrtarët kanë thënë që Komuna ka lidhje pozitive me bizneset private siç janë ELKOS-i, Hotel Dukagjini dhe Birra Peja. Faktikisht, në të kaluarën kompania ELKOS kishte planifikuar të ndërtonte një qendër të kujdesit për fëmijë, por procesi ishte shtyrë. Kërkesa për shërbime të tilla duket që ekziston: 95.5 % e punëtorëve të ELKOS-it të anketuar dhe 91.9% e punëtorëve të Hotel Dukagjinit shfaqën interesim për përdorimin e shërbimeve të kujdesit për fëmijë që do të siguroheshin nga kompanitë e tyre.

Komuna mund të sigurojë stimulime, duke ia bërë më të lehtë sektorit privat të investojë në kujdesin për fëmijë. Pasi që disa kompani të mëdha gjenden afër njëra tjetrës, në periferi të qytetit të Pejës dhe disa nga to janë në sektorë që nuk garojnë direkt me njëra tjetrën, ato mund të inkurajohen të investojnë në qendra të përbashkëta të kujdesit për fëmijë për punëtorë e tyre. Nëse në këto qendra mbetet hapsirë në dispozicion, atëherë ato do të mund të ofronin shërbime të kujdesit për fëmijë me pagesë për fëmijët e prindërve që jetojnë në zonat përreth. Komuna përmes subvencioneve do të mund të mbështeste familjet me të ardhura të ulëta apo pa të ardhura fare dhe grupet e tjera të disavantazuara (p. sh. fëmijët me të meta, fëmijë me vetëm një prind), në bazë të mësimit që u inkurajua nga Prishtina

<sup>204</sup> Intervistë e RrGGK-së me z. Skender Tullumi, 2016.

<sup>205</sup> Intervistë e RrGGK-së me udhëheqësin e Drejtorisë së Financave të Komunës së Gjakovës, z. Teki Shala, 2016.

<sup>206</sup> Intervistë e RrGGK-së me z. Jeton Adazaj, Drejtor i Drejtorisë së Financave, Komuna e Pejës, 2016.

<sup>207</sup> Intervistë e RrGGK-së me udhëheqësin e Drejtorisë së Pronës, z. Edmond Shala, 2016.

<sup>208</sup> Intervistë e RrGGK-së me udhëheqësin e Drejtorisë së Financave të Komunës së Pejës, z. Jeton Abazaj, 2016.

në lidhje me dhënien e prioritetit. Subvencionet e tilla mund të kushtojnë më pak për komunën sesa hapja dhe menaxhimi i qendrës së saj.

## **Komuna e Kamenicës**

Kamenica është një Komunë e vogël me kërkesë për rritjen e mundësive shtesë për kujdesin e fëmijëve. Në linjë me Strategjinë Zhvillimore Kombëtare, e po ashtu pas kërkesave nga të dyja, anëtarët e kuvendit të grave dhe qytetarëve gjatë konsultimeve publike vjetore mbi buxhetin e Kamenicës, Komuna tashmë ka kërkuar të rriten mundësitë e kujdesit për fëmijë<sup>209</sup>. Në kërkesat me prioritet për buxhetin, Komuna ka kërkuar mbështetje buxhetore për të adresuar këtë prioritet që u identifikua nga qytetarët e saj. Sidoqoftë, Ministria e Financave nuk i ka aprovuar kërkesat, deklaruan zyrtarët komunal.

Drejtorja për Planifikim Urban dhe Hapësinor dhe Drejtorja e Arsimit kanë përgatitur një llogaritje të koston për renovimin e qendrës ekzistuese publike për kujdes për fëmijë, *Filizat*, e vetmja qendër e kujdesit për fëmijë parashkollorë në këtë Komunë. Në 2016, komuna e ka llogaritur se kostoja për renovimin e qendrës do të ishte 296,000 euro, duke përfshirë këtu edhe ndërrimin e dritareve të vjetra, dyerve, çatisë, fasadën, izolimin termik për kursim të energjisë, dyshemetë, rrymën, ngrohjen qendrore dhe një ambient të përmirësuar. Projekti e ka kapacitetin e 120 fëmijëve dhe 13 punëtorëve me orar të plotë. Paga mujore për fëmijë në këtë qendër është 25 euro.

*Filizat* nuk funksionon gjatë muajve të verës, gjë që ka paraqitur problem për qytetarët lokalë që punojnë gjatë gjithë vitit. Së fundmi, punëtorët e sektorit privat vendas kanë nënshkruar një petition të adresuar tek MASHT-i, duke kërkuar që kjo qendër publike të punojë edhe gjatë muajve të verës. Sidoqoftë, kërkesa nuk u miratua nga Ministri. Është e qartë që kërkesa për kujdes për fëmijë që do të ishte i disponueshëm gjatë verës ekziston.

Në lidhje me hapjen e qendrave të reja të kujdesit për fëmijë, Komuna mund të siguronte tokë për shembull në fshatin Ragacica. Sipas një zyrtari, atje ka nevojë të madhe për kujdes për fëmijë: “Atje ka raste kur femrat ecin 20 kilometra për të sjellë fëmijët e tyre në qendrën për kujdes të fëmijëve”<sup>210</sup>. Ragacica është njëri nga fshatrat më të mëdha të Komunës (përafërsisht ka 2,664 banorë duke përfshirë këtu 1,688 femra), kështu që ka më shumë familje që do të mund të përdornin një qendër të kujdesit për fëmijë. Kamenica zotëron ndërtesa të tjera publike që po ashtu do të mund të përdreshin për këtë qëllim por shumica e tyre janë në një situatë të keqe dhe do të kërkonin një investim të madh.

Një opsion tjetër për Komunën është që të hapë qendra të kujdesit për fëmijë në objektet ekzistuese funksionale siç është ajo në fshatin Liskoc. Së fundmi atje është hapur një shkollë fillore e re, por hapësira e shkollës është më e madhe se sa nevoja reale e komunitetit. Zyrtarët janë shprehur që kjo shkollë mund të hapë një program edukimi parashkollor në mënyrë që të rrisë numrin e fëmijëve në parashkollim. Sidoqoftë, Komuna aktualisht nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të punësuar punëtorë të tjerë. Ndoshta aty ekziston një mundësi për të hapur një qendër të kujdesit për fëmijë me bazë në komunitet duke bashkëpunuar me prindërit dhe punëdhënësit lokal. Nëse secili aktor do të kontribuonte me fonde, kostoja e përgjithshme do të mund të ulej për çdo aktor. Në ndërkohë Komuna do të mund të siguronte hapësirë dhe shpenzimet operative. Kjo mund të organizohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në kornizën ligjore të përmendur më herët, mundësisht duke u mbështetur në shembullin e Prishtinës.

Kështu që Kamenica mund të aplikojë modele të ndryshme për të rritur numrin e qendrave të kujdesit për fëmijë gjë që do të krijonte mundësi të reja punësimi për qytetarët e saj. Gjithashtu, Komuna mund të marrë në konsideratë bashkëpunimin me sektorin privat për të krijuar PPP-ët. Ndoshta sektori privat mund të inkurajohet të mbështesë punëtorët duke paguar disa nga pagesat mujore për kujdes për fëmijë.

---

<sup>209</sup> Intervistë e RrGGK -së me Drejtorinë e Financave, Komuna e Kamenicës, 2016.

<sup>210</sup> Po aty.

## Kosova e Veriut, Veçanërisht Mitrovica e Veriut

Në Mitrovicën e veriut nuk ekziston ndonjë qendër private e kujdesit për fëmijë apo institucion parashkollor<sup>211</sup>. Mitrovica e Veriut ka vetëm një qendër të kujdesit për fëmijë që drejtohet nga qeveria e Serbisë: “*Danica Jaramaz*”. Kopshtet po ashtu ekzistojnë nëpër fshatrat përreth, kështu që fëmijët nuk kanë nevojë të udhëtojnë në Mitrovicë apo Zveçan për kopshtin e fëmijëve.

Komuna e Mitrovicës së jugut nuk ka një drejtori të arsimit apo ndonjë person që është përgjegjës për arsimin. Një shoqatë e edukatorëve merr vendime në lidhje me kopshtin e fëmijëve. Objekti është mjaft i ri, ai është hapur në vitin 2010. Kopshti i fëmijëve ka psikologë, pedagogë dhe edukatorë për fëmijët. Programi mësimor është sipas atyre të qendrave për kujdes për fëmijë në Serbi. Duke marrë parasysh që të gjitha institucionet në veri të Kosovës janë në proces të integritimit, institucionet arsimore do të duhej të integroheshin dhe të jenë nën qeverinë e Kosovës. Sidoqoftë, ata do të vazhdojnë të përdorin programin mësimor të Serbisë.

“*Danica Jaramaz*” ka më shumë fëmijë se sa që mund t’i përballojë. Përderisa ndërtesa ka një maksimum prej 360 fëmijësh, në 2016 ata kishin 380 fëmijë. Zyrtarët kanë diskutuar krijimin e ndërtimeve në mënyrë që të kenë një kujdes më kualitativ. Një tjetër kopsht fëmijësh është duke u ndërtuar në lagjen boshnjake. Ky dhe çdo objekt tjetër i ri i kujdesit për fëmijë do të duhej të rekrutonte edukatorë shtesë.

Aktualisht institucionet arsimore duket të furnizohen nga të dyja qeveritë, ajo e Kosovës dhe ajo e Serbisë, me pajisje, ushqim dhe nevoja të tjera<sup>212</sup>. Punëtorët mesa duket pranojnë paga nga Kosova dhe Serbia. Përveç financimit publik, prindërit bashkë-paguajnë për shërbimet e kopshtit. Sipas ligjit serb për arsimin parashkollor “prindi apo kujdestari ligjor i fëmijës duhet të kontribuojë në mbështetjen financiare të implementimit të aktiviteteve në institucionin parashkollor [...] në shumë prej 20% të çmimit ekonomik për fëmijën”<sup>213</sup>. Institucionet përcaktojnë çmimin. Ligji përjashton nga pagesa fëmijët pa kujdes prindëror, ata me nevoja të veçanta dhe ata që vijnë nga familjet e disavantazuara financiarisht<sup>214</sup>.

Burimet lokale në Mitrovicën Veriore sugjerojnë që çmimi i rregullt për një fëmijë është 25 euro në muaj. Sidoqoftë, pagesa varion nga 15 euro deri në 40 euro varësisht nga pagat e prindërve dhe numrit të fëmijëve. Nëse kanë dy fëmijë në kopsht, atëherë aplikohet një zbritje për fëmijën e dytë. Nuk ka ndonjë pagesë për fëmijën e tretë. Personat që nuk mund ta përballojnë kujdesin për fëmijë mund të kërkojnë asistencë nga shërbimet sociale<sup>215</sup>.

Zyrtarët shprehën gatishmëri për idenë e krijimit të PPP-së. Një zyrtar deklaroi që prindërit mund të jenë të gatshëm të paguajnë më shumë për të dërguar fëmijët e tyre në qendra private të kujdesit nëse ato do të ekzistonin për sa kohë cilësia e kujdesit do të ofronte “ruajtje” për fëmijët e tyre. Sidoqoftë, duke marrë në konsideratë situatën aktuale politike, integrimi i mëtejshëm i veriut mund të jetë i nevojshëm në mënyrë që zyrtarët të mund të përdorin legjislacionin e Kosovës në lidhje me PPP-ët.

Sa i përket pronës që do të mund të përdorej për qendra të kujdesit për fëmijë, Mitrovica e Veriut ballafaqohet me disa sfida që kanë të bëjnë me posedimin e paqartë të tokave publike/private sepse nuk ka të dhëna kadastrale dhe ekziston një plan urbanistik i vjetruar (që nga 1999). Planet për të përditësuar planin urbanistik ekzistojnë, por zyrtarët kanë ngritur dyshime mbi atë nëse ndonjë buxhet do të ishte i disponueshëm për të rinovuar ndërtesat e vjetra për qëllime të kujdesit të fëmijëve.<sup>216</sup> Edhe nëse Komuna i jep leje për ndërtimin apo rinovimin e objekteve të tilla, shumica e pronave që do të mund të përdorshin janë ose të vjetra ose të papërdorshme.<sup>217</sup>

UNICEF-i ka mbështetur krijimin e qendrave të zhvillimit të fëmijërisë së hershme me bazë në komunitet në veri të Kosovës duke përfshirë këtu dy të tilla në Zveçan, një në periferi të Zubin Potoku dhe një në periferi të Leposaviqit.<sup>218</sup> Ato operojnë katër orë në ditë. Regjistrimi është pa pagesë për të

<sup>211</sup> Respondentët në Mitrovicën e veriut kanë hezituar të flasin në incizim. Kështu që ky seksion është bazuar në biseda jozyrtare që janë zhvilluar mes RrGGK-së dhe zyrtarëve dhe praktikantët në Mitrovicën e veriut.

<sup>212</sup> RrGGK-ja nuk arriti të mbledhë informacion të saktë mbi këtë pasi që respondentët hezituan të flasin sinqerisht në lidhje me këtë.

<sup>213</sup> Serbia, Ligji për Arsimin Parashkollor, Neni 50 (1)

<sup>214</sup> Po aty, Neni 50 (2,3).

<sup>215</sup> Intervistë e RrGGK -së me psikologun që ofron shërbime sociale, 2016.

<sup>216</sup> Intervistë e RrGGK-së me Drejtorinë e Planifikimit Urban, 2016.

<sup>217</sup> Intervistë e RrGGK -së me Drejtorinë e Pronave, Mitrovica e veriut, 2016.

<sup>218</sup> Emaili i korrespondencës i RrGGK-së-së, 12 tetor 2016.

gjithë fëmijët që vijnë nga zonat rurale dhe aktualisht në secilën qendër shkojnë 15 deri në 30 fëmijë. Aktualisht UNICEF-i paguan për edukatorë ndërsa shkollat lokale që operohen nga Ministria e Arsimit e Serbisë sigurojnë hapësirën duke përfshirë këtu kostot e shpenzimeve komunale dhe ato të pastrimit. OJQ Santa Maria menaxhon qendrat. Në sfidat më të mëdha të ndeshura bën pjesë transporti për fëmijët nga fshatrat përreth në mënyrë që të shkojnë në qendra dhe qëndrueshmëria e qendrave pasi që komunat ende nuk janë pajtuar t'i menaxhojnë ato. Në të ardhmen këto qendra do të mund të formalizoheshin dhe të regjistroheshin në MASHT. Sidoqoftë, duket që do të ketë nevojë për mbështetje politike shtesë.

Qeverisja lokale në veriun e Kosovës do të duhej të sqarohet më tej para se të bëhen investimet e sigurta e afatgjate në bashkëpunim me autoritetet e komunës. Sa i përket qendrave private për kujdesin e fëmijëve, mund të ekzistojnë më shumë mundësi për investime. Shumica e bizneseve janë të vogla kështu që të bindësh një punëdhënës të vetëm që të hapë qendra për kujdes të fëmijëve për punëtorët e tij mund të jetë diçka e pamundur. Për më tepër, shumica e bizneseve në veri nuk besojnë se ofrimi i kujdesit për fëmijë për punëtorë është një rol i bizneseve, ose e konsiderojnë investimin në kujdesin për fëmijë për punëtorët si shumë të shtrenjtë. Fakti që ata kanë punëtorë të papunë nga të cilët zgjedhin, e bën ofrimin e kujdesit për fëmijë të pavlefshëm për mendimin e tyre. Sidoqoftë, bizneset individuale ndoshta do të mund të bindeshin të subvencionojnë kujdesin për fëmijë për punonjësit e tyre.

## Rekomandime shtesë

- Qeveria e Kosovës, sidomos MPMS-ja, MASHT-i, dhe komunat duhet të *njohin* publikisht vlerën e punës së kujdesit që kryhet nga gratë; të *zvogëlojnë* kohën që gratë shpenzojnë për punën përkujdesëse, përmes rritjes së mundësive të shërbimeve të kujdesit; dhe të inkurajojnë *rishpërndarjen* e punës së kujdesit te burrat duke iu ofruar burrave të drejta të barabarta për leje atërore,<sup>219</sup> bursa për një numër më të lart studentësh që të bëhen edukatorë në institucione parashkollore,<sup>220</sup> dhe duke krijuar më shumë qendra të kujdesit për fëmijë ku do të punësoheshin më shumë gra dhe burra.
- Në mënyrë që të zbatohet SKZh-ja dhe të adresohet nevoja për rritje të edukimit parashkollorë, Komisioni i Granteve duhet të marrë parasysh ndryshimin e formulës për grante specifike për arsim, por gjithashtu duhet të parashihen fonde shtesë për komunat që kanë nevojë të rrisin shpenzimet në paga, materiale për mësim dhe investime të tjera lidhur me arsimin parashkollorë drejt zbatimit të SKZh-së dhe arritjes së Objektivave të Barcelonës.
- Projekt Ligji për Ndërmarrjet Shoqërore nuk është miratuar. Megjithatë, sipas projekt-ligjit, ofrimi i kujdesit për fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara konsiderohet si një prej aktiviteteve potenciale në të cilën mund të angazhohen ndërmarrjeve shoqërore.<sup>221</sup> Një numër më i madh qendrash të kujdesit për fëmijë mund të hapen si ndërmarrje shoqërore, sidomos ato që kërkojnë të punësojnë gra, persona me aftësi të kufizuara, të mbijetuar të dhunës me bazë gjinore dhe grupe të tjera të disavantazuara. Qeveria mund t'i kontraktojë këto ndërmarrje përmes një "procedure të thjeshtuar" të Ligjit për Prokurimit Publik. Këto ndërmarrje mund të kualifikohen për të aplikuar për financime nga qeveria si dhe nga programet e donatorëve. Sipas projekt-ligjit, qendrat që kualifikohen për këtë status do të përjashtohen nga tatimet mbi fitimin dhe taksën e vlerës së shtuar, dhe do të marrin nxitje të tjera potenciale financiare. Ky ligj duhet të miratohet, promovohet dhe përdoret për të nxitur përpjekjet për të krijuar një numër më të madh qendrash që punësojnë anëtarë të grupeve të cilëve nuk u është dhënë përparësi.

## Rekomandimet për Komunat

- Të rriten në mënyrë graduale alokimet buxhetore për kujdesin për fëmijë, duke u mbështetur në nivelin e kërkesës së paplotësuar në komuna, në drejtim të plotësimit të qëllimeve të caktuara në SKZH dhe Objektivat e Barcelonës të KE-së. Sipas nevojës, të kërkohej rritje e grantit specifik komunal për arsim dhe linjat e tjera buxhetore që janë të lidhura me arsimin për pagat e edukatorëve si dhe shpenzime të tjera që lidhen me arsimin parashkollor. Kjo mund të kryhet përmes zgjerimit të arsimit publik para-shkollor, subvencionit të qendrave me bazë në komunitet dhe/ose kontraktimit të PPP-ve duke përdorur subvencione.
- Duke marrë parasysh burimet e kufizuara, të prioritetizohet ofrimi i kujdesit për fëmijët që vijnë nga familjet e disavantazuara, ngjashëm me sistemin që përdoret në Prishtinë. Krahas kësaj, komunat duhet të ofrojnë kujdes falas për personat që kërkojnë punë. Për shembull, komunat duhet të sigurojnë që gratë dhe burrat, të cilët marrin asistencë nga Zyrat e Punës, të cilët janë të papunësuar dhe që presin të bëjnë intervista për punë dhe që frekuentojnë kurset e Qendrës për Aftësim Profesional, të marrin kujdes falas për fëmijët nga qendrat publike të kujdesit. Kjo mund të ndihmojë gratë dhe burrat e papunë në përpjekje për të gjetur punë.
- Të krijohen qendra të kujdesit për fëmijë pranë shtëpive dhe/ose vendeve të punës të prindërve, nevojat e fëmijëve të të cilëve kanë mbetur të paplotësuar. Kjo mund të jetë më e realizueshme nga pikëpamja mjedisore dhe ekonomike në raport me kohën e transportit, kostot dhe emetimet nga automjetet.

<sup>219</sup> Për informata të mëtejme dhe rekomandime të detajuara, shihni RrGGK-në, *Arritja e Ekulibrit*.

<sup>220</sup> Për informata të mëtejme, shihni RrGGK-në, *Buxhetimi për Arsim më të Mirë*.

<sup>221</sup> Republika e Kosovës, Qeveria, MMPMS, draft Ligji për Ndërmarrje Shoqërore, nga dhjetori i vitit 2015.

## Rekomandime për Ministrinë e Financave

- Të miratohen kërkesat e komunave të bazuara në fakte për rritjen e financimeve për qendrat e kujdesit të fëmijëve në pajtim me SKZH-në dhe qëllimet e qeverisë për rritjen e qasjes në arsimin parashkollor.

## Rekomandime për MPMS-në

- Të bashkëpunohet me MASHT-in për të dizajnuar dhe filluar ofrimin e trajnimeve profesionale në fushën e kujdesit për fëmijë, të ofruara nga Qendrat për Aftësim Profesional.<sup>222</sup> Kjo do t'iu mundësojë grave t'i formalizojnë njohuritë që kanë fituar ndërkohë që kryejnë detyra joformale të kujdesit, me qëllim që të mund të ofrojnë kujdes formal e të paguar. Edhe burrat mund të inkurajohen të marrin pjesë në këto kurse, në drejtim të rritjes së përqindjes së burrave që bëjnë punë përkujdesjeje dhe për t'iu mësuar fëmijëve rëndësinë e baraspeshës gjinore në rolet e përkujdesit. Kurset mund të zgjasnin nga 12 deri në 24 javë. Ndërkohë që ofruesit e kujdesit nuk mund të punojnë si edukatorë në institucione publike për shkak të kërkesave të diplomës universitare, ata mund të shërbejnë si ndihmës edukatorë për edukatorët që kanë diploma në arsimin parafillor dhe të punojnë me qendra private dhe me bazë në komunitet. Krahas kësaj, ata mund të punojnë edhe si kujdestare në ambiente shtëpiake. Ndërkohë, pagat më të larta për edukatorë/e të kualifikuara mund të ofrojnë një nxitje që asistentët të përfshihen në universitet.
- Të finalizohen ndryshimet në Ligjin për Punën, duke adresuar dispozitat aktuale të pushimit të lehonisë dhe atësisë në veçanti, në drejtim të uljes së diskriminimit të grave dhe burrave.<sup>223</sup> Aktualisht, dispozita për pushimin e lehonisë sugjerojnë në mënyrë të padrejtë se i gjithë kujdesi për fëmijë duhet të kryhet nga nëna, ndërkohë kjo diskriminon baballarët dhe të drejtën e tyre për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në kujdesin për fëmijët e tyre. Kjo kontribuon në zgjerimin e pabarazive gjinore në shoqëri, përmes përforsimit të supozimeve të pabazuara dhe të shtrembëruara nga ana gjinore sipas të cilave gratë duhet të kryejnë pjesën më të madhe të punëve të përkujdesit.
- Të dizajnohen apo të shtohen skemat ekzistuese sociale për subvencionimin e kujdesit për fëmijë për familjet me të ardhura të ulëta, prindërit e vetëm, personat e papunë që presin intervistat e punës, personat e papunë që frekuentojnë trajnimin profesional dhe të mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore.

## Rekomandime për MASHT-in

- Tu ipet përparësi qendrave të kujdesit të fëmijëve në zhvillimin e politikave, përfshirë këtu buxhetin për shpenzimet e lidhura me planifikim, ndërtim dhe mirëmbajtje të arsimit parashkollor, sipas nevojës, për të arritur synimet e SKZH-së dhe Objektivave të Barcelonës.
- Të sigurohet që Inspektorati i arsimit prej së afërmi i monitoron klasat në mënyrë që Ligji për Arsimin Para-Shkollor dhe legjislacioni dytësor të zbatohen, duke përfshirë në veçanti raportin nxënës/edukator/e, ushqimin dhe higjienën. Të ofrohet trajnim për qendrat private të kujdesit për fëmijë, duke fuqizuar kapacitetet e edukatorëve dhe duke iu mundësuar atyre të ofrojnë shërbime më cilësore.
- Të ndryshoj emri nga “Motrat Edukatore” në “Ndihmës Edukatorë/e” në mënyrë që të mos nxisë paragjykimet gjinore në punësimin e grave dhe burrave në arsim.

## Rekomandime për biznesin

- Aty ku është e realizueshme, të krijohen qendra të kujdesit për fëmijë, ose të kontraktohen shërbimet e kujdesit për fëmijë dhe të bashkë-financohet kujdesi për fëmijë për punonjësit. Kjo mund

<sup>222</sup> Rekomandim i shtjelluar nga kolegu shqyrtues në draftin e raportit. Vini re se edhe MPMS-ja mund të ofrojë kurse profesionale për kujdesin për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Këto trajnime nuk janë kërkuar që të organizohen dhe nuk janë organizuar më parë (bisedë telefonike me Drejtorin e Departamentit për Punë dhe Punësim, Tetor 2016).

<sup>223</sup> Për rekomandime specifike, shihni RrGGK, *Arrija e Ekuilibrit*.



të kontribuojë në mbajtjen e punonjësve, rritjen e produktivitetit, dhe rekrutimin e punonjësve më të kualifikuar.

### **Rekomandime për qendrat e kujdesit**

- Të angazhohen prindërit dhe komunitetet në aktivitetet e ngritjes së fondeve për furnizimet dhe pajisjet e nevojshme shtesë të cilat do të përmirësojnë mjedisin e nxënies për fëmijët.
- Të ndahen me prindërit në mënyrë transparente shpenzimet reale që lidhen me kujdesin që ato ofrojnë, me qëllim që prindërit të kuptojnë më mirë kostot e kujdesit cilësor për fëmijët.

### **Rekomandime për financuesit jo-qeveritarë**

- Nëse punëdhënësit do të mund të kuptonin dëshmitë e përfitimeve të prekshme, të lidhura me përkrahjen e qendrave për përkujdesje, ata do të ishin më të gatshëm për të marrë parasysh investimin apo përkrahjen e këtyre shërbimeve për punonjësit e tyre. Nëse programet e ardhshme investojnë në pilotimin e PPP-ve apo bashkëpunimin e punëdhënësve për të krijuar shërbime të përmirësuara të kujdesit për fëmijë për punonjësit, mësimet e nxjerra dhe çdo provë e përfitimeve nga këto programe do të mund të ndahet me punëdhënësit e tjerë. Kjo mund të kontribuojë në rritjen e numrit të punëdhënësve që kanë interes në ofrimin e shërbimeve të tilla në të ardhmen.

### **Rekomandime për Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe për hulumtime në të ardhmen**

- Në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit dhe ekspertët e çështjeve gjinore, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) duhet të hartojë dhe të ndërmarrë studime të rregullta, të paktën çdo pesë vite. Kjo do të lehtësonte monitorimin e kohës që harxhohet në punën e kujdesit dhe detyrat e tjera në familje, si dhe do të ofronte informata jetike lidhur me aktivitetet e tjera, të tilla si ato që lidhen me tregun joformal dhe punën joformale dhe pa pagesë. Ky hulumtim duhet të përfshijë perspektivën gjinore.
- Hulumtimet e mëtejshme do të mund të shqyrtonin format e kujdesit që përdoren nga personat e punësuar në ndërmarrje më të vogla, biznese familjare apo në informalitet. ASK do të mund të përfshinte disa pyetje brenda anketës së forcës punëtore lidhur me kujdesin për fëmijë me qëllim që të mbledhë informata kyçe lidhur me këtë drejtim.
- Hulumtimet e mëtejme do të duhet të përfshijnë të dhëna të sakta të kostove të kujdesit në nivelin komunal, duke u mbështetur në vlerën e tregut të shërbimeve të ofruara në atë komunë me qëllim që të plotësohen të gjitha kushtet e paraqitura në Ligjin për Arsimin Parashkollor dhe legjislacionin dytësor të ndërlidhur. Kjo do të ofronte të dhëna të sakta lidhur me kostot e kujdesit cilësor për fëmijë. UNICEF-i aktualisht është duke u marrë me një hulumtim të tillë me kërkesën e Kuvendit të Kosovës, i cili do të publikohet në vitin 2016.
- Hulumtimet e ardhshme do të duhet të shqyrtojnë në hollësi kërkesën, ofertën dhe mundësitë për rritjen e mundësive të formave të tjera aktuale të punës së kujdesit pa pagesë, siç është kujdesi për të moshuarit, të sëmurët dhe personat me aftësi të kufizuara.

## Bibliografia

- Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, Sida, *Udhëzues i shpejtë lidhur me çfarë dhe si: Puna Pa Pagesë në Kujdes - Pikat Hyrëse për Njohje, Zvogëlim dhe Rishpërndarje (Quick Guide to What and How: Unpaid Care Work: Entry Points to Recognise, Reduce and Redistribute)*, Sweden: 2012, marrë nga: <https://www.oecd.org/dac/gender-development/47565971.pdf>.
- Banka Botërore, Partneriteti Publiko-Privat në Infrastrukturën e Qendrave Burimore (Public-Private Partnership in Infrastructure Resource Center), marrë nga: <http://ppp.worldbank.org/public-private-partnership/overview/what-are-public-private-partnerships>.
- Branch, Catheryn, *A vlejë gratë po aq sa burrat? Pabarazia në punësim, rolet gjinore dhe politikat publike*, Nju Jork: *Duke Journal of Gender Law & Policy*, 1994: <http://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1205&context=djglp>.
- Eisler, Riane Kimberly Otis, *Puna e kujdesit e nënvlerësuar dhe pa pagesë i mban gratë buzë gremine (Unpaid and Undervalued Care Work Keeps Women on the Brink)*, California: *Center for Partnership Studies*, 2014, marrë nga: <http://shriverreport.org/unpaid-and-undervalued-care-work-keeps-women-on-the-brink/>.
- Elson, Diane, *Ekonomikja, Politikja dhe Ekonomia shtëpiake (The Economic, the Political and the Domestic)*, *New Political Economy*. 1998.
- Eurofound, *vjetari i Eurofound 2013: Jeta dhe puna në Evropë*, 2013, marrë nga: [http://www.eurofound.europa.eu/sites/default/files/ef\\_publication/field\\_ef\\_document/ef1416en.pdf](http://www.eurofound.europa.eu/sites/default/files/ef_publication/field_ef_document/ef1416en.pdf).
- EC, *Barcelona, Objektivi: Zhvillimi i qendrave për kujdesin ndaj fëmijëve, për fëmijët e vegjël në Evropë, në vështrim të rritjes së qëndrueshme dhe përfshirëse (The development of childcare facilities for young children in Europe with a view to sustainable and inclusive growth)*, Luksemburg, 2013: [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/130531\\_barcelona\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/files/documents/130531_barcelona_en.pdf).
- \_\_\_\_\_, *Raporti për Kosovës*, 2015, Bruksel, 10. 11. 2015, marrë nga: [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2015/20151110\\_report\\_kosovo.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf)
- \_\_\_\_\_, *Anketa për kushtet e punës në Evropë në vitin 2010*, marrë nga: [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/economic-independence/economic-growth/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/economic-independence/economic-growth/index_en.htm).
- \_\_\_\_\_, *Anketa për kushtet e punës në Evropë në vitin 2010*, marrë nga: [http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/economic-independence/economic-growth/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/justice/gender-equality/economic-independence/economic-growth/index_en.htm).
- Eyben and Fontana, *Kujdesi për Mirëqenie (Caring for Wellbeing)*, Brighton, 2011, marrë nga: <https://opendocs.ids.ac.uk/opendocs/bitstream/handle/123456789/3674/Bellagio-Eyben%20and%20Fontana.pdf?sequence=1>
- Fälth, A., Blackden, M., *Përmbledhje e politikave për punën pa pagesë të kujdesit (Policy Brief on Unpaid Care Work)*, Nju Jork, 2009, marrë nga: <http://www.undp.org/content/dam/undp/library/gender/Gender%20and%20Poverty%20Reduction/Unpaid%20care%20work%20English.pdf>.
- Fëmijët dhe Familjet, *Zyra e kujdesit për fëmijë, Partneriteti Ekzekutiv i Kujdesit për fëmijë i Floridas*. Florida: 2014, marrë nga: [https://childcareta.acf.hhs.gov/sites/default/files/public/florida\\_profile.pdf](https://childcareta.acf.hhs.gov/sites/default/files/public/florida_profile.pdf).
- Folbre, Nancy, *Për Dashuri dhe Para: Ofrimi i Kujdesit në Shtetet e Bashkuara (For Love and Money: Care Provision in the United States)*, Nju Jork: Russell Sage Foundation, 2012. <http://scholarworks.wmich.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=3739&context=jssw>.
- The Heckman Equation, *“Investimi në zhvillimin e fëmijërisë së hershme: zvogëlon deficitin, forcon ekonominë” (Invest in early childhood development: Reduce deficits, strengthen the economy)*, marrë nga: <http://heckmanequation.org/content/resource/invest-early-childhood-development-reduce-deficits-strengthen-economy>

- Himmelweit, Susan, Konferenca publike për *Gjininë dhe Financat Publike nga Perspektiva e Kujdesit*, 2014, marrë nga:  
[https://www.wu.ac.at/fileadmin/wu/d/i/vw3/Public\\_Conf\\_Key\\_Note\\_Sue\\_Himmelweit.pdf](https://www.wu.ac.at/fileadmin/wu/d/i/vw3/Public_Conf_Key_Note_Sue_Himmelweit.pdf).
- Hirokazu Yoshikawa, Christina Weiland, Jeanne Brooks-Gunn, Margaret R. Burchinal, Linda M. Espinosa, William T. Gormley, Jens Ludwig, Katherine A. Magnuson, Deborah Phillips, Martha J. Zaslow; *“Investimi në ardhmërinë tonë: baza e dëshmimeve për arsimin parashkollor” (Investing in Our Future: The Evidence Base on Preschool Education)*, Nju Jork: 2013, marrë nga: <http://fcd-us.org/sites/default/files/Evidence%20Base%20on%20Preschool%20Education%20FINAL.pdf>.
- Instituti për Studime Fiskale, Alissa Goodman dhe Barbara Sianesi, Arsimi i hershëm dhe rezultatet e fëmijëve: sa zgjasin këto ndikime? Korrik 2005*, marrë nga:  
[http://www.ifs.org.uk/docs/ee\\_impact.pdf](http://www.ifs.org.uk/docs/ee_impact.pdf).
- Konventa mbi të drejtat e fëmijës, 1989, marrë nga:  
[http://www.unicef.org/montenegro/CRC\\_albanian\\_language\\_version.pdf](http://www.unicef.org/montenegro/CRC_albanian_language_version.pdf)
- Kuvendi i Kosovës, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, <http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>
- \_\_\_\_\_, Ligji nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2525>
- \_\_\_\_\_, Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2784>
- \_\_\_\_\_, Ligji Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajshme të Komunës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2858>
- \_\_\_\_\_, Ligji Nr. 05/L-202 për Barazinë Gjinore,  
[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004\\_2\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2004_2_al.pdf)
- \_\_\_\_\_, Ligji Nr. 2004/32 për Familjen e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>
- \_\_\_\_\_, Ligji Nr. 2006/02-L-52 mbi Arsimin Parashkollor,  
[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006\\_02-L52\\_al.pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L52_al.pdf).
- Kuvendi i Përgjithshëm i OKB-së, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Femrave (KEGjFDF), 1979, marrë nga:  
<http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/Ahri/AConEliminationAllFormsDiscriminationAgainstWomen.pdf>.
- Murray, Jean, Valerie Adams, *The Conversation, Llogaritja e kostos së ekonomisë së kujdesit të Australisë (Counting the cost of Australia's care economy)*, 2012, marrë nga:  
<http://theconversation.com/counting-the-cost-of-australias-care-economy-9946>
- OBZHE, “Kërkohet Ndihmë - Ndikimi i Kujdesit në Kujdestarët Familjarë”, France: OBZHE 2011, marrë nga: <http://www.oecd.org/els/health-systems/47884865.pdf>.
- Pennycook, Matthew, *Fondacioni Resolution, Does it pay to care? Under-payment of the National Minimum Wage in the social care sector [A paguhesh të kujdesesh? Pjesa nën pagën minimale kombëtare në sektorin e kujdesit social]*, MB: Fondacioni Resolution, gusht 2013, marrë nga:  
<http://www.resolutionfoundation.org/wp-content/uploads/2013/08/Does-it-pay-to-care.pdf>.
- Repo, Katja, *Skemat e Parasë-për-kujdes dhe jeta e përditshme e familjeve: Shtepia e një fëmiju finlandez si shembull*, Finland: The University of Tampere, at:  
[http://www.hioa.no/asset/3661/1/3661\\_1.pdf](http://www.hioa.no/asset/3661/1/3661_1.pdf).
- Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, ASK, *Statistikat e lindjeve 2013, 2014, 2015 dhe Statistikat e vdekjeve 2013, 2014, 2015. Statistikat e arsimit në Kosovë 2015-2016*, Prishtina: ASK, 2016, marrë nga: <https://ask.rks-gov.net/sq/statistikat-e-arsimit#>.
